



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Maj 2021/ Nr. 5



Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim:
Stërvitja ushtarake zyrtarisht
ka filluar, të lumtur që Shqipëria
pret "Defender Europe 21"



Ministri Peleshi
"Presim stërvitjen më të
madhe të zhvilluar
ndonjëherë në Shqipëri "



Intervista
Shqipëria mikpritëse e stërvitjes
"Defender Europe 21" më e
madhja e NATO-s në rajon



STËRVITJA "DEFENDER EUROPE 21"

Ambasadorja e SHBA-ve, Yuri Kim priti
ushtarakët nga Garda Kombëtare e New Jersey

Përmbajtja

Numri 5

STËRVITJA "DEFENDER EUROPE 21"

- 6** Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim priti ushtarakët nga Garda Kombëtare e New Jersey

PROJEKTET

- 8** Amerikanët: Modernizimi i Forcës Ajrore me helikopterët Black Hawk

GJENERALMAJOR BEGAJ

- 12** Shqipëria mikpritëse e stërvitjes "Defender Europe 21" më e madhja e NATO-s në rajon

12-VJETORI I ANËTARËSIMI NË NATO

- 24** Shqipëria ka zënë vendin e saj në Aleancën e NATO-s

MARDHËNIET SHQIPËRI-SHBA

- 38** Kolonel Steven Bucci: Shërbimi në Shqipëri një nga pikat e mia të larta profesionale

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



4 YURI KIM

Kushdo që sheh hartën do kuptojë rëndësinë gjeostrategjike të Shqipërisë

Në vendin tonë, fillon stërvitja e madhe ushtarake "Defender Europe-21", me pjesëmarrje të Forcave të Armatosura shqiptare dhe trupave...



5 AMBASADORJA E SHBA-ve

Stërvitja ushtarake zyrtarisht ka filluar, të lumtur që Shqipëria pret "Defender Europe 21"

Më shumë ushtarë amerikanë po mbërrijnë në Shqipëri këtë javë për nisjen e "Defender Europe 21", stërvitjes më të madhe ushtarake...



14 INTERVISTË ME KOLONELIN SCROCCA

Stërvitja "Defender Europe 21" në Shqipëri

Intervistë me Kolonelin Joseph Scrocca, Drejtor për Marrëdhëniet me Publikun në Komandën e Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe Afrikë, dhënë për DW...



26 KOLONEL TAFILI

"Defender Europe 21": Gatishmëri, ndërveprueshmëri dhe operacionalitet

Stërvitja "Defender Europe 21", që do të mbahet në vendin tonë, është e një rëndësie strategjike dhe ajo zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 5/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfutimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Në vendin tonë, fillon stërvitja e madhe ushtarake "Defender Europe-21", me pjesëmarrje të Forcave të Armatosura shqiptare dhe trupave ushtarake të huaja të cilat do të vijnë nga vendet e NATO-s. Lidhur me këtë stërvitje ushtarake është pronocuar edhe Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim, në intervistën e dhënë më 13 prill për RTSH.

Pas pak ditësh do të fillojë stërvitja ushtarake "Defender Europe-21". Cili është mesazhi i stërvitjes më të madhe ushtarake në rajon?

Ambasadorja Yuri Kim: Mendoj që tregon se Shtetet e Bashkuara janë serioze. Kur themi se do të forcojmë marrëdhëniet me miqtë dhe aleatët tanë, se kemi në plan të mbetemi aleanca ushtarake, forca ushtarake më e pashoqe në botë, për ta bërë këtë, duhet të stërvitesh, të praktikohesh dhe kjo është një nga ato ngjarje ku do të provojmë sa shpejt dhe efektshëm mund të sjellim trupa dhe pajisje nga e gjithë bota në Europë, sa shpejt dhe efektshëm mund t'i lëvizim ato drejt Detit të Zi dhe në fund të sigurojmë që, nëse ndonjëherë do të bëhet e nevojshme për Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj, që do të fitonim në çdo konfrontim ushtarak. Ky është synimi, dhe zgjedhëm ta bëjmë këtë në Shqipëri sepse, e para, kushdo që sheh hartën do kuptojë rëndësinë gjeostrategjike të Shqipërisë. Mendoj edhe se ky është çasti i duhur për të ecur përpara në këto tre drejtime: demokraci, mbrojtje, biznes. E përsëris prapë, këto tre gjëra janë të lidhura, nuk janë të pavarura ndaj e presim me kënaqësi atë. Do të jenë deri në 6,000 trupa që do të vijnë. Kjo do të përfshijë rreth 26 vende të ndryshme që do të kontribuojnë me trupa dhe pajisje dhe besoj se stërvitjet do të zhvillohen në rreth 30 pika të ndryshme nëpër 12 vende në Europën Qendrore dhe Ballkanin Perëndimor. Domethënë do të jetë diçka e madhe. Ka qenë e planifikuar shumë kohë përpara se të caktohej data e zgjedhjeve në Shqipëri ndaj nuk dua të ketë ndonjë konfuzion për këtë.

E di, njerëzit mendojnë për konspiracion... E dini, nëse shton sigurinë, më vjen mirë, por nuk ka qenë ai qëllimi. Dhe pastaj do të shihni shumë më tepër lëvizje pas zgjedhjeve. Do të vazhdojë deri në

Kushdo që sheh hartën do kuptojë rëndësinë gjeostrategjike të Shqipërisë

Shqipëria po bën më të mirën për të qëndruar në drejtimin e duhur dhe duam ta mbajmë kështu



qershor. Në fakt janë një seri prej tre stërvitjesh të ndryshme ushtarake që mbivendosen mbi njëra tjetrën për të demonstruar gjëra të ndryshme. Javën e parë të majit ndoshta do kemi disa udhëheqës shumë të rëndësishëm që do të vijnë të vëzhgojnë stërvitjen ushtarake "Defender Europe-21".

Udhëheqës ushtarakë apo politikë?

Ambasadorja Yuri Kim: Usharakë, por besoj se mund të ketë edhe disa civilë që do të vijnë. Mendoj se ka shumë interes tek Shqipëria nga Uashingtoni këto ditë. Është e pafat që koronavirusi na ka penguar të bëjmë shumë më tepër ballë për ballë, por mendoj që fakti që po mbështesim qartë zgjedhjet tuaja dhe mbështesim fort kompromisin midis udhëheqësve politikë, dhe llogaridhënien nga të gjithë drejtuesit tuaj politikë, është një shenjë e rëndësishme. Mendoj se fakti që kemi nënshkruar një memo-

randum mirëkuptimi historik dhe disa rezultate konkrete tashmë nga ai memorandum janë për t'u shënuar. Fakti që do të zhvillohet stërvitja më e madhe ushtarake ndonjëherë në Ballkanin Perëndimor është po ashtu domethënëse. Pra, nëse ndokush pyet nëse Shtetet e Bashkuara e kanë për zemër Shqipërinë, mendoj përgjigja është e dukshme: po!

Sa e kënaqur jeni me angazhimin e Shqipërisë për të zbatuar premtimin e Uellsit për të shpenzuar jo më pak se 2% të PBB-së për mbrojtjen?

Ambasadorja Yuri Kim: Mendoj se Shqipëria po bën më të mirën për të qëndruar në drejtimin e duhur dhe duam ta mbajmë kështu, duam ta shohim Shqipërinë si çdo aleat tjetër, të bëjë më të mirën për të mbartur pjesën e saj të barrës dhe mendoj se pavarësisht sfidave nga situata me koronën, Shqipëria ka bërë punë të mirë.

Ambasadorja e SHBA-ve, Yuri Kim:

Stërvitja ushtarake zyrtarisht ka filluar, të lumtur që Shqipëria pret “Defender Europe 21”

Anija e marinës së Shteteve të Bashkuara “Bob Hope”, me 800 pjesë pajisjesh, ka mbërritur në Durrës

Më shumë ushtarë amerikanë po mbërrijnë në Shqipëri këtë javë për nisjen e “Defender Europe 21”, stërvitjes më të madhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor që përfshin 26 vende pjesëmarrëse. Gjatë stërvitjes ushtarake do trajnohen së bashku në të gjithë Shqipërinë dhe Evropën për të kryer operacione të ndryshme, duke filluar nga luftimet e simuluar e deri te ndihma humanitare. Ky ushtrim do ndihmojë forcat e SHBA, të Shqipërisë dhe të tjerat për të shfaqur aftësitë e tyre për të parandaluar konfliktet dhe për të mbajtur kombet tona të sigurta.

“Defender 21, stërvitja më e madhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor, fillon zyrtarisht sot”, shkruan më 26 prill 2021, në faqen e saj në facebook, Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim. “Me kënaqësi shoh anijen e marinës së Shteteve të Bashkuara “Bob Hope” që ka mbërritur në Durrës. “Bob Hope” është një anije furnizimi që mban më shumë se 800 pjesë pajisjesh për t’u përdorur në stërvitje. Dy anije të tjera do të bashkohen!”, shkruan Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim. Stërvitja “Defender 21” do të zhvillohet nga data 1 maj-14 qershor të këtij viti dhe do të

shtrihet në disa vende të Ballkanit dhe të Detit të Zi. Në të do të marrin pjesë mbi 17 mijë trupa amerikane dhe 14 mijë të tjera nga 26 vende anëtare të NATO-s, që do të vënë në dispozicion të stërvitjes edhe mjete ushtarake.

Ndërkohë, Ambasada amerikane me anë të një postimi tjetër, të datës 28 prill 2021, në twitter kujton stërvitjen ushtarake që do të zhvillohet në vendin tonë si pjesë e “Defender Europe 21”. Stërvitja e NATO-s në Shqipëri, “Defender Europe 2021” është konsideruar një tregues i nivelit të ngushtë të bashkëpunimit dhe i marrëdhënieve të ngushta që Shqipëria ka me SHBA. Zëvendëskomandant i Ushtrisë së SHBA në Europë, Gjeneral Major Joseph Jarrard e cilësoi Shqipërinë gjatë një vizite të fundit në vendin tonë si partnere strategjike e sigurisë amerikane në Europë. Ai theksoi, se stërvitja në fjalë do të shërbejë “për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ushtarak të SHBA, me ushtarë shqiptarë në tokën shqiptare”. Postimi i ambasadës amerikane në Tiranë, 28 prill 2021: “Ne jemi të lumtur që Shqipëria pret “Defender Europe 21”. Si pjesë e stërvitjes ushtarake, afërsisht 28 mijë forca shumëkombëshe nga 26 kombe do të kryejnë operacione gati të njëkohshme në më shumë se 30 zona trajnimi në 12 vende”. Në kuadër të stërvitjes së madhe “Defender Europe 2021”, trupat ushtarake amerikane kanë filluar të zbarkojnë në Portin e Durrësit më 16 prill 2021, ku ankorimi i parë ishte ai i anijes amerikane USAV MG CHARLES (LSV-5). Duhet thënë se kalatat 1, 2 dhe 3 të portit do të jenë në funksion të kësaj stërvitjeje. Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë stërvitje do të jetë demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura për të pritur, koordinuar dhe për t’u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe ato të NATO-s, në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks.





Stërvitja “Defender Europe 21”

Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim priti ushtarakët nga Garda Kombëtare e New Jersey

Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim ka mirëpritur më 10 prill 2021, në Tiranë disa ushtarë amerikanë nga Garda Kombëtare e New Jersey në kuadër

të stërvitjes ushtarake “Defender Europe 21”. Ambasada njofton se këta ushtarë do e ndihmojnë Shqipërinë për të marrë dy helikopterë UH-60A Blackhawk nga SHBA dhe do

të kryejnë trajnime për të përgatitur Forcat e Armatosura Shqiptare. Ambasada e SHBA-së në Tiranë njofton zyrtarisht se: “Ambasadorja Yuri Kim mirëpret ushtarët amerikanë nga



Ushtarët amerikanë do të ndihmojnë Shqipërinë për të marrë dyhelikopterë UH-60A Blackhawk nga SHBA dhe do kryejnë trajnime për të përgatitur FA-në për stërvitjen "Defender Europe 21"



Garda Kombëtare e New Jersey, të cilët mbërritën sot në Tiranë. Ata do të ndihmojnë Shqipërinë në përgatitjen për të marrë dy helikopterë UH-60A Blackhawk nga Shtetet e Bashkuara

dhe gjithashtu do të kryejnë trajnime për të përgatitur Forcat e Armatosura Shqiptare për stërvitjen "Defender Europe 21" e cila do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021.

Për rëndësinë që ka për Shqipërinë stërvitja ndërkombëtare ushtarake "Defender Europe 21" është shprehur edhe zv. Ndihmës Sekretari i Shtetit të SHBA-së Matthew Palmer, në takimin virtual me krerët më të lartë të shtetit Shqiptar, para pak ditësh ku ai theksoi rëndësinë strategjike të stërvitjes ushtarake "Defender Europe 21", e cila "do të jetë stërvitja më e madhe ushtarake shumëpalëshe që zhvillohet në Ballkanin Perëndimor dhe se stërvitja "Defender Europe 21" shpreh thellimin dhe rritjen e marrëdhënies së mbrojtjes dhe sigurisë me Shqipërinë si një partnere në NATO, një aleate në NATO".

Lidhur me stërvitjen "Defender Europe 21", kolonel Beqir Tafili, Drejtor i Drejtorisë të Operacioneve dhe Stërvitjes (J-3/7) në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së sqaron se: "Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do të drejtojë stërvitjen "Defender Europe 21" ku marrin pjesë: Shqipëria, Kanada, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj. FARSH do të vendosin në dispozicion të saj, hapësirën tonë ajrore për kryerjen e operacioneve ajrore, hapësirën detare për kryerjen e operacioneve detare dhe 11 poligone e destinacione të ndryshme të shpërndara në të gjithë territorin e RSH, ku përfshihen, porte, aeroporte, terrene stërvitore, poligone; infrastrukturë kritike etj, për kryerjen e stërvitjes/operacioneve tokësore. Në vendin tonë, do të dislokohen mbi 3000 trupa nga disa struktura amerikane, ku më kryesoret janë Brigada e 53-të e këmbësorisë së lehtë; batalioni i helikopterëve; batalioni logjistik; batalioni xhener, bateria e raketave "Patriot", struktura të Policisë Ushtarake; struktura CIMIC etj. Përveç forcave amerikane, në vendin tonë do të stërviten edhe njësi ushtarake të Republikës Çeke, Hungarisë, personel nga Kanada etj. Po ashtu, në vendin tonë, do të dislokohen edhe personel ushtarak nga rreth 15 vende të ndryshme Europës, të cilët do të plotësojnë me personel Qendrën Shumëkombëshe të Koordinimit CIMIC, e cila do të ngrihet në Bazën Detare /Pashaliman-Vlorë.

Amerikanët: Modernizimi i Forcës Ajrore me helikopterët Black Hawk

Gjeneralmajor Bajram Begaj priti në një takim të veçantë dy ekipet e ekspertëve ushtarakë të Gardës Kombëtare të New Jersey

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj priti më datë 16 prill 2021, në një takim të veçantë dy ekipet e ekspertëve ushtarakë të Gardës Kombëtare të New Jersey, të shoqëruar edhe nga atasheu i SHBA-së dhe përfaqësues të Zyrës së Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes.

“Modernizimi i Forcës Ajrore me helikopterët Black Hawk nga SHBA dhe vijimi i punës për kompletimin e b2k-së me mjete të blinduara është tregues i qartë i partneritetit strategjik midis dy vendeve dhe asistencës që SHBA ka dhënë dhe vijon të japë për Shqipërinë. Projektet e asistencës së SHBA-së për modernizimin e FARSH konsiderohen si paketa të plota kapaciteti, të cilat përfshijnë jo vetëm pajisjet, por edhe mirëmbajtjen e tyre dhe trajnimin e personelit përdorues, duke ofruar garanci afatgjatë në operacionalitetin e forcave.” - u shpreh ndër të tjera gjatë takimit gjeneralmajor Begaj.

Ekspertët e ekipeve të Gardës Kombëtare të New Jersey siguruan shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së se janë të gatshëm të rrisin nivelin e asistencës në fushën e trajnimit të personelit pilot dhe mirëmbajtës të teknikës ajrore.

Në përfundim shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj falënderoi Zyrën e Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes për rolin dhe përpjekjet e vazhdueshme për të mbështetur modernizimin e FARSH me projekte konkrete. Ekipet e Gardës Kombëtare të New Jersey gjatë kësaj jave kanë kryer vizita pune në Komandën e Forcës Ajrore dhe Forcës Tokësore lidhur me projektet e modernizimit të FARSH me helikopterët UH-60A Black Hawk dhe mirëmbajtjes së mjeteve të blinduara HMMWV të dhëna nga pala amerikane në

kuadër të asistencës në fushën e Mbrojtjes.

Gjatë ardhjes në Shqipëri, ekipet së bashku me trupa të tjerë ushtarakë të SHBA-së pjesëmarrës në stërvitjen “Defender 21” u pritën në aeroportin

“Nënë Tereza” nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ambasadorja e SHBA-së Juri Kim. Lidhur me këtë pritje në Rinas, Ambasada e SHBA-së në Tiranë njoftoi zyrtarisht me 10 prill,





se: "Ambasadorja Yuri Kim mirëpret ushtarët amerikanë nga Garda Kombëtare e New Jersey, të cilët mbërritën sot në Tiranë. Ata do të ndihmojnë Shqipërinë në përgatitjen për të marrë dy helikopterë UH-60A Black Hawk nga Shtetet e Bashkuara dhe gjithashtu do të kryejnë trajnime për të përgatitur Forcat e Armatosura Shqiptare për stërvitjen "Defender Europe 21" e cila do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021".



STËRVITJA "DEFENDER EUROPE 21"

Gjeneral Xhebexhia takon kolonelin amerikan Timothy R. Zetterwall

Në kuadër të zhvillimit të stërvitjes së përbashkët "Defender Europe 21", më datë 22 prill 2021, në ambientet e Komandës së Forcës Detare, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie komandantin e JTF-07, kolonel Timothy R. Zetterwall. Një pjesë e efektivëve JTF-07 aktualisht janë të dislokuar në garnizonin Plepa. Gjatë takimit gjeneral brigade Xhebexhia i uroi mirëseardhjen kolonel Zetterwallit dhe shprehu gatishmërinë e tij dhe të personelit të Forcës Detare për çdo mbështetje që mund të kërkojë pala amerikane si dhe i uroi suksese në stërvitje. Nga ana e tij, kolonel Zetterwall falënderoi komandantin e Forcës Detare për mikëpritjen dhe u shpreh se deri tani çdo gjë ka qenë e mirëorganizuar nga pala pritëse.





MINISTRI PELESHI INSPEKTON PËRGATITJET PËR "DEFENDER EUROPË 21"

Presim stërvitjen më të madhe të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri

Stërvitja më e madhe ushtarake e 30 viteve të fundit në vendin tonë është gati të ngrejë siparin. Forcat tona të Armatosura, përveç pjesëmarrjes me rreth 1000 trupa, kanë përgatitur edhe infrastrukturën ndihmëse për pritjen e kolegëve të tyre nga vendet aleate.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi inspektoi ditën e enjte, më 29 prill 2021, pjesën ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" infrastrukturën e përkohshme për pritjen e trupave, duke respektuar edhe masat kundër përhapjes së COVID-19. Ministri Peleshi e konsideroi stërvitjen "Defender Europë 21" si shumë të çmuar për rëndësinë strategjike të Shqipërisë dhe rolin që vendi ynë luan si vend anëtar i NATO-s. "Bëhet fjalë për një ngjarje historike sepse është stërvitja më e madhe e ndodhur ndonjëherë në Shqipëri dhe rajon. Është një stërvitje, e cila jep mesazhe të rëndësishme për rëndësinë strategjike të Shqipërisë dhe për rolin që vendi ynë ka dhe do të ketë në të ardhmen në të gjitha zhvillimet gjeopolitike duke patur në krah aleatë shumë të fortë. Partneri ynë më strategjik që,



Shqipëria do jetë një nga 16 vendet që do mirëpresin zhvillimin e kësaj stërvitjeje ushtarake, e cila ka për qëllim ndërveprimin e aleatëve dhe reagimin në raste krizash

le të themi janë Komanda Evropiane e SHBA, është organizatore e kësaj stërvitjeje, natyrisht në kuadrin e NATO-s, me pjesëmarrje të madhe të trupave amerikane por edhe të vendeve të tjera pjesë e Aleancës. Ne jemi vend pritës dhe do të marrim pjesë me rreth 1000 efektivë aktivë. Unë sot kam ardhur me shefin e Shtabit të FA, gjeneralmajor Begaj, për të parë pikën hyrëse të trupave që do të ulen në pistën e Rinasit. Këtu janë facilitetet e nevojshme për të pritur edhe më pas sipas planit, vazhdon stërvitja. Do të kemi vizita shumë të rëndësishme në ditët në vazhdim nga NATO, nga Komanda

Evropiane e SHBA, Komanda Supreme Operacionale e NATO, që siç e thashë puntajnë tek rëndësia dhe mesazhet strategjike të kësaj stërvitjeje për vendin, rajonin por edhe për gjithë Evropën." , - u shpreh ministri Peleshi. "Defender Europe 21" është një stërvitje e organizuar nga ushtria amerikane në Evropë dhe Afrikë dhe parashikohet të marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 26 vende aleate dhe partnere. Shqipëria do të jetë një nga 16 vendet që do të mirëpresin zhvillimin e kësaj stërvitjeje ushtarake, e cila ka për qëllim ndërveprimin e aleatëve dhe reagimin në raste krizash.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, me anë të një mesazhi, ka urrear pilotët, ushtarakët aktivë dhe në rezervë dhe civilë të Forcës Ajrore, në 70 - vjetorin e krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, si më poshtë vijon:

"Ky 24 Prill, shënon 70-vjetorin e krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Në këto shtatë dekada, me përkushtim, djersë dhe sakrifica sublime e të jashtëzakonshme, aviacioni ynë ka shkruar një histori të lavdishme. Misioni ushtarak i tij, por veçanërisht angazhimi dhe kontributi i pazëvendësueshëm e fisnik ndër vite për komunitetin dhe jetën e njerëzve të thjeshtë në situata emergjence, në kohë të vështira dhe kritike, në fatkeqësi dhe nevojë, në ndihmë e në shpëtim jetësh, e ka bërë aviacionin tonë ushtarak dhe pilotët e tij, nga njerëzit më të dashur, të nderuar dhe të adhuruar në popull, dhe historinë e tij, pjesë të historisë tonë kombëtare.

Arma e Aviacionit Ushtarak dhe shërbimi në të është fisnik, është krenari, por sfidues, i vështirë dhe me kërkesa e rreziqe të përhershme e të paparashikuara. Dëshmorët e shumtë të saj janë dëshmia e këtyre vështirësive e rreziqeve, por edhe e përkushtimit, dashurisë, kurajës dhe guximit të këtyre profesionistëve. Forca Ajrore dhe Aviacioni i saj Ushtarak, sikurse gjithë Forcat e Armatosura, ka kaluar në procese të domosdoshme dhe të

Me përkushtim, aviacioni ynë ka shkruar një histori të lavdishme

Gjeneralmajor Bajram Begaj: "Modernizimi, zgjerimi i flotës së helikopterëve dhe konsolidimi e intensifikimi i përgatitjes profesionale të pilotëve, do ta bëjnë Forcën Ajrore një forcë më të fuqishme, më efikase dhe më operacionale"



nevojshme reformimi, transformimi dhe zhvillimi, në kuadër të angazhimeve kombëtare euro-atlantike dhe anëtarësimit në NATO. Siguria për modernizimin dhe zgjerimin e flotës së helikopterëve dhe të elementëve të tjerë të Forcës Ajrore, konsolidimi dhe intensifikimi i përgatitjes profesionale të pilotëve, me mbështetjen edhe të aleatëve tanë, do ta bëjë

atë një forcë më të fuqishme, më efikase dhe më operacionale.

Në këtë përvjetor, homazhi i parë i nderimit shkon për ata që kanë sakrifikuar jetën në Armën e Aviacionit Ushtarak, dhe një mesazh i veçantë respekti e mirënjohje për të gjithë aviatorët, personelin inxhiniero - teknik, ushtarak e civil të kësaj arme ndër vite, që me punën dhe përkushtimin, pasionin dhe dashurinë e treguar, e kthyen atë, por edhe figurën e tyre, në një monument krenarie për gjithë Forcat e Armatosura dhe shprese e besimi për të gjitha komunitetet në kohë të vështira dhe nevojë. Edhe në këto kohë të sfidës së madhe kombëtare me pandeminë virusale, pilotët tanë, kudo që ata shërbejnë, vazhdojnë të gjenden dhe t'iu përgjigjen kërkesave dhe emergjencave të kësaj situatë të jashtëzakonshme. Kjo gjendje e bën edhe kujtimin e këtij përvjetori të veçantë dhe të kufizuar përmes shprehjes së urimeve më të mira për të gjithë veteranët, aviatorët aktivë e rezervë, ushtarakë dhe civilë të Forcës Ajrore!"

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj

Është dita për të përkujtuar me krenari 24 Prillin e vitit 1951

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj uron me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar: "Sot, festojmë 70-vjetorin e krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Është dita për të përkujtuar me krenari 24 Prillin e vitit 1951, ditën kur u krye fluturimi për herë të parë i Avionit Ushtarak shqiptar.

Në këtë ditë të shënuar, Forca Ajrore kujton dhe nderon me respekt të gjithë atë plejadë profesionistësh, komandantësh, pilotësh, teknikësh dhe personel civil e ush-

tarak që shërbyen me përkushtim duke e transmetuar dhe kontribuar në breza ngritjen, drejtimin dhe zhvillimin e kësaj arme të dashur të Forcave të Armatosura. Në historikun e Forcës Ajrore janë gdhendur me shkronja të arta emrat e Dëshmorëve të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, të cilët dëshmuar dhjetëra akte guximi, trimërie, profesionalizmi e vetëmohimi duke rënë në krye të detyrës dhe duke mbetur të përjetshëm në breza. Prandaj ne pjesëtarët më të rinj të Forcës Ajrore i kujtojmë me nderim e res-

pekt të thellë të gjithë Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak Shqiptar, të cilët janë nderi dhe krenaria jonë. Me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, uroj të gjithë efektivët dhe pjesëtarët e Forcës Ajrore në vite gëzuar festën e 70-Vjetorit. Le të punojmë të gjithë së bashku për të çuar më tej emrin e respektuar të Aviacionit Ushtarak Shqiptar dhe Forcës Ajrore. Na takon ne, që detyrimet ndaj Aleancës t'i çojmë në një stad më të lartë me profesionalizimin e secilit anëtar të Forcës Ajrore!"

Shqipëria mikpritëse e stërvitjes “Defender Europe 21” më e madhja e NATO-s në rajon

Zëri i Amerikës: Zoti Gjeneral! Stërvitja “Defender Europe 21” është vlerësuar si më e madhja, që është zhvilluar ndonjëherë më parë në këtë rajon. A mund të na tregoni mbi përmasat dhe qëllimet e stërvitjes?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Faleminderit për interesimin dhe praninë tuaj këtu në shtabin e forcave të armatosura. Pyetja juaj është shumë e rëndësishme edhe për vet forcat e armatosura shqiptare. Stërvitja “Defender Europe 2021” është stërvitja më e madhe e zhvilluar ndonjëherë në rajonin tonë dhe është ngjarje jo vetëm ushtarake për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, rajonit dhe më gjerë, por për vendin tonë është më shumë edhe si një ngjarje kombëtare. Kjo stërvitje është e përmasave të mëdha, jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes, por edhe për shkak të rëndësisë së saj. Nga përmasat mund të flasim në nocionin gjeografik: kjo stërvitje përfshin një territor mjaft të gjerë që nga Afrika e deri në Europë, por në vijë frontale përfshin vendet e Europës veriore nga Baltiku, Deti i Zi dhe Ballkanit Perëndimor. Përfaqësimi në këtë stërvitje do të jetë me prezencë të madhe trupash: mendohet të marrin pjesë rreth 30 mijë trupa dhe do të jenë të pranishëm edhe 26 vende anëtare të NATO-s, të cilët do të jenë me prani trupash gjithashtu. Për vendin tonë, ky eveniment ushtarak është shumë i rëndësishëm për faktin që Komanda Amerikane e Europës dhe Afrikës organizon këtë stërvitje për herë të parë në rajonin tonë me rëndësinë që e shprehin edhe vet e përmasat e saj. Me këtë vlerësim Shtetet e Bashkuara shprehin vendosmërinë, aftësinë, sigurinë dhe që janë garant i sigurisë dhe mbrojtjes së Europës Qendrore, Veriore dhe për rajonin tonë delikat të Ballkanit Perëndimor.

Zëri i Amerikës: Çfarë synon kjo stërvitje, e cila kërkon edhe një bashkërendim midis kaq shumë kombesh?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Stërvitja përveç planeve dhe komunikimit strategjik që bën në vetvete, ka dhe një interes ushtarak për faktin që rrit dhe teston aftësinë dhe ga-

“ Shtetet e Bashkuara shprehin vendosmërinë, aftësinë, sigurinë dhe që janë garant i sigurisë dhe mbrojtjes së Europës Qendrore, Veriore dhe për rajonin tonë delikat të Ballkanit Perëndimor.



forca të armatosura të Shqipërisë, kjo stërvitje na jep mundësinë që ne të bëjmë testimin e aftësive tona operacionale të njësive dhe strukturave tona, të cilat janë të deklaruar dhe të certifikuar për pjesëmarrje në Aleancë në vendet dhe rajonet, ku ata e shikojnë të arsyeshme të marrë pjesë. Gjithashtu nxirren mësim për të garantuar stërvitje më cilësore në të ardhmen dhe që trupat tona të jenë të përkushtuara dhe angazhuara në të ardhmen në pjesëmarrjen në operacionet e përbashkëta në Nato. Organizimi i kësaj stërvitjeje në kushtet e pandemisë është një arritje e madhe për faktin që në këto situata të vecanta arrijmë që të organizojmë një stërvitje të përmasave kaq të mëdha.

Zëri i Amerikës: Cila është pjesa dhe roli që ka marrë përsipër ushtria e Shqipërisë?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Ne e falenderojmë aleatin tonë strategjik, SHBA-të, që na përgjodhën si vend mikpritës i stërvitjes. Kjo dëshmon një akt besimi që SHBA kanë për Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ne do të marrim pjesë me mjete dhe trupa

dishmërinë operacionale të forcave aleate. Së dyti bën komunikimin dhe ndërveprueshmërinë midis pranisë së trupave nga vende të ndryshme për të vepruar në nivelin taktiko operacional. Po kështu synohet përdorimi efektiv i kapaciteteve të përbashkëta në një stërvitje me kaq gjerësi dhe me kaq shumë forca pjesëmarrëse. Në planin ushtarak kombëtar, si

tokësore, detare, ajrore dhe do të ketë pjesëmarrje nga struktura të tjera të mbështetjes, komunikimit dhe mbrojtjes kibernetike. Ne do të testojmë kapacitetet tona infrastrukturore, mbështetëse, logjistike, koordinuese dhe bashkëpunuese me institucionet e tjera civile në vend. Roli mikpritës i kësaj stërvitje, me fjalë të tjera, ka të bëjë me vënien në dispozicion të kësaj stërvitjeje të kapaciteteve tona aero-portuale, detare, infrastrukturës rrugore për kalimin tranzit të trupave dhe mjeteve nëpër Shqipëri për t'u dislokuar në vende të tjera të rajonit. Stërvitja kërkon koordinim dhe bashkëpunim të gjithë strukturave të vendit. Për këtë falenderoj institucionet për ndihmën e plotë, nga parlamenti, Këshilli i Sigurisë Kombëtare, ministrinë e mbrojtjes etj.

Zëri i Amerikës: Çfarë mund të thoni lidhur me angazhimin profesional dhe sasi të ushtrisë së SHBA-ve, sepse ata kanë rol thelbësor dhe po sjellin trupat dhe përvojën e tyre?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Stërvitja është komplekse dhe shumë e gjerë në pikëpamjen ushtarake. Ka prani trupash, mjeteve dhe elementë të tjerë, që lidhen me kapacitetet logjistike dhe të komunikimit. Stërvitja do të kryhet në rajone të ndryshme të Shqipërisë, Durrësi, Biza, Rinas, Kuçova, Farka etj. Trupat amerikane në vendin tonë mund të arrijnë 3 mijë ose 4 mijë të pranishme nga Komanda Amerikane për Europën dhe Afrikën. Natyrisht do të kishte edhe kapacitet logjistik, mbështetëse, akomoduese dhe komunikuese të ushtrisë amerikane.

Zëri i Amerikës: Ndërsa nga pikëpamja shtetërore marrëdhëniet shqiptaro - amerikane gjithmonë vlerësohen si të niveleve më të shkëlqyera. Si do ta vlerësonit ju bashkëpunimin ushtarak mes Shqipërisë dhe SHBA-ve, duke marrë shkas nga kjo stërvitje?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Kjo stërvitje në vetvete tregon forcën e kohezionit të Aleancës. Bërja e kësaj stërvitje me aleatin tonë strategjik, SHBA-të, tregon mesë miri vlerësimin e opinionit publik si dhe vlerësimin e vendeve të Aleancës, që përfshihet në raportin vjetor të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg, i cili thotë se 79 për qind e qytetarëve vlerësojnë bashkëpunimin e Amerikës së Veriut me Europën në çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes si shumë të rëndësishme. Në këtë aspekt, bashkëpunimi dhe zhvillimi i kësaj stërvitje në vendin tonë tregon që aleati ynë strategjik ka besim tek Shqipëria, ka besim te forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë, dhe vlerëson kapacitetet tona ushtar-

ake si të afta dhe dëshmojmë se jemi një vend anëtar i denjë i Aleancës së NATO-s. SHBA-të kanë bërë investime të konsiderueshme të forcat tona të armatosura. Mbështetja ka qenë ligjore, konceptuale, doktrinare, strukturore. Kurora e gjithë këtij bashkëpunimi ka qenë asistencë e vazhdueshme teknike në lidhje me riorganizimin e forcave të armatosura shqiptare; shpërndarjen e saj në një forcë të vogël në numër, por e aftë të përballojë çdo sfidë si anëtar i NATO-s. E rëndësishme është pjesëmarrja në misione, në operacione dhe kontribute të përbashkëta me SHBA-të. E ka përmendur edhe ambasadorja amerikane, Yuri Kim, se një nga prirjetet e qëndrimit të saj këtu në Shqipëri është edhe mbrojtja. E falenderojmë për bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi me SHBA-të. Për forcat e armatosura shqiptare kontributi i SHBA-ve ka qenë jo vetëm në asistencë teknike, por edhe në trajnimin dhe edukimin e personelit shqiptar. Bashkëpunimi në këtë fushë është kontributi më i rëndësishëm, i gjithanshëm dhe pamatshëm. Ky kontribut i qenësishëm shërben drejt një kulture të re dhe reformimit të mentalitetit të forcave tona të armatosura.

Zëri i Amerikës: A mund të na thoni disa nga investimet më

të fundit të SHBA-ve ër ushtrinë shqiptare?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Investimet e SHBA-ve në modernizimin e ushtrisë shqiptare janë të pamatshme. Së fundi vijnë pas pak kohe helikopterë luftarakë të tipit Black hawk, të pajisjes së forcës tokësore me armatim të ri, me pajisje të kimisë, dhe me projekte mbi sigurinë kibernetike, apo me projektin e radarit. Këto janë të rëndësishme jo vetëm pse na pajisin ne, por edhe për faktin se këto projekte janë të lidhura si paketë totale. Përveç pajisjeve, ne marrim edhe edukimi, trajnimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve.

Zëri i Amerikës: Si po shkon puna me projektin e aeroportit të Kuçovës?

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Një kontribut të rëndësishëm për aeroportin e Kuçovës kanë dhënë edhe SHBA-të. Ai është një projekt për modernizimin e kësaj baze ajrore, duke e shndëruar atë në një bazë ajrore taktike. Vlerësimi për këtë është i gjithë Aleancës dhe kjo është për meritë të forcave të armatosura të Shqipërisë, e cila ka marrë pjesë në një seri misionesh të kërkuara. Unë e lexoj vendimin e Aleancës për të modernizuar bazën e Kuçovës si një besim i Aleancës tek Shqipëria dhe tek forcat e saj të armatosura.

Stërvitja ndërkombëtare "Defender Evrope 21"

Gjeneralmajor Begaj takon ushtarakë të Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe Afrikë

Stërvitja "Defender Evrope 21" do sjellë rritjen e ndërveprueshmërisë dhe testimin e kapaciteteve operacionale

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti me 27 prill 2021, në një takim këshilltarin për nënoficerët të Komandantit të Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe Afrikë, kryekapter Robert Abernethy dhe këshilltarin për nënoficerët të Komandantit të Komandës Mbështetëse të 21 të Ushtrisë Amerikane kryekapter Sean Howard. Gjeneralmajor Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak me Komandën e Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe Afrikë, sidomos përzgjedhjen dhe zhvillimin në vendin tonë të stërvitjes "Defender Evrope 21". Me tej, u theksua për mundësitë që kjo stërvitje sjell në rritjen e ndërveprueshmërisë dhe testimin e kapaciteteve operacionale. Kjo stërvitje është edhe një mundësi e bashkëpunimit të ndërsjellë të trupës së nënoficerëve dhe rritjes së rolit të tyre si menaxherë/drejtues të stërvitjes taktike të niveleve të vogla. Në takim, gjeneralmajor Begaj shoqërohej nga këshilltari për nënoficerët, kryekapter Albert Koka. Gjatë takimit u vlerësua rëndësia e vizitës si një mundësi për forcimin e urave të komunikimit si dhe u diskutua për vazhdimësinë e shkëmbimit të eksperiencës për promovimin e trupës së nënoficerëve, rishikimit të kurrikulave të kurseve institucionale për nënoficerët si dhe trajnimin e nënoficerëve si këshilltarët kryesorë të komandantëve për çështjet e trupës së ushtarëve dhe nënoficerëve. Gjatë qëndrimit tre ditor në Shqipëri, delegacioni amerikan ka vizituar trupat pjesëmarrëse në stërvitje dhe ka zhvilluar takime me nënoficerët e Komandës së Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore. Vizita e këshilltarëve më të lartë për nënoficerët vjen në kuadër të zhvillimit në vendin tonë të Stërvitjes shumëkombëshe "Defender Evrope 21".

Intervistë me Kolonelin Joseph Scrocca

Stërvitja “Defender Europe 21” në Shqipëri

Intervistë me
Kolonelin
Joseph Scrocca,
Drejtor për
Marrëdhëniet
me Publikun
në Komandën e
Ushtrisë Ameri-
kane në Evropë
dhe Afrikë,
dhënë për DW



Kolonel Scrocca, çfarë synimesh ka stërvitja ushtarake DEFENDER-Europe 21, që pritet të zhvillohet në fillim të majit dhe do të zgjasë 45 ditë?

Kolonel Joseph Scrocca: “Defender Europe 21” është një stërvitje e përbashkët mbrojtëse shumëkombëshe e drejtuar nga Komanda në Evropë dhe ajo në Afrikë e ushtrisë së SHBA-së. Kjo stërvitje synon të ngrejë gatishmërinë dhe realizojë ndërveprimin midis ushtrisë së SHBA, NATO-s dhe ushtrive partnere, në mënyrë që bashkërisht të jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi. Po ashtu stërvitja ushtarake në fjalë synon të demonstrojë aftësinë e SHBA për të shërbyer si një partner strategjik sigurie në rajonet e Ballkanit Perëndimor dhe Detit të Zi, ndërkohë që mbështet aktivitetet tona në Evropën Veriore dhe Afrikë. Mbështetur në suksesin e kësaj stërvitjeje, vitin e kaluar, sivjet “Defender Europe 21” përfshin një numër më të madh kombesh aleate dhe partnere të NATO-s, që kryejnë aktivitete në një zonë më të gjerë sesa ajo që u planifikua në 2020-ën. Stërvitjet ushtarake si “Defender Europe 21” demonstrojnë që angazhimi i SHBA ndaj NATO-s është i pathyeshëm, i hekurt, që aleatët dhe partnerët e NATO-s janë më të fortë së bashku. Këto stërvitje janë një shembull i shkëlqyer i aftësive tona kolektive.

Sa kombe dhe trupa ushtarake do të marrin pjesë në aktivitetet e stërvitjes dhe në sa zona do të shtrihen ato?

Kolonel Joseph Scrocca: Marrin pjesë më shumë se 26 kombe dhe 28.000 trupa shumëkombëshe që do të kryejnë aktivitete pothuajse në të njëjtën kohë në më shumë



se 30 zona trajnimi, të shtrira në 12 vende.

Cilat janë aktivitetet kryesore?

Kolonel Joseph Scrocca: "Defender Europe 21" do të përfshijë disa manovra dhe aktivite ushtarake. Kryesoret janë: Përgjigja e Shpejtë (1-15 maj 2021) që ka të bëjë me operacione ajrore në Estoni, Bullgari dhe Rumania, ku do të përfshihen më shumë se 7.000 trupa nga 11 vende; Përgjigja e menjëhershme (15 maj-1 qershor) ku më shumë se 5.000 trupa nga 8 vende do të shpërndahen në 31 zona trajnimi në 12 vende të ndryshme për të kryer trajnime dhe stërvitur për të hapur zjarr realisht. Do të ketë edhe një operacion të përbashkët logjistik në bregdet; Mbrojtja kalorsiake (15 maj-fillim qershori) ku më shumë se 13.000 trupa do të kryejnë gjuajtje reale dhe operacione reale mbrojtëse me raketa si edhe një evakuim mjekësor në shkallë të gjerë; Stërvitja e Komandës post manovre (qershor 2021) ku afërsisht një personel prej 2.000 vetësh do të bëjë manovra për aftësinë e shtabit për të komanduar forca tokësore shumëkombëshe në një mjedis të përbashkët dhe të kombinuar stërvitor, ndërkohë që kryen operacione në botën reale në 104 vende në dy kontinente. "Defender Europe 21" do të ketë edhe dy ngjarje trajnimi shumë të rëndësishme: Luani Afrikan (15 maj -15 qershor) që është ngjarja vjetore më e rëndësishme stërvitore e komandës së ushtrisë amerikane në Afrikë, ku rreth 5.000 vetë, personel ushtarak, nga 24 kombe, do të stërviten për gatisshmëri mjekësore, do të kryejnë manovra në shkallë të gjerë për të gjuajtur si edhe manovra ajrore dhe detare. Këto manovra do të kryhen kryesisht në Marok: Mbrojtësi i Patundur, (15 maj-1 qershor) që është një seri e re e manovrave të NATO-s, e fokusuar në përforsimin transatlantik të Evropës dhe që demonstroi aftësinë e NATO-s për t'iu përgjigjur me shpejtësi spektrit të plotë të kërcënimeve.

Çfarë kërcënimesh dhe krizash potenciale ndaj paqes dhe sigurisë në Europë dhe Detin e Zi ka aktualisht apo mund të shfaqen?

Kolonel Joseph Scrocca: Situata e sigurisë në Evropë është bërë gjithnjë e më komplekse gjatë dekadës së fundit. Ushtria amerikane duhet në të ardhmen të jetë e gatshme të vendosë trupa, të luftojë me vendosmëri dhe të fitojë kundër çdo kundërshtari pothuajse të barabartë, në një konflikt të

përbashkët, në shumë fusha dhe me intensitet të lartë. Thënë kështu, "Defender Europe 21" është një stërvitje e përbashkët, shumëkombëshe, mbrojtëse që përfshin forcat aleate dhe partnere. Ajo nuk zhvillohet në përgjigje të ndonjë kërcënimi specifik ose kundërshtari. Ajo dhe stërvitjet tjera ushtarake që zhvillohen rregullisht të lidhura me të, janë manovra të drejtuara nga SHBA, të dizenuara për të rritur gatishmërinë dhe ndërveprimin me SHBA, aleatët dhe forcat partnere.

A ka ndonjë paralajmërim nga Rusia apo Irani lidhur me "Defender Europe 21"?

Kolonel Joseph Scrocca: Për të siguruar transparencën, SHBA informuan OSBE-në për planet lidhur

mbështetur nga imitimi në kompjuter për demonstrimin e aftësisë së SHBA në kryerjen e operacioneve sulmuese në një mjedis shumëkombësh. Kjo stërvitje do të imitojë një skenar të bazuar në përgjigjen e NATO-s, sipas nenit 5.

Shqipëria do të jetë vendi kryesor mikpritës i një stërvitjeje kaq gjigande ushtarake. Çfarë prisni nga Shqipëria që të arrihen synimet e manovrës "Defender Europe 21"?

Kolonel Joseph Scrocca: "Defender Europe 21" do të fillojë në Durrës, në javën e parë të majit. Shqipëria do të presë një stërvitje të përbashkët të logjistikës në bregdet, të njohur me inicialet JLOTS (Joint Logistics Over-the-Shore-Logjistikë e përbashkët në



me zhvillimin e stërvitjes ushtarake "Defender Europe 21" dhe do të vazhdojnë përpjekjet për të ndarë me këtë organizatë koordinimin, shkëmbimin e informacionit, në mënyrë që SHBA të përmbushin detyrimet e tyre, që burojnë nga traktati.

Çfarë kontributi jep Gjermania në "Defender Europe 21"?

Kolonel Joseph Scrocca: Këtë vit pjesa më e madhe e aktiviteteve të "Defender Europe 21" do të zhvillohen në Ballkanin Perëndimor dhe zonat pranë Detit të Zi. Gjithsesi, kemi planifikuar paraprakisht të përdorim portin e Bremerhaven në Gjermani. Por jo si një nga portet kryesore për manovrat ushtarake pasi vetëm një sasi e vogël e pajisjeve do të ngarkohet në Bremerhaven. Parashikojmë gjithashtu përdorimin e aeroporteve në Frankfurt, Nuremberg dhe Ramstein duke filluar nga ky muaj deri në fund të majit.

Përveç kësaj, Zona e Trajnimit në Grafenwoehr është planifikuar të përdoret në qershor për Stërvitjen e Komandës post manovre që është një stërvitje e asistuar, e

bregdet) e cila do t'i mundësojë ekipit të shërbimit amerikan të përdorë anije për të ngarkuar dhe shkarkuar pajisje dhe personel në porte jo të përshtatshme apo të dëmtuara si edhe në plazhe të zhveshura.

Kjo është një ngjarje e rëndësishme, sepse do të jetë hera e parë që një JLOTS ndodh në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Ky trajnim historik demonstroi aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të shërbyer si një partner strategjik i sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonet e Detit të Zi ndërkohë që ne ngrejmë gatishmërinë operacionale dhe ndërveprimin me aleatët tanë të NATO-s dhe partnerët pjesëmarrës në "Defender Europe 21", gjë që nxjerr gjithashtu në pah rëndësinë strategjike që ka Porti i Durrësit. Rreth 5.000 forca amerikane do të stërviten dhe veprojnë në Shqipëri nga muaji prill deri në qershor, të cilat do të veprojnë në vende të shumta në Shqipëri, përfshirë bazën ajrore në Kuçovë, në Farkë dhe në zonën e trajnimit në Bizë.

Flota Detare provon veten përpara stërvitjes “Defender Europe 21”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, inspektoi ditën e premte më 9 prill 2021, Bazën Detare Pashaliman, në kuadër të zhvillimit dhe angazhimit të Forcave të Armatosura në stërvitjen “Defender Europe 21”. Komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman kapiten i rangut dytë Sabri Gjinollari i uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe i informoi për rolin dhe masat e marra nga Flotila Detare në interes të pjesëmarrjes në stërvitjen Defender Europe-21 si dhe i njohu me skenarët e stërvitjes paraprahe të planëzuar.

Gjeneralmajor Bajram Begaj, i shoqëruar edhe nga komandanti i Komandës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve Bunavi kolonel Ferdinand Dimo, pasi vlerësoi efektivat e Bazës Detare për përmbushjen me sukses të detyrave, angazhimit dhe vazhdueshmë të tyre në ndihmë të komunitetit gjatë emergjencave civile, ndau me ta momente të caktuara të zhvillimit dhe angazhimit të Forcave të Armatosura në përgatitjet e stërvitjes “Defender Europe 21”.

“Kanë filluar dhe janë në proces, jo vetëm në planin ushtarak, por edhe në atë kombëtar, përgatitjet për zhvillimin e stërvitjes “Defender Europe 21”. Stërvitja është një demonstrim i aftësisë dhe vullnetit të SHBA për angazhimin në mbrojtjen e aleatëve evropianë në kuadrin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive. Në këtë stërvitje të madhe përfshihet edhe vendi ynë dhe Forcat tona të Armatosura, krahas disa vendeve të tjera të Aleancës. Në këto kushte, ky është më shumë se një eveniment ushtarak që kërkon dhe meriton vëmendje, përgjegjësi, përkushtim dhe angazhim maksimal profesional, dhe jo vetëm...”, theksoi gjeneralmajor Begaj.

Më tej SHSHPPFA u ndal në vëmendjen dhe vlerësimin që aleati

Në stërvitjen detare të zhvilluar në Gjirin e Dukatit morën pjesë 7 anije: P-132 “Oriku”, P-134 “Butrinti”, P-116 “Bora”, P-112 “Skënderbe”, P-02 “Mati”, P-03 “Shkumbini”, Y-32 “Karaburuni”



ynë strategjik SHBA ka vendosur për zhvillimin e kësaj stërvitje edhe në ujërat tona territoriale si dhe përdorimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve tona portuale. “Flotila juaj Detare ka një pjesëmarrje dhe angazhim më shumë se të konsiderueshëm në këtë stërvitje. Ky është një rast i veçantë për të përfutur eksperiencën dhe përvojën të vlefshme në angazhime të tilla të mëdha, por edhe një detyrim dhe përgjegjësi për përgatitjet të gjithanshme serioze për një angazhim dhe përfaqësim dinjitoz të aftësive operacionale e profesionale të Forcës tonë Detare...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Më pas të ftuarit ndoqën stërvitjen përgatitore, e cila u zhvillua në det në rajonin e Gjirit të Dukatit. Në stërvitjen morën pjesë gjithsej 7 (shtatë) anije të Flotiljes Detare: P-132 “Oriku”, P-134 “Butrinti”, P-116 “Bora”, P-112 “Skënderbe”, P-02 “Mati”, P-03 “Shkumbini”, Y-32 “Karaburuni”, dy gomone të anijeve të klasit Iliria dhe një skuadër e Grupit të Bordingut. Në stërvitjen provë u realizuan të gjithë skenarët

e planëzuar për t'u zhvilluar nga efektivat dhe mjetet e Forcës Detare gjatë stërvitjes Defender Europe 21, duke u fokusuar në elementët stërvitorë si, shoqërimi, ruajtja dhe siguri i anijes së rëndësishme së veçantë, kryerja e operacionit të bordimit, kryerja e operacionit të antindotjes detare, parakalimi në formacion i grup-anijeve të Flotiljes Detare. Në përfundim të elementëve stërvitorë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe pjesëmarrësit u imbarkuan në anijen P-132 “Oriku” dhe realizuan një dalje në det në Gjirin e Dukatit për të ndjekur nga afër fazën përmbyllëse të stërvitjes gjatë së cilës u zhvillua parakalimi në revistë i të gjitha anijeve të angazhuara. Duke përfunduar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, i siguroi ata për vëmendjen dhe mbështetjen e tij dhe të ministrit të Mbrojtjes me burime financiare për përmbushjen e misionit, zhvillimit të kapaciteteve, marrjen e masave konkrete për rritjen e motivimit dhe dinjitetit të ushtarakëve, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës.

Bashkëpunim bilateral, por edhe bashkëpunim në kuadër të NATO-s

Bashkëpunimi ushtarak me Turqinë shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, shëndetësisë, modernizimit, logjistikës dhe misionëve të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Bajram Begaj zhvilloi një takim me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë Murat Ahmet Yörük dhe atasheun ushtarak turk kolonel Kablay. Gjeneralmajor Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misionëve dhe aktiviteteve të NATO-s. Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, shëndetësisë, modernizimit, logjistikës dhe misionëve të NATO-s,

konkretisht kontingjenti i përbashkët ushtarak që shërben në Hamid Karzai International Airport, në Kabul, Afganistan. Gjeneralmajor Begaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e edukimit të brezave të rinj si dhe ushtarakëve të gradave të ulëta dhe të larta në kurset dhe akademitë turke, si një kontribut për zhvillimin e lidërshiptit. Të dy bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve, sipas planeve të bashkëpunimit ushtarak bilateral si dhe atyre në kuadër të NATO dhe iniciativave rajonale.



“Defender Europe 21”

Vaksinohen ushtarakët shqiptarë për stërvitjen

“Filloi vaksinimi i ushtarakëve shqiptarë, me prioritet trupat që do të marrin pjesë në stërvitjen e madhe ushtarake “Defender Europe 2021”. Përveç protokolleve shëndetësore anti-Covid të hartuara enkas për këtë stërvitje, çdo ushtarak shqiptar dhe i huaj do të jetë i vaksinuar për të garantuar edhe mbrojtje shëndetësore gjatë “Defender Europe 21”, -shkruan ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në facebook.

Sipas kolonelit Beqir Tafili, Drejtor i Drejtorisë të Operacioneve dhe Stërvitjes (J-3/7) në SHPFA, në total, FA-të do të angazhojnë gjithsej 15 struktura ushtarake, GBKL/b2k; CIMIC; EOD; CBRN; Xhenio

QKR/FAJ; SHPFA/QBO; EOD nënujore; baza ajrore Farkë, FD me 10 anije/ekuipezhe; Policia Ushtarake, Seti Fushor i KM-së; kompani komando; Grup special/ SOTU, AFA, me më shumë se 1000 trupa”.

Stërvitja “Defender Europe 21”, e cila zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021, drejtohet nga Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do drejtojë stërvitjen “Defender Europe 21” ku marrin pjesë: Shqipëria, Kanada, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj.



Batalioni i Tretë i Këmbësorisë

Përfundon Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë në Forcën Tokësore

Në ambientet e Batalionit të Parë dhe të Batalionit të Tretë të Këmbësorisë u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Stërvitjes Individuale Bazë. Ky kurs, i cili filloi në datën 3 mars dhe zgjati deri në 23 prill, u zhvillua në ambientet e poligonit stërvitore nga efektivet e këtyre batalioneve. Në këtë kurs u trajnuan 100 rekrutë të rinj, ku një pjesë e konsiderueshme do t'i bashkohen Forcës Tokësore. Programi stërvitor i këtij kursi u zhvillua në zbatim të protokollare anti-COVID 19. Përgjatë shtatë javëve, rekrutët u trajnuan me intensitet të lartë duke u njohur me të gjitha rregullat e jetës ushtarake duke i kthyer ata nga qytetarë të thjeshtë në efektive të mirë përgatitur dhe të mirëtrajnuar nën uniformë. Eksperienca dhe profesionalizmi i trupës së instruktorëve në të dyja batalionet bëri të mundur përfundimin e këtij kursi me sukses. Forca Tokësore do të japë kontributin e saj në edukimin e brezit të ri të rekrutëve duke dhënë përvojën e saj të fituar në misionet dhe trajnime.



Stërvitja e madhe e NATO-s “Defender Europe 2021”

**Ankorohet anija e parë amerikane
USAV MG CHARLES (LSV-5)**





Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do të drejtojë stërvitjen e koduar "Defender Europe 21"



A nija e parë amerikane USAV MG CHARLES (LSV-5) është ankoruar pasditen e ditës së premte, më 16 prill 2021, në portin e Durësit, ku ka nisur zbarkimi i trupave ushtarake dhe logjistikës së nevojshme që do të përdoret në stërvitjen më të madhe ndërkombëtare "Defender Europe 2021", që zhvillohet edhe në territorin e vendit tonë. Kalatat 1, 2 dhe 3 të portit do të jenë në funksion të kësaj stërvitjeje. Stërvitja ndërkombëtare "Defender Europe 2021" do të zhvillohet përgjatë një muaji e gjysëm (në maj deri në mes të qershorit) dhe do të shtrihet thuhet në të gjitha bazat tokësore, detare apo ajrore të Shqipërisë, nga veriu në jug. Stërvitja ushtarake do të zhvillohet nga 1 maj-14 qershor të këtij viti dhe do të shtrihet në disa vende të Ballkanit dhe të Detit të Zi. Stërvitja "Defender Europe 21" zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me palën amerikane dhe është në vazhden e partneritetit të fortë strategjik që vendi ynë ka me SHBA-në, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do të drejtojë stërvitjen e koduar "Defender Europe 21". Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë stërvitje do të jetë demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura për të pritur, koordinuar dhe për t'u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe ato të NATO-s, në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks.

Në turin e takimeve në kuadër të ristrukturimit të Forcave të Armatosura, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, i shoqëruar edhe nga Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantët e reparteve vartëse, ka zhvilluar paraditen e datës 16 prill 2021, një takim me strukturat e Komandës së Forcës Tokësore.

Fjalën përshëndetëse e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe të ftuarit për praninë e tyre në këtë ceremoni. Në fjalën e tij, ndër të tjera ai theksoi: "Forca Tokësore si një ndër njësitë kryesore të Forcave të Armatosura, me kapacitetin njerëzor, përgatitjen operacionale, eksperiencën e fituar gjatë angazhimeve në stërvitjet dhe operacionet e ndryshme si brenda dhe jashtë vendit, është e aftë të harmonizojë të gjitha këto avantazhe në përballimin e sfidave dhe përmbushjen me sukses të misionit të saj." Ai garantoj se do të jetë gjithmonë në krye të punës dhe sfidave që koha do të sjellë për Forcën Tokësore dhe repartet e vartësisë.

Pasi i ka falënderuar për përkushtimin dhe përgjegjësinë e treguar në realizimin e detyrave dhe objektivave kudo që kudoherë që është kërkuar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, u shpreh: "Rikthehem sot këtu, pas disa takimeve në disa struktura të FT-së, por edhe të FA-së, për të konfirmuar se ndryshimet dhe riorganizimet strukturore të kryera në disa formacione ushtarake të FT-së, besojmë se do të përmirësojnë dhe rrisin efektivitetin operacional dhe funksional të tyre. Profesionalizëm, sakrificë, sfidë, unitet dhe kohezion-këto janë parimet dhe cilësitë që kërkohen për të konsoliduar strukturën dhe forcën tuaj dhe për të siguruar suksesin në kryerjen e detyrave të vështira në misione, operacione, stërvitje dhe çdo aktivitet tjetër ushtarak."

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj duke u ndalur në këto ndryshime vuri theksin se ato i shërbejnë reformimit të mëtejshme të Forcave tona të Armatosura, bazuar edhe në mësimet e nxjerra si anëtar i Aleancës dhe kontribues në misionet e operacionet e saj. "Ndryshimet e kryera janë edhe një reformim i mëtejshëm i forcës tonë ushtarake, bazuar edhe në vetë NATO-n, gjatë vitit 2020, sikurse shprehet Sekretari i Përgjithshëm në raportin vjetor të këtij viti, ka bërë ndryshime të strukturës organizative të komandës



SHSHPFA takim me strukturat e Komandës së Forcës Tokësore

Forca Tokësore mban peshën kryesore në "Defender Europe-21"



Kjo stërvitje është demonstrim i aftësisë dhe vullnetit të SHBA-së për angazhimin në mbrojtjen e aleatëve europianë në kuadrin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive

së saj, për ta përshtatur atë me një mjedis të sigurisë në ndryshim të shpejtë dhe të vazhdueshëm".

Procesi i konsolidimit të funksionimit të strukturës së re organizative të Forcës Tokësore, koincidon edhe me zhvillimin e stërvitjes "Defender Europe - 21" dhe Forcat e Armatosura shqiptare janë në përgatitje intensive jo vetëm në planin ushtarak por edhe në nivel kombëtar. "Kjo stërvitje, ku marrin pjesë edhe disa vende të tjera të Aleancës, është një demonstrim i aftësisë dhe vullnetit të SHBA-së për angazhimin në mbrojtjen e aleatëve europianë në kuadrin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive. Në këto kushte, ky është më shumë se një eveniment ushtarak që kërkon dhe meriton vëmendje, përgjegjësi, përkushtim dhe angazhim maksimal profesional, dhe jo vetëm..." - theksoi gjeneralmajor Begaj. "Forca Tokësore, u shpreh më tej gjeneralmajor Begaj, mban peshën kryesore, më shumë se të konsiderueshme, të pjesëmarrjes dhe angazhimit ushtarak të vendit tonë në këtë stërvitje. Ky është një rast i veçantë për të përfutur eksperiencën dhe përvojën të vlefshme në angazhime të tilla të mëdha, por

edhe një detyrim dhe përgjegjësi për përgatitje të gjithanshme serioze, për një përfaqësim dinjitoz të aftësive operacionale e profesionale të të gjithë forcave tona pjesëmarrëse në këtë lëvizje masive të aleatëve".

Në vijim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj u shpreh besimplotë në përgjegjësinë, aftësinë, përkushtimin dhe profesionalizmin e kësaj strukture dhe risolli në vëmendje faktin se Forca Tokësore ka mbajtur dhe do të vazhdojë të mbajë edhe ngarkesën më të madhe të përmbushjes së detyrave për nevojat e brendshme të vendit por edhe për detyrimet euro-atlantike të tij. Në përfundim të fjalës së tij në këtë takim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj i siguroi ata se veçanërisht Forca Tokësore, por edhe Forca e Armatosur, do të kenë një vëmendje të shtuar për mbështetje, përmirësime cilësore dhe motivime të tjera domethënëse. Ceremonia e rreshtimit organik u mbyll me parakalimin ceremonial të Flamurit Luftarak të Forcës Tokësore.

Në mjediset e Forcës Tokësore (FT), u zhvillua trajnimi i mirëmbajtjes së mjeteve të blinduara tip HMMWV (High Mobility Multipurpose Wheeled Vehicle). Në këtë trajnim morën pjesë efektivët e Batalionit të Dytë të Këmbësorisë (b2k) dhe grupi i instruktorëve amerikanë të Njesisë së Lëvizshme dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve nga Garda e New Jersey-it. Në kursin, për mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara tip HMMWV, morën pjesë 20 ushtarakë.

Ky trajnim si aktivitet i një rëndësie të veçantë, ka impakt të jashtëzakonshëm në rritjen profesionale të efektivëve ushtarakë shqiptarë, të cilët janë të angazhuar çdo ditë gjatë punës së tyre, në përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të këtij lloji.

Trajnimi vjen rishtazi pas dhurimit të 29 Automjeteve Ushtarake të Lëvizshmërisë së Lartë, (HMMWV) dhe në vijimësi të një numri të shumtë trajnimesh, me të cilat qeveria dhe ushtria amerikane kanë mbështetur prej vitesh tashmë Forcat e Armatosura shqiptare.

Trajnimi i efektivëve të b2k-së është tepër i nevojshëm, duke qenë se ky batalion, si bërthama e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, i ka mjetet HMMWV pjesë të organikës së tij. Njohuritë e marra nga efektivët, pjesëmarrës në këtë trajnim, do të rrisin edhe më tej profesionalizmin dhe nivelin e gatishmërisë profesionale të këtij batalioni.

Dhurimi i 29 Automjeteve Ushtarake të Lëvizshmërisë së Lartë (HMMWV) nga qeveria amerikane u bë më 24 mars 2021. Në ceremoninë e zhvilluar morën pjesë ministri Peleshi dhe ambasadoria e SHBA-së, Yuri Kim. "Ndihma materiale, teknike dhe modernizuese e SHBA-së, i ka dhënë dhe u jep ushtarakëve tanë më shumë fuqi, forcë dhe efektivitet në operacionet brenda dhe jashtë vendit", -tha Peleshi. Kurse ambasadoria e SHBA-së, Yuri Kim u shpreh se: "Shqipëria i përgjigjet detyrës, duke qenë gjithmonë në krah të SHBA-së, pavarësisht sa të rrezikshme janë misionet, pavarësisht sa larg shtëpisë". Dhurimin e 29 mjeteve të reja, ajo e konsideroi si një donacion të rëndësishëm në prag të "Defender Europe 21", stërvitjes ushtarake më të madhe në Europën Juglindore.

Amerikanët e Gardës së New Jersey-it trajnojnë efektivët për mjetet e blinduara

Zëvendëskomandanti i Forcave Ajrore, kolonel Ylli Pulaj takohet me përfaqësues të personelit femër në uniformë dhe ato civile, pjesë e strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit



Ekspertët amerikanë një javë në Komandën e Forcës Ajrore

Ekipi i ushtarakëve amerikanë nga Garda Kombëtare e New Jersey, zhvilloi një vizitë pune një javore në Komandën e Forcës Ajrore dhe strukturat e saj të vartësisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte mbështetja për realizimin e projekteve për trajnimin e pilotëve, teknikëve dhe specialistëve të Forcës Ajrore për përdorimin nga Forca Ajrore të dy helikopterëve UH-60A Black Hawk, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i dorëzojnë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ekipi amerikan zhvilloi një takim të veçantë pune me drejtues, ekspertë dhe efektivin pilot e teknik në Bazën Ajrore Farkë, të cilët shkëmbyen informacione të rëndësishme që lidhen me pilotimin, mjetet e teknikën ajrore si dhe administrimin e mirëmbajtjen e tyre.

Në takimin e ekipit të Gardës Kombëtare të New Jersey me zëvendëskomandantin e Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, u theksua rëndësia e bashkëpunimit në të ardhmen me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, duke pasur në fokus projektet e nisura me SHBA-në, por edhe bashkëpunime të tjera në interes të modernizimit të Forcës Ajrore.



Kursi i Stërvitjes Individuale në Shkollën e Trupës, Bunavi, Vlorë

Shtohen radhët: Certifikohen 141 rekrutë për Forcat e Armatosura

Gjeneralmajor Bajram Begaj: “Ju e nisni rrugëtimin tuaj në shërbimin fisnik të ushtarit, në prag të stërvitjes më të madhe ushtarake të SHBA-së dhe aleatëve të NATO-s, ku merr pjesë vendi ynë dhe Forcat tona të Armatosura, “Defender Europe 21”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë ditën e hënë më 19 prill 2021, në ceremoninë e certifikimit të 141 rekrutëve të rinj të Kursit të Stërvitjes Individuale në Shkollën e Trupës, Bunavi, Vlorë. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm gjithashtu komandanti i Komandës së Doktrinës, gjeneral brigade Albert Mullai, dhe drejtorë drejtorish në SHP. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, në përshëndetjen e veçantë drejtuar kursantëve u shpreh se: “Kam ardhur me një interes të veçantë sot këtu dhe kjo është për disa arsye. E para, sepse është një ditë e veçantë për ju, efektivët e ushtarëve rinj, që përfunduat përgatitjen tuaj individuale dhe do të betoheni si ushtarakët më të rinj të Forcave të Armatosura; e dyta, se këtë stërvitje e keni kryer në kushte të vështira, të pandemisë së COVID-it dhe e treta, sepse ju e nisni rrugëtimin tuaj në shërbimin fisnik të ushtarit në forcën ushtarake të vendit tuaj, në prag

të stërvitjes më të madhe ushtarake të SHBA-së dhe aleatëve të NATO-s, ku merr pjesë vendi ynë dhe Forcat tona të Armatosura, “Defender Europe 21”. Më tej gjeneralmajor Begaj, i siguroi ata se, pavarësisht vështirësive dhe pengesave që ka krijuar pandemia, Forcat e Armatosura do të kenë vëmendje të veçantë dhe zhvillime pozitive gjatë këtij viti e në vijim. “Ju do të keni mundësi të merrni eksperiencë të reja, që nesër t’ju mundësojnë ta gjeni veten edhe në radhët e nënoficerëve dhe oficerëve të ardhshëm. Në vështrim të përbërjes tuaj, ku të paktën 10 përqind janë vajza, duke vlerësuar me konsideratë të veçanta ambicien dhe pasionin e tyre për profesionin ushtarak, do të theksoja që kjo është domethënëse dhe na bën të gjithëve të ndjehemi më optimistë për perspektivën e Forcave të Armatosura”. Duke përfunduar, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor prof.asoc. Bajram Begaj, u shpreh besimplotë për dinamizmin dhe gjallërinë që ushtarët e rinj do t’i japin punës aty ku do të shërbejnë, si dhe risolli në vëmendje kujdesin maksimal për zbatimin e masave për ruajtjen nga COVID-19.

Për rekrutët, të cilët gjatë kursit janë dalluar për arritje të larta në disiplinë, në stërvitje si dhe në jetën e përditshme në repart, u ndanë certifikata vlerësimi. Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë në Shkollën e Trupës në Bunavi, Vlorë, filloi më 3 mars 2021 dhe përfundoi më 19 prill 2021, ku 141 rekrutë të rinj përfunduan me sukses këtë kurs, nga të cilët 14 ishin vajza.



Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë dhe batalioneve të këmbësorisë të Forcës Tokësore, Poshnje dhe Vau i Dejës, u zhvilluan ceremonitë e certifikimit dhe Betimit të rekrutëve që përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 241 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, tashmë pjesë e Forcave tona të Armatosura.

Në ceremoninë e organizuar në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, morën pjesë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Prof. asoc. Bajram Begaj, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Albert Mullai, komandanti i FD gjeneral brigade Ilir Xhebexhia dhe drejtorë drejtorish në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti Komandanti i QAPU, kolonel Ferdinand Dima, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe personelin trajnues, ku ndër të tjera theksoi: "Ndihe mi krenar për produktin e punës suaj, për këtë forcë të madhe ushtarake që keni stërvitur, për përpjekjet e vazhdueshme tuaja në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara në procesin stërvitor, për gjithçka që ju keni bërë për edukimin

FA: Konsolidohet sistemi i stërvitjes individuale bazë

Gjeneralmajor Bajram Begaj: "Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për t'i qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit"



e këtyre të rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura".

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura falënderoi të gjithë personelin e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve për punën e deritanishme dhe në veçanti rekrutët e sapo certifikuar: "Ju shpreh mirënjohjen time për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar, për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes pavarësisht situatës së vështirë të krijuar nga pandemia e "Covid-19". Jam i sigurt se dijet dhe

aftësitë e fituara në këtë stërvitje do t'ju shërbejnë për të realizuar me sukses detyrat në repartet e Forcave të Armatosura ku do të shërbeni. Dita e sotme është e veçantë për Ju, pasi do të betoheni si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për ti qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit", përfundoi përshëndetjen gjeneral major Begaj". Mes urimeve më të mira, rekrutët u përçollën nga Bunavia për në repartet e Forcave të Armatosura.

Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit, kurs i cili zgjati 4 muaj, trajnim intensiv në mjediset e reja bashkëkohore të Qendrës së Stërvitjes. Në këtë kurs u trajnuan 13 kursantë, 3 femra dhe 10 meshkuj. Qëllimi i këtij kursi ishte trajnimi në tërësi të oficerit të ardhshëm, osedetyrat në jësuar me të, në specialitetin Këmbësori.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral

Pas trajnimit 4-mujor përfundon Kursi Bazë i Oficerit

Në këtë kurs u trajnuan 13 kursantë, 3 femra dhe 10 meshkuj

brigade Arben Kingji, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Ilirjan Dauti dhe komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Eklend Dauti. Në fjalën e tij përshëndetëse, kolonel Dauti theksoi se: "Stafimësimdhënës i kësaj qendre

do të bëjë gjithnjë vlerësim real sipas meritës së gjithsecilit, duke mos u bërë pjesë e formalitetit. "Gjeneralbrigade Kingji falenderoi stafin për punën e palodhurdhe përkushtimin e treguar për përgatitjen e brezave ndër vite.

Ambasada e SHBA-së ka uruar përvjetorin e 12-të të Shqipërisë në NATO duke kujtuar fjalët e ish-Presidentit George W. Bush gjatë vizitës historike në Tiranë në 2007. Atëherë Bush thoshte se Shqipëria është një mike e besuar dhe aleate e fortë, dhe mund të mbështetet tek SHBA. Shqipëria u anëtarësua më 1 prill të 2009 në NATO.

Nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare, në "Facebook", Ambasada SHBA-së në Shqipëri citon fjalët e ish-Presidentit George W. Bush: Shqipëria është një mike e besuar dhe një aleate e fortë. Dhe shpresoj se vizita e sotme do të dërgojë tek populli shqiptar mesazhin se ju mund të mbështeteni tek Amerika, ashtu si Amerika mund të mbështetet tek ju, për të punuar fort për të përhapur lirinë dhe, si rrjedhojë, paqen," -deklaroi ish-Presidenti i Shteteve të Bashkuara George W. Bush, gjatë vizitës së tij historike në Tiranë, më 10 qershor 2007, teksa Shqipëria përgatitej të hynte në NATO. Sot, Shqipëria feston 12 vite anëtarësim në NATO dhe Shqipëria mund të mbështetet tek Shtetet e Bashkuara, ashtu si Shtetet e Bashkuara mund të mbështeten tek Shqipëria më shumë se kurrë. Gëzuar përvjetorin e 12-të, Shqipëri!

Ndërkohë, Ambasadorja amerikane Yuri Kim, deklaroi më 31 mars, në Konferencën "Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, në të shkuarën,

Yuri Kim: SHBA e përkushtuar për të ardhmen e begatë të Shqipërisë



të tashmen dhe të ardhmen", se: "Gjatë tridhjetë viteve të shkuara, marrëdhëniet SHBA-Shqipëri kanë përparuar dhe janë rritur. Shtetet e Bashkuara kanë qenë një partner i fortë, aleat dhe mik i Shqipërisë teksa Shqipëria forcon demokracinë e saj, hap ekonominë dhe ofron mundësi për të gjithë njerëzit e saj. Shtetet e Bashkuara mbështesin synimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian, siç bënë edhe kur mbështetën kërkesën e Shqipërisë për anëtarësim në

NATO. Shtetet e Bashkuara janë një mbështetëse e palëkundur në përpjekjet e Shqipërisë për të zbatuar reformën në drejtësi, për të forcuar sundimin e ligjit dhe qeverisjen dhe për të krijuar kushtet për rritje gjithëpërfshirëse ekonomike. Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për një të ardhme demokratike, të sigurt dhe të begatë për Shqipërinë, si një anëtare me të drejta të plota e Bashkimit Europian, për të mirën e qytetarëve të saj dhe të gjithë rajonit".

Shqipëria ka zënë vendin e saj në Aleancën e NATO-s



Për përvjetorin e 12-të të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO ka reaguar edhe ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, i cili nëpërmjet një postimi në Facebook, shkruan se Shqipëria ka zënë vendin e saj në Aleancën e NATO-s, jo thjesht si një vend anëtar formal, por tashmë si një partner i dobishëm e i besueshëm.

"Prej 12 vitesh, Shqipëria ka zënë vendin e saj në Aleancën e NATO-s,

jo thjesht si një vend anëtar formal, por tashmë si një partner i dobishëm e i besueshëm. Nuk ka shembull më të dukshëm të kësaj dobie e besueshmërie, sesa rritja dhe përsosja e EOD, një strukturë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, e cila ka bërë emër të mirë dhe e ka nderuar vendin tonë në gjirin e NATO-s me suksesin e saj", -shprehët ministri Peleshi në postimin e tij në "Facebook".

Shqipëria 12 vite në NATO

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Periudha 12-vjeçare është një histori e vërtetë suksesi dhe eksperiencash për Forcat tona të Armatosura

Në kuadër të 12 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, zgjodhi t'a ndante urimin e tij me strukturat e Batalionit të Tretë të Këmbësonisë, si një nga strukturat e rëndësishme të Forcës Tokësore.

Një rrugëtim historik dhe sfidues, i filluar që në vitin 1994, kur Shqipëria u bë anëtare e Partneritetit për Paqe të NATO-s dhe i kurorëzuar me anëtarësimin e plotë në Aleancë më 1 Prill 2009. Gjatë këtyre 12 viteve Shqipëria, padyshim e ndihmuar edhe nga statusi i saj si një vend anëtar i NATO-s, e ka konsoliduar rolin e saj si një shtyllë e stabilitetit në rajon, duke kontribuar në misionet e saj, në shërbim të paqes dhe sigurisë në botë. Forcat e Armatosura, burrat dhe gratë nën uniformë dhe brezat e Forcave të Armatosura, që punuan ndër vite me përkushtim, bënë të mundur futjen e Shqipërisë në familjen e madhe të vlerave të lirisë dhe për herë të parë në histori i krijuan vendit mundësinë dhe të drejtën për të qenë të barabartë, në një tryezë kaq të rëndësishme të vendimmarrjes botërore. "Sot për të gjithë ne është një ditë e veçantë. Shqipëria sot mbush 12 vite si anëtar i Aleancës. Kjo periudhë 12-vjeçare është një histori e vërtetë suksesi dhe eksperiencash për Forcat tona të Armatosura. Sigurisht që është një ditë krenarie, por veçanërisht reflektimi. Objektivi ynë mbetet zhvillimi dhe mbajtja e kapaciteteve operacionale ushtarake të nevojshme për t'i u përgjigjur në kohë nevojave të brendshme dhe për të siguruar kontribute ushtarake modeste, por dinjitoze për Aleancën dhe më tej për BE, OKB dhe koalicionet e mundshme".

"Forcat tona të Armatosura", -u shpreh gjeneralmajor Begaj -"kanë përjetuar ndryshime rrënjësore pas anëtarësimit në NATO në aspektin organizativ, në strukturën e personelit, në konceptimin e misionit, në edukim dhe trajnim, në modernizim dhe në angazhimet në operacione, por jo vetëm".

Më tej gjatë fjalës së tij, ai listoi disa zhvillimeve të tjera pozitive si zgjerimin e hartës dhe përmirësimin cilësor të kontributit të FARSH në misionet e Aleancës e më gjerë, rritjen e personelit femër në uniformë; trendin rritës të buxhetit



të mbrojtjes; reformatimin dhe konsolidimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit ushtarak; si dhe vuri theksin në startimin e zbatimit të projektit të Bazës Ajrore të Kuçovës. "Vendimi i NATO për investimin në Kuçovë është një deklaratë publike e Aleancës për vlerësimin e rolit në rritje të Shqipërisë dhe të forcës së saj ushtarake, për sigurinë në rajon dhe më gjerë. Me këtë rast, unë do të dëshiroja t'ju shprehja publikisht mirënjohjen dhe falënderimin të gjithë atyre civilëve dhe

ushtarakëve tanë dhe të aleatëve, që kanë kontribuar në vite për këto arritje", - theksoi SHSHHPFA në fjalën e tij. Në përfundim të takimit të tij me strukturat e Batalionit të Tretë të Këmbësonisë, SHSHHPFA i siguroi ata se vëmendja dhe mbështetja e tij dhe e Ministrit të Mbrojtjes do jetë e pakursyer për përmbushjen e misionit, zhvillimit të kapaciteteve si dhe masave konkrete për rritjen e motivimin dhe dinjitetit të ushtarakëve, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës.

Xhaçka: Shqipëria ia ka dalë të fitojë besimin e aleatëve

Ministria për Evropë dhe Punë të Jashtme dhe ish Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, kapërkujtuar 12-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Ministria Xhaçka deklaroi se gjatë këtyre viteve, Shqipëria ia ka dalë të fitojë besimin e aleatëve si partnerë të besueshëm dhe kontribues seriozë në sigurinë kolektive të Aleancës. Kryediplomatja Xhaçka e cila ka mbajtur për një periudhë tre vjeçare (shtator 2017-dhjetor 2020), postin e lartë të ministres së Mbrojtjes, theksoi se sfida e radhëse vendit mbetet integritetin e Bashkimit Europian. "Me shumë punë e shumë përkushtim edhe kjo sfidë do të fitohet hap pas hapi, duke filluar nga mbajtja e Konferencës së Parë Ndërqeveritare brenda këtij viti", -u shpreh ministria në "Facebook".



Intervistë me kolonel Beqir Tafili, drejtor i J-3/7 në SHPFA

“Defender Europe 21”: Gatishmëri, ndërveprueshmëri dhe operacionalitet

Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do drejtojë stërvitjen “Defender Europe 21” ku marrin pjesë: Shqipëria, Kanada, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj.

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Stërvitja “Defender Europe 21”, që do të mbahet në vendin tonë, është e një rëndësie strategjike dhe ajo zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me palën amerikane, në vazhden e partneritetit të fortë strategjik që vendi ynë ka me SHBA-në, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do të drejtojë paketën e stërvitjeve të koduar “Defender Europe 21” dhe pjesë e kësaj pakete do të jetë pjesëmarrja e forcave të vendeve aleate dhe partnere, si: Kanada, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Turqia etj. Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë stërvitje do të jetë demonstrimi i aftësive të FA-së për të pritur, koordinuar dhe për t’u stërvitur e trajnuar me forcat

amerikane dhe ato të NATO-s, në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks. Ndërkohë, pjesëmarrja e FARSH në këtë paketë stërvitjesh ndikon në rritjen e aftësive operacionale të trupave tona, veçanërisht të disa prej njësive dhe reparteve tona të deklaruar në NATO. Ndërveprueshmëria, integrimi i strukturave tona dhe zhvillimi i aktivitetit të përbashkët stërvitor do të përcjellë mesazhe të shumëfishta me impakt strategjik në fushën e bashkëpunimit, sigurisë dhe mbrojtjes dhe do të jetë një mundësi e shkëlqyer për promovimin e vlerave të FA-së në komunitet. Kur kanë mbetur dhe pak ditë nga fillimi i stërvitjes, intervistuar për shtypin ushtarak kolonelin Beqir Tafili, Drejtor i Drejtorisë të Operacioneve dhe Stërvitjes (J-3/7) në SHPFA.

Shqipëria do të jetë vendi mikpritës i Stërvitjes “Defender Europe 21”, që është një stërvitje me trupa të ushtrisë amerikane por që konsiderohet edhe si një nga stërvitjet më të mëdha në Europë që nga viti 1995. Stërvitja do të zhvillohet nga 1 maji deri më 14 qershor 2021. Sot që po flasim deri ku jeni me përgatitjet për organizimin e kësaj stërvitjeje kaq të madhe ushtarake?

Në fakt do të doja të bëja një sqarim, lidhur me pyetjen pasi në Evropë por edhe në disa vende të Ballkanit (Kroaci; Slloveni, madje dhe në Maqedoninë e Veriut) Komanda Amerikane, Evropë, ka zhvilluar stërvitje të këtyre përmasave, ndër vite. Kurse për ne, është hera e parë që një stërvitje e përmasave të tilla të zhvillohet në territorin e vendit tonë, në hapësirën detare dhe në hapësirën tonë ajrore. Gjithsesi, për t’u kthyer tek pyetja juaj, përgatitjet e “Defender Europe 21”, të cilat kanë filluar që në tetor 2019, janë pothuajse në koordinimin e detajeve të fundit.

Për të krijuar infrastrukturën dhe kushtet e zhvillimit të stërvitjes, FARSH do të vendosin në dispozicion të saj, hapësirën tonë ajrore për kryerjen e operacioneve ajrore, hapësirën detare për kryerjen e operacioneve detare dhe 11 poligone e destinacione të ndryshme të shpërndara në të gjithë territorin e RSH, ku përfshihen, porte, aeroporte, terrene stërvitore, poligone; infrastrukturë kritike etj, për kryerjen e stërvitjes/operacioneve tokësore.

Paketa ligjore është tashmë e miratuar



në Parlamentin e RSH dhe ligji për zhvillimin në vendin tonë të stërvitjes "Defender Europe 21" është efektiv duke filluar nga data 1 prill 2021. Gjithashtu jemi në fazën e nënshkrimit të Marrëveshjes teknike midis Komandës Amerikane, Evropë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, marrëveshje e cila parashikon detajet mbi detyrimet e palëve.

Planëzimi i stërvitjes i cili drejtohet nga SHPFA, me qëllim realizimin e disa objektivave strategjike, është fokusuar në 4 drejtime kryesore: planëzim dhe përgatitje për strukturat tona të cilat do të stërviten brenda vendit, në ambient kompleks, "Comined-Joint"; planëzim për strukturat tona të cilat do të stërviten në kuadër të "Defender Europe 21" dhe të stërvitjes së NATO-s "Steadfast Defender 21", jashtë vendit; planëzim për të testuar kapacitetet tona kombëtare strategjike, aeroportin ndërkombëtar Nënë Tereza; Portin e Durrësit; Poligonin Kombëtar Bizë etj; planëzim për integrimin, vendosjen në dispozicion të palës amerikane të infrastrukturës dhe poligoneve; planëzim për pritjen, mbështetjen, organizimin dhe koordinimin e lëvizjeve në territorin e vendit tonë.

Nuk dëshiroj të futem në detaje të skenarit dhe të planëzimit të stërvitjes, por do të doja të përmendja disa elementë të cilët do të ngrihen për menaxhimin e stërvitjes brenda vendit tonë: Për Komandim-Kontrollin dhe menaxhimin e stërvitjes, në SHPFA por edhe në komandat e forcave janë ngritur strukturat e Kontrollit të Stërvitjes (EXCON) të cilat aktualisht janë në fazën e trajnimit familjarizues. Trajnimi ka si objektiv, familjarizimin me postet, rolet dhe me detyrat respektive që do të kenë këto struktura në funksion të menaxhimit të stërvitjes. Për pritjen dhe procesimin e trupave amerikane të cilët vijnë nëpërmjet aeroportit Nënë Tereza, në komandën Ajrore dhe PU, nga ana jonë do të ngrihet, zona e pritjes "Staging Area"; Për të mbështetur operacionet në portin e durrësit është planizuar për tu ngritur Terminali Operacional, ku Kalata Nr.1 dhe Kalata Nr.2 e Portit të Durrësit, janë tashmë të rezervuara, për kryerjen e operacioneve portuale. Përveç Terminalit Operacional, me qëllim mbështetjen logjistike dhe administrative të forcave të luftimit, janë planëzuar që të ngrihen dy (2) Zona të mëdha të Mbështetjes Logjistike, përkatësisht në Territorin e Forcës Detare, Durrës dhe në Bazën Ajrore Kuçovë. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, në bashkëpunim me Komandën Amerikane në Evropë dhe me Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit/ODC, me qëllim koordinimin e transportit dhe të lëvizjes

së kolonave ushtarake, të më shumë se 5000-6000 ushtarëve dhe të më shumë se 1000 automjeteve, do të organizojnë ngritjen e Qendrave të Përbashkëta të Kontrollit të Lëvizjes në Tiranë, Durrës dhe Kuçovë. Këto qendra të cilat do të funksionojnë si struktura OPERACIONALE për menaxhimin e lëvizjeve/konvojeve, do të garantojnë, koordinimin dhe sigurinë e transportit tokësor ushtarak nga Porti i Durrësit dhe Aeroportit "Nënë Tereza", për në të gjitha zonat operacionale të shpërndara brenda vendit tonë dhe në Ballkan. Pra, si përfundim, lidhur me statusin e përgatitjes dhe planëzimit, do të thoja që dosja e detajuar e planëzimit pothuaj ka përfunduar, dhe strukturat tona po bëjnë përgatitjet e fundit për t'u përfaqësuar sa më profesionalisht në këtë stërvitje të madhe.

Sa do të jetë pjesëmarrja e trupave në këtë stërvitjetë drejtuar nga ushtria e SHBA-së në Evropë? Sa trupa do të vendosen në Shqipëri?

Meqënsë po më jepet rasti, po jap disa të dhëna dhe fakte të zhvillimit në Evropë të serisë së stërvitjeve të koduara "Defeder". Seria e stërvitjeve të paketës së "Defender", përgatitet dhe drejtohet nga Komanda Amerikane në Evropë, bazuar në skenarët e NATO-s, ku në vitet tek, stërvitja/operacionet, tokësore, detare dhe ajrore, zhvillohen në jug të Europës dhe në Detin e Zi dhe në vitet çift, stërvitja/operacionet, tokësore, detare dhe ajrore, zhvillohen në veri të Evropës dhe në Detin e Zi. Disa të dhëna mbi "Defender Europe 21", po i pasqyroj si më poshtë: "Defender Europe 21", është e përbërë nga 4 stërvitje dhe e bashkëlidhur me 2 stërvitje të tjera amerikane si dhe me stërvitjen e NATO-s, "Steadfast Defender 21"; do të zhvillohet në 30 poligone të vëna në dispozicion nga 12 shtete. Marrin pjesë në stërvitje gjithësej 27 shtete, me mbi 31,000 trupa, ku 17 000 trupa janë amerikane dhe 14 000 trupa janë të aleatëve; mbi 2,200 pajisje/mjete; 4 Multinational "Airborne Operations"; 1 stërvitje mjeksore; 1 aktivitet logjistike "Joint Logistics Over-the-Shore (JLOTS); 5 porte, ku porti i Durrësit do të jetë porti kryesor; 12 ajroporte. Në vendin tonë, siç është përmendur edhe më herët, do të dislokohen mbi 3000 trupa nga disa struktura amerikane, ku më kryesoret janë Brigada e 53-të e këmbësorisë së lehtë; batalioni i helokopterëve; batalioni logjistik; batalioni xhenier, bateria e raketave "Patriot", struktura të Policisë Ushtarake; struktura CIMIC etj.

Përveç forcave amerikane, në vendin tonë do të stërviten edhe njësi ushtarake të Republikës Çeke,

Hungarisë, personel nga Kanada etj. Po ashtu, në vendin tonë, do të dislokohen edhe personel ushtarak nga rreth 15 vende të ndryshme Europës, të cilët do të plotësojnë me personel Qendrën Shumëkombëshe të Koordinimit CIMIC, e cila do të ngrihet në Bazën Detare /Pashaliman-Vlorë.

Vendi ynë ka një rëndësi strategjike gjeografike në rajon. Pse mendoni se është zgjedhur Shqipëria?

Nëse do të kthehem në vitin 2019, kur diskutohet për këtë projekt në Wisbaden Gjermani, drejtuesi kryesor planëzues amerikan, nuk e shikonte dhe nuk e konsideronte Shqipërinë, si destinacion për të zgjeruar hartën e DE më në jug të Europës. Në rrethanat e krijuara, brenda një kohe të shkurtër përgatitëm një prezantim me fokus, pozicioni gjeo-strategjik i Shqipërisë dhe vlerësimi për Portin e Durrësit (Port Assessment). Në prezantim, nënvizua lehtësisht dhe avantazhet që u garantonte pozicioni ynë gjeografik për zhvendosjet strategjike amerikane si dhe mundësitë e përdorimit të Portit të Durrësit për mbështetjen e zhvendosjeve strategjike amerikane, në drejtim të Detit të Zi, në drejtim të Afrikës etj.

Takimi rezultoi i suksesshëm pasi, pas diskutimesh, në fund të tij, duke vlerësuar pozicionin strategjik të vendit tonë, drejtuesit amerikan, hapën "dritën jeshile" për përfshirjen e vendit tonë në stërvitjen "Defender Europe 21".

Tashmë që planëzimi i "Defender Europe 21" ka rrugëtuar për afërsisht 2 vite, ku me dhjetëra drejtues të lartë ushtarakë amerikanë dhe me qindra planëzues amerikanë kanë ardhur në vendin tonë, përveç avantazheve të pozicionit gjeo-strategjik dhe pozicionit të Portit të Durrësit, amerikanët kanë identifikuar gjithashtu se shqiptarët janë populli më "pro amerikan" në botë, dhe si e tillë është një arsye më shumë, që kjo stërvitje të pasohet me simotrat e saj në vitet në vijim 2022; 2023; 2024; 2025 etj.

Ambicia e FA-së për të marrë pjesë dhe për të zhvilluar në vendin tonë seritë e stërvitjeve "Defender Europe", për periudhën 2021-2025, është shprehur dhe depozituar tashmë në strukturat vendimarrëse dhe planëzuese amerikane, ku aktualisht ka filluar planëzimi për ta zhvilluar edhe në vendin tonë stërvitjen "Defender Europe 22". Në mënyrë që të promovojmë rëndësinë gjeo-strategjike të vendit tonë si dhe rëndësinë strategjike të Portit të Durrësit, i cili siguron infrastrukturën e nevojshme për zbarkim të trupave amerikane, në përgjigje të ndonjë krize në Ballkan, Detin e Zi dhe Afrikë, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i FA-

së, në b/p me Komandën Amerikane në Europë (USAREUR) dhe Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit Ushtarak, kanë planifikuar zhvillimin e "DITËS SË VIZITORËVE TË SHQUAR", në Portin e Durrësit, më 4 maj 2021. Dita e Vizitorëve të Shquar, në Durrës, do të pasohet nga disa aktivitete të tjera kulturore dhe ushtarake të listuara si më poshtë: dita e Hapur/Display day në Tiranë; dita e hapur në Poligonin Kombëtar Bizë; ditë e hapur në Kuçovë; ditë e hapur në Vlorë etj.

Po Forcat e Armatosura shqiptare me çfarë trupash do të përfaqësohen? Cili do të jetë roli i tyre në këtë stërvitje?

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës 1 maj deri më 14 qershor 2021, do të "Mikpresin" tre (3) nga 6 stërvitjet e paketës së "Defender Europe 21", konkretisht, stërvitjet: Immediate Response 21; Saber Guardian 21 dhe Astral Knight 21. Bazuar në objektivin e SHSHP FA, në stërvitjet e sipërcituara, FA-të do të angazhohen me disa struktura në disa nivele, ku Shtabi i Përgjithshëm, luan rolin kryesor si drejtues i planëzimit dhe gjatë fazës së zhvillimit të stërvitjes, do të luajë rolin e Komandim-Kontrollit të saj. Komponentët, Tokësor, Detar, Ajror, Forcat Speciale dhe strukturat mbështetëse, do të jenë gjithashtu pjesë e audiencave stërvitore, ku fokusi do të jetë te Grup Batalioni i lehtë i Këmborisë, Objektivi Kapaciteti i NATO-s dhe disa struktura të tjera prioritare të FA-së.

Në total, FA-të do të angazhohen, gjithsej 15 struktura ushtarake, GBKL/b2k; CIMIC; EOD; CBRN; Xhenio QKR/FAj; SHPFA/QBO; EOD nënujore; baza ajrore Farkë, FD me 10 anije/ekui-pazhe; Policia Ushtarake, Seti Fushor i KM; kompani komando; Grup special/SOTU, AFA, me më shumë se 1000 trupa, ku pjesa më e madhe e tyre do të stërviten nën statusin "Audiençë Parësore e Stërvitjes" (me objektiva kryesore: rritja e aftësive operacionale dhe rritja e ndërveprueshmërisë) dhe një pjesë nën statusin "Audiençë Dytësore e Stërvitjes".

Përveç angazhimit në stërvitjet amerikane të sipërcituara, Forcat e Armatosura, do të marrin njëkohësisht pjesë edhe në stërvitjen e koduar "LAUFER", e cila është stërvitje e bashkëlidhur me stërvitjen DE 21, zhvillohet në Kroaci si dhe në stërvitjet Steadfast Defender 21/STDE 21 dhe Noble Jump 21, të drejtuara nga NATO, të bashkëlidhura me DE 21 (Rumani).

"Stërvitja Defender Europe 21", do të drejtohet nga Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë dhe Shqipëria do të jetë vendi pritës. Por

stërvitja gjithashtu do të shtrihet edhe në disa vende të Ballkanit dhe të Detit të Zi. Cilat janë këto vende dhe cila është ideja e stërvitjes për këtë bashkëpunim mes aleatëve?

Koncepti i stërvitjes bazohet në skenar të adoptuar, bazuar në situatën aktuale, ku siç e kam përmendur më sipër, do të marrin pjesë 26 shtete europiane, pjesa më e madhe e të cilëve, vende antare të NATO-s. Fokusi kryesor i stërvitjes do të përqëndrohet në 3 zona operacionale; vendet e Balltikut në Veri; vendet e Detit të Zi në lindje dhe në jug-perëndim, vendet e Ballkanit, ku përjashtohet vetëm Serbia. NATO, do të marrë pjesë në këtë fushatë me stërvitjen e saj të koduar "Steadfast Defender 21", e cila është e integruar me DE21. Fokusi kryesor i NATO-s do të jetë "Mbrotjtja Kolektive", përfshirë edhe aktivizimin e artikullit V. Në stërvitjen e NATO-s STDE 21 do të marrin pjesë 20 shtete të cilat

porti kryesor i stërvitjes DE 21 dhe do të shërbejë si Porta-hyrëse dhe përpunuese për të gjitha materialet dhe pajisjet që hyjnë në vendin tonë dhe që kalojnë tranzit; Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza" Tiranë, i cili do të jetë Porta-hyrëse kryesore për personelin ushtarak dhe civil që merr pjesë në stërvitje; Komanda e Forcës Ajrore dhe PU, ku përveç se si portë hyrëse do të shërbejë edhe si QENDËR E PRITJES dhe e procesimit të personelit të huaj"; Baza Ajrore Farkë, ku do të akomodohet batalioni amerikan i helikopterëve amerikanë; Baza ajrore e Kuçovës.

Kuçova do të kthehet në një ndër zonat më të mëdha të trajnimit për disa njësi ushtarake amerikane, siç janë ato të Policisë Ushtarake, Bateria e Raketave "PATRIOT", njësia e mjeteve fluturuese pa pilot/Dronëve si dhe baza logjistike mbështetëse. Poligoni kryesor ku do të zhvillohet Stërvitja Saber Guardian. Dhe lidhur



kanë si objektivi ushtarak, rritjen e ndërveprueshmërisë si dhe testimin e praktikimin e procedurave për zhvendosjet strategjike ushtarake, midis vendeve të ndryshme të Evropës. Në stërvitjen STDE 21, do të testohen për herë të parë strukturat e reja të NATO-s (2 komandat, JSEC dhe JFCNF) si dhe nëpërmjet Noble Jump 21, do të vlerësohen dhe testohen aftësitë operacionale të forcave të gatishmërisë së lartë të NATO-s, të cilat gjatë vitit 2021, operojnë nën statusin "NATO Stand By/VJTF".

Çfarë kapacitetesh logjistike do të ofrojnë Forcat e Armatosura? Në cilat terrene? Po bazat ushtarake të Shqipërisë çfarë mundësish ofrojnë për mbarrëvajtjen e kësaj stërvitjeje të pazakontë për nga përmasat në territorin tonë?

Në vendin tonë, në dispozicion të stërvitjes, janë vendosur 11 poligone dhe zona stërvitore e mbështetëse, të cilat do të garantojnë mbështetjen logjistike, administrative dhe stërvitjen e përbashkët me forcat amerikane për rreth 1 muaj e gjysmë. Porti i Durrësit, padyshim është

me Kuçovën, unë do të doja t'ju informoja, se menjëherë pas përfundimit të stërvitjes "Saber Guardian 21", do të fillojë zbatimi i projektit të ndërtimit të "Bazës Ajrore Taktike" të NATO-s.

Zall Herr, Tiranë, ku Komandës së Forcës Tokësore, do t'i shtohen edhe Brigada e 53-të amerikane, batalioni logjistik dhe batalioni xhenier amerikan në kuadër të stërvitjes Immediate Response 21; Komanda e Forcës Detare, Durrës do të shërbejë si bazë logjistike dhe si vend ku do të zhvillohet stërvitja detare për furnizimin e automejetve me karburant nga anijet në det; Baza e detare në Pashaliman, në të cilën do të ngrihet Qendra Ndërkombëtare e CIMIC; Poligoni kombëtar, Bizë, në të cilën do të zhvillohen stërvitja e Grup Batalionit të Lehtë të Këmborisë/GBKL dhe e disa strukturave amerikane në kuadër të stërvitjes Immediate Response. Risi është se GBKL, gjatë gjithë periudhës së stërvitjes, do të asistohet dhe monitorohet nga një ekip trajnues i specializuar amerikan (SFAB). Poligoni i Fekënit/Stanet e Linosit, do të akomodojë forcat tona, të cilët do të

impovizojnë kundërshtarin; Poligoni i Vaut të dejës, më të cilin në kuadër të stërvitjes Astral Knight 21, do të zhvillohen operacione "Personnel Recovery Operations"

Për sa i përket mbështetjes logjistike, FA-të do të mbështesin logjistikisht të gjitha trupat shqiptare që marrin pjesë në stërvitje, brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, FA-të do të mbulojnë me shërbime logjistike të limituara disa nga strukturat amerikane të cilat dislokohen në vendin tonë, veçanërisht për strukturat amerikane që dislokohen për ndërtimin e bazave logjistike dhe kampingjeve ushtarake si dhe për trupat amerikane të dislokuara në Poligonin Kombëtar, Bizë dhe në Pashaliman.

Ushtaraku i lartë amerikan, gjeneralmajor Joseph Jarrard, Zëvendëskomandant i Ushtrisë së SHBA-së në Europë, kur vizitoi vendin tonë për koordinimin e masave paraprake dhe përgatitjet, tha se Shqipëria është partnere strategjike e sigurisë amerikane në Europë. Cilat janë pritshmëritë? Por dhe sa e rëndësishme do të jetë kjo stërvitje për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ushtarak të SHBA-së me ushtarë shqiptarë në tokën shqiptare?

Gjatë vizitës në vendin tonë, gjeneralmajor Joseph Jarrard, zhvilloi takime në Këshillin e Lartë të Sigurisë dhe me autoritetet e larta të vendit për koordinimin dhe përgatitjet për zhvillimin me sukses të stërvitjes ushtarake "Defender Europe 21". Në takimet që ai zhvilloi në vendin tonë, nënvizoi se Shqipëria është një partnere strategjike e sigurisë dhe se Shqipëria po investon ndjeshëm në të gjitha fushat për të forcuar gatishmërinë operacionale për mbrojtjen kolektive të NATO-s. Gjenerali amerikan gjatë vizitës së tij përcolli disa mesazhe ku theksoi rolin e vendit tonë për sigurinë në rajon, rritjen e bashkëpunimit ushtarak në fushën e mbrojtjes; modernizimin e FA-së, si dhe rritjen e numrit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese dhe stërvitore. Në këtë kontekst, pritshmëritë janë që stërvitjet e përbashkëta do të rriten, si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit, ku jo më larg se në shtator të këtij viti Komanda Amerikane Europë, do të marrë pjesë me disa struktura në një stërvitje tonën kombëtare, po ashtu do të zhvillojë në vitin 2022 në vendin tonë stërvitjen "Swift Response 22" pjesë e paketës së "Defender Europe 22". E kështu, stërvitjet e përbashkëta do të vijojnë me intesitet të lartë në vitet në vijim. Stërvitja me ushtrinë më të fortë në botë, është padyshim sfida,

por nga ana tjetër është shans për FA-në, për t'u stërvitur së bashku, në disa disiplina dhe në disa domaine, në një ambient multinacional, kompleks me skenar real.

Si ka qenë bashkëpunimi dhe mbështetja e strukturave të shtetit shqiptar, për realizimin me sukses të stërvitjes "Defender Europe 21"?

Për shkak të kompleksitetit të kësaj stërvitjeje, metodologjia e planëzimit të saj, ka qenë gjithëpërfshirëse, ku përveç Ministrisë së Mbrojtjes dhe SHPPFA, kemi përfshirë edhe aktorët e tjerë. Struktura shtetërore të përfshira në planëzimin dhe përgatitjen e stërvitjes, kanë qenë pjesë integrale e grupeve të punës të ngritura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në SHPPFA, duke kontribuar në fushat respektive. Në nivel lokal, FA-të kanë bashkëpunuar me të gjitha autoritetet lokale të zonave ku do të zhvillohet stërvitja, autoritete lokale në Tiranë; Durrës; Vlorë; Kucovë etj. Po ashtu bashkëpunim të shkëlqyer kemi pasur me Komandën Amerikane Europë, Komandën Operacionale të NATO-s, Napoli, Zyrën e Atasheut amerikan në Tiranë dhe veçanërisht me Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit (ODC).

Pandemia, është një tjetër aspekt që duhet vlerësuar gjatë kësaj stërvitjeje. Si do të respektohen protokollet shëndetësore dhe rekomandimet e OBSH-së për parandalimin dhe përhapjen e virusit "COVID 19"?

Sfida e të gjithëve ka qenë ruajtja e gatishmërisë operacionale në kushtet e kufizimeve që dikton pandemia e shkaktuar nga COVID 19. Për të siguruar shëndetin e gjithë personelit të angazhuar në stërvitje, është përgatitur një plan tepër i detajuar i cili është i bazuar në protokollet tona kombëtare dhe në "COVID Mitigation Plan", të përgatitur nga Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë. Plani parashikon procedurat dhe hapa të detajuar që duhen ndërmarrë nga komandat dhe personeli ynë si dhe nga personeli i huaj, përpara dislokimit, gjatë stërvitjes dhe gjatë ridislokimit.

Bazuar në protokollet e përgatitura, strukturat tona të angazhuara në stërvitje, do t'i nënshtrohen testimit COVID 19 dhe menjëherë mbas testit, do të transportohen në poligonet e përcaktuara për të bërë 10 ditë karantinë, karantinë e cila nuk presupozon izolim të plotë të tyre dhe mos përfshirje në aktivitetet ditore. Të gjitha strukturat që shkojnë në poligone, janë negativë dhe gjatë qëndrimit në karantinë

në poligonin stërvitor, ata janë të autorizuar të kryejnë përgatitje dhe stërvitje me elementë duke zbatuar protokollet (maska; distanca, higjiena etj) si dhe konceptin e stërvitjes "train in bubble".

Vetëm mbas 10 ditëve karantinë, trupat tona do të mund të stërviten dhe të integrohen me trupat amerikane të cilat, dislokohen në vendin tonë sipas protokolleve të tyre COVID 19; 10 ditë karantinë në vendet e tyre dhe test COVID 19 (jo më herët se 48 orë para nisjes), transport me mjete ushtarake për në aeroportin e Tiranës dhe ose Portin e Durrësit, kontroll nga ekipet tona mjekësore në aeroport/port (pa u futur nga pjesa civile), transport me autobuza të sigurt për në zonat e trajnimit.

Në vijim të masave, Trupat amerikane do të bëjnë edhe dy teste të tjera në vendin tonë, një test në ditën D+2 dhe një tjetër në ditën G+8. Ndërkohë që për të trajtuar rastet pozitive, nëse do të ketë të tillë, janë planëzuar ambiente specifike në poligonet respektive dhe transport tokësor ose ajëror për në spitalet respektive për ata që mund të kërkojnë trajtim më të specializuar.

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2021 ka pësuar një rritje me rreth 2,7 miliardë lekë ose 11,8% krahasuar me planin e vitit 2020. Nga ana tjetër organizimi i kësaj stërvitjeje kaq të madhe kërkon shpenzime të mëdha. Mendoni se kjo rritje në buxhet është për këtë shkak?

Rritja e buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në shifrat që ju përmendni, nuk ka asnjë lidhje me stërvitjen "Defender Europe 21", por është një rritje në përpunje me objektivat dhe angazhimet tona në Samitin e Uellsit për ta rritur buxhetin e mbrojtjes, vit pas viti deri sa të arrijë nivelin-dyshe të kërkuar nga NATO, 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Lidhur me angazhimin e FA-së në stërvitjen "Defender Europe 21", ju sigurojmë që nuk janë alokuar fonde shtesë apo fonde të veçanta për të mbështetur strukturat tona. Pavarësisht emrit të stërvitjes dhe integritetit të stërvitjeve tona kombëtare me paketën e "Defender Europe 21", SHPPFA, komandat kryesore dhe reparte autonome, bazuar në ciklin stërvitor, i cili nis me përgatitjen individuale, vijon me stërvitjen kolektive dhe kulmon me një ushtrim stërvitor në terren ose të asistuar me kompjutera, bazuar në objektivat e stërvitjes, vit pas viti planëzojnë stërvitje dhe fondet respektive për kryerjen me sukses të ciklit të plotë të stërvitjes.

Të gjesh balancën midis detyrës, profesionit dhe familjes

Intervistë me major Dr.Elona HILA, mjeke pneumoftiziatre në Shërbimin e Sëmundjeve të Brendshme 1, në Spitalin Universitar të Traumës

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Njësia Mjekësore Ushtarake që funksionon në Spitalin Universitar të Traumës siguron ndihmën mjekësore të specializuar për efektivat e Forcave të Armatosura, siç e parashikon statusi i ushtarakut dhe ka aktivitet diagnostikues, mjekues, parandalues dhe trajnues, për mjekësinë ushtarake. Njësia Mjekësore Ushtarake siguron mbështetje mjekësore të FA në rol 3, dhe trajnon, përgatit personelin mjekësor ushtarak për rolin 1 dhe 2 të ndihmës mjekësore, parandalimin e sëmundjeve dhe epidemive, riaftësimin e forcave në kohë paqe, konflikti e krize dhe menaxhimin e politraumës në nivelin kombëtar. Në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore civile, ofron ndihmë mjekësore për popullatën në katastrofa e fatkeqësi. Major Dr. Elona Hila është pjesë e stafit të Njesisë Mjekësore Ushtarake, mjeke pneumoftiziatre në Shërbimin e Sëmundjeve të Brendshme 1, por ajo është dhe një prej mjekëve ushtarakë të angazhuar në përpjekjen për të arritur synimin e qeverisë shqiptare për të vaksinuar të gjithë popullatën në luftën anti-covid. Po sjellim për shtypin ushtarak intervistën me major Dr. Elona Hila.

Major Dr. Elona Hila, ju jeni pjesë e Forcave të Armatosura me një karrierë 16 vjeçare, mbani gradën major, por gjithashtu jeni pjesë e bluzave të bardha të Mjekësisë Ushtarake. Shkollimi



juaj është ushtarak dhe mjekësor njëkohësisht. Është hera e parë që në faqet e shtypit tonë ne sjellim intervistë nga një mjek ushtarak, por dhe sidomos nga një femër, mjeke ushtarake. Na flisni pak për rrugëtimin tuaj. Si u bëtë pjesë e FA dhe e Mjekësisë Ushtarake?

Kam lindur në Tiranë në dhjetor 1979, nga 2 prindërit e mi të res-

pektuar në profesionin e tyre, babai pilot ushtarak dhe mamaja mjeke. Që në fëmijërinë time të herëshme jam dashuruar me dy uniformat e prindërve të mi, me kapelen dhe spalëtat e babait ushtarak, por edhe me bluzën e bardhë të mjekut që vishte mami. Ishin dy uniforma, që si çdo fëmijë mrekullohesha pafundësisht kur vendosja në kokë kapelen e ba-

bait, apo vishja bluzën e mamit. Por atëhere unë nuk e dija që pikëtishtë, këto dy uniforma kaq të dashura për mua do të shkriheshin tek një e vetme dhe do të më tregonin rrugën që do të merrja në jetë. Besoj të vazhdosh pak nga rruga e prindërve është privilegj i madh dhe unë e kam atë, kam vazhduar pak nga rruga e të dyve, me dëshirën e mirë për të ecur në hapat e tyre që i kam si model në çdo çast. Mbarova shkollën e mesme të Pergjithshme "Qemal Stafa" në Tiranë me rezultate të shkëllyera (notë mesatare 10). Konkurova në Ministrinë e Mbrojtjes dhe fitova bursë për Mjekësi Ushtarake në Greqi. Këtu nis dhe rrugëtimi im.

Si ishte të fitojë një bursë në Mjekësi Ushtarake, të studioje në një vend si Greqia, vështirësitë e gjuhës, larg vendit, familjes, shoqërisë, por ajo që është më e rëndësishmja ndoshta nga të gjitha, disiplina ushtarake. A ishte e vështirë për ju jeta e re që po fillonit? Sfidat që ju prsinin? Si jeni ndjerë?

Konkursi ishte faza e parë, ishte shumë gjithëpërfshirës, që nga testimi fizik dhe ai mjekësor, e deri te provimi në matematikë, kimi, histori, gjeografi, anglisht. Në momentin që dola e para nga kandidatët fitues u ndjeva mirë, por në të njëjtën kohë edhe shumë konfuze. Të zgjidhje në moshën 18 vjeçare karrierën për të ardhmen, të futeshe në Forcat e Armatosura, ishte përgjegjësi e madhe. Sidoqoftë për mua mjekësia ishte pasion dhe me pjesën e ushtrisë, siç e thashë dhe më lart në koncept isha e familjarizuar, prej profesionit të babait tim.

Studimi ishte i vështirë, me vështirësi në gjuhë që për më tepër unë nuk e njihja absolutisht fare më parë. Studimi ishte i bukur, mjekësia në vetvete shumë e vështirë, por dhe shumë e bukur njëkohësisht. Jeta larg familjes ishte sfidë e re, megjithatë e gjitha mbaroi me sukses. Për mua dhe shoket e mi, pasi kisha edhe shokë të tjerë nga Shqipëria që dëshiroj t'i kujtoj, ishin Mimoza Simoni (stomatologji), Valbona Idrizi (ekonomik), Ilda Kokona (juridik), Ana Shkambi (juridik), Eliona Shkurta (juridik) dhe më duhet të përmend edhe shokun tonë që fatkeqësisht humbi jetën nga një sëmundje e pashërueshme gjatë viteve të studimit Mariel Condi (mjekesi). I përmenda se ne ishim si një familje e vogël që ndanim sukseset, vështirësitë, problemet së bashku dhe çdokush që ka studiuar jashtë vendit në një shkollë ushtarake, në moshë të re besoj se më kupton shumë mirë.

Ishte sfidë shumë e vështirë, Fakulteti i Mjekësisë, në gjuhën

greke dhe paralelisht detyrimet në Akademinë Ushtarake, sfidë nën uniformë. Por ishte një sfidë që ia dola me sukses.

Pra shkollimin tim e fillova në vitin 1998-1999 me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja Aristotel, Selanik, Greqi, vit ku mësuam dhe dhamë provomin zyrtar të gjuhës greke. Në vitin 1999-2005 mbarova Fakultetin e Mjekësisë Aristotel, Selanik Greqi dhe njëkohësisht Shkollën Ushtarake të Trupave SSAS, Selanik, Greqi.

Pas studimeve, u kthyet në Shqipëri, e diplomuar mjeke por dhe me titullin oficer, me gradën nentogere. Kush ishte emërimi juaj i parë, nga ku e filluat jetën ushtarake por tashmë atë në profesion?

Po. Pas studimeve u ktheva në Shqipëri, gjithmonë kam dashur të kthehem në vendin tim dhe të punoj me përkushtim dhe devotshmëri, të jap më të mirën nga ajo që unë mësova gjatë shkollimit tim me forcat e mia, por dhe mundësinë që më dhanë Forcat e Armatosura. Madje në vitin 2006, unë së bashku me infermiere Lavdie Kurti kemi qenë grupi i parë i femrave në operacione të përbashkëta me trupa angleze në Bizë. Fillimi i punës në një repart aq dinamik, me një ndryshim shumë të madh nga jeta studentore dhe aplikimi i mjekësisë nëpër spitale, ishte i vështirë. Nëse ju kujtohet në Shqipëri ishin vitet e fundit me ushtarë aktivë jo profesionistë, gjë që përmbante problematikat e veta. Sidoqoftë stafi i shkëlqyer mjekësor me mjekë dhe infermiere punëtorë e të përkushtuar më ndihmoi ta kaloja me shumë sukses punën time të parë në ushtri. Në vitin 2007 kam punuar si shefe e operacioneve mjekësore në kompaninë mjekësore në Brigaden e Reagimit të Shpejtë, Zall-Herr Tiranë, ku bente pjesë toga e parë mjekësore PFP, pjesë e certifikimit për antarësim në NATO. Kurse në vitin 2007-2008 u trajnova 1 vit në Spitalin Ushtarak të Marinës në Athinë, Greqi për "Mjekësi hiperbarike dhe vlerësim fillestar të zhytësve". Ky trajnim u bë me arsyen se në Shqipëri po përgatitej hapja e Shërbimit të Mjekësisë hiperbatike dhe zhytjes, por që fatkeqësisht nuk u realizua. Pastaj më vonë në vitin 2008 e deri në 2011 isha mjeke në Brigadën e Mbrojtjes Rajonale (BMR). Të punosh mes ushtarakësh është vlerë, je e rrethuar gjithmonë nga njerëz me përgjigjshmëri të lartë dhe me përkushtim, siç janë ushtarakët por dhe siç ishte dhe kolektivi i BMR, dhe stafi i personelit mjekësor. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kam punuar e komanduar edhe në Drejtorinë e Shëndetësisë në Ministrinë e Mbrojtjes për 9 muaj.

Që nga viti 2015 e deri më sot unë punoj si mjeke pneumoftiziatre në Shërbimin e Sëmundjeve të Brendshme 1, në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë (ku Njësia mjekësore Ushtarake bën pjesë si strukturë e integruar e këtij spitali). Jam njohëse e 4 gjuhëve të huaja, anglisht, italisht, greqisht dhe pjesërisht gjermanisht.

Në çfarë fushe të mjekësisë jeni e specializuar?

Mjekësia është një shkencë humane me përmasa shumë të gjëra, por unë jam specializuar në Pneumologji dhe e dua specialitetin tim. Në vitin 2011 deri 2015 kam kryer specializimin afatgjatë në Pneumologji në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë. Specializimi afatgjatë, që kryesisht e kreu në Sanatorium, spitalin 'Shefqet Ndroqi', që është përmendur aq shumë këtë kohë gjatë pandemisë, ishte specializim shumë intensiv, dinamik, interesant por dhe i bukur. Tani që jam futur më thellë në profesionin tim të pneumologut, në sudimet e rasteve por dhe koncertisht në punën e përditëshme, falenderoj me zemër dhe ju jam mirënjohës për tërë jetën profesorëve të mi dhe mjekëve me të cilët unë isha e atashuar gjatë spedializimit, siç kanë qenë prof dr.Jul Bushati, dr. Ylli Vakefliu, dr Vangjelika Leka, profesoreshe dr.Silva Bala, që përveç sheshe me mësoi që në punë marrëdhëniet e mira njerëzore bashkëlidhen me vlerat dhe njohuritë mjekësore për të pasur sukses. Apo një profesor tjetër shumë i nderuar si Prof. dr.Perlat Kapisyzin që e ngriti shërbimin e pneumologjisë në Shqipëri në vlera dhe praktika mjekësore të barazvlefshme me ato europiane. Më vjen të përmend me emër të gjithë ata që të bëhen bashkëkudhëtarë në momente të rëndësishme të jetës, e që kontribuojnë që ti të marrësh më të mirën prej tyre dhe pastaj ta japësh atë në shërbimin e njerëzve. Të gjitha këto që thashë, disa kohë më parë mund të tingëllonin pak çuditshëm në një intervistë me ju, ku mbase kanë dominuar intervista me tema operacionale apo të stërvitjes, pavarësisht se ekipi mjekësor është edhe aty i atashuar gjithmonë. Por sot kur po kalojmë këtë periudhë të vështirë pandemie, ndjeshmëria e gjithsecilit bëhet më e madhe, por dhe pothuaj gjithkush është familjarizuar me terma dhe nocione të pneumologjisë, për shkak të virusit corona apo kur dhe kur lufta anti-covid identifikohet për të gjithë me spitalin infektiv dhe atë "Shefqet Ndroqi".

Si është përditshmëria e punës tuaj në spital, si funksionon të

jesh mjek ushtarak? Kush janë pacientët tuaj?

Dita e punës nis në pavion, ku shihen rastet e shtruarra (në SUT ka 2 pavione sëmundje të brendshme, ku bëhen shtrime sipas patologjive), bisedohet me shefat për problematikat dhe ecurinë e të sëmurëve dhe më pas kalohet në konsultat e ndryshme në spital, pasi ka shumë pavione ortopedie, kirurgjie, neurokirurgjie, ORL, okulistikë, repart kirurgjie plastike, ku ne punojmë si konsulentë të fushave përkatëse. Gjithashtu kemi vizita ambulatorore për probleme të ndryshme pulmonare, ose kontrole periodike të ushtarakëve. Disa ditë në muaj bëj roje 24 orëshe si mjek primare terapie, në urgjencën e terapisë në SUT. Gjatë kësaj periudhe përveç punës së përditëshme në spital, rojeve 24 orëshe në Urgjencën e Siptalit, konsultave pneumologjike në pavionet e ndryshme të spitalit, shërbimit on call për konsulentë pneumologjike, si mjekë ushtarake jam angazhuar dhe në shërbimin mjekësor të ofruar në zona të thella rurale të organizuara nga MM dhe në ndihmën mjekësore të popullsisë në raste të fatkeqësive mjekësore si përmbytjet dhe rasti i tërmetit.

Gjatë gjithë kohës unë dhe personeli mjekësor marrim pjesë në kontrollin mjekësor të trupave ushtarake para trajnimeve, operacioneve jashtë vendit, ndjekjes së studimeve jashtë vendit, kontrollit periodik të personelit. Kemi marrë pjesë në plotësimin me kartela personale mjekësore në të gjithë Repartet Ushtarake në vendin tonë. Gjatë gjithë këtyre viteve kam ndjekur dhe trajnime dhe kurse afatshkurta në fushën e mjekësisë dhe kam botuar disa herë në Kongreset e Mjekësisë Ushtarake Ballkanike.

Prej më shumë se një viti edhe Shqipëria është përfshirë në luftën globale ndaj pandemisë COVID-19. Konkretisht kush është puna e ekipit tuaj? Cila është eksperiencia juaj?

Gjatë pandemisë Covid 2019 si mjekë e specializuar në pneumologji, së bashku me mjekët e tjerë pneumologë, infeksionistë, epidemiologë e mikrobiologë kemi qenë pjesë e punës intensive për Depistimin dhe Ndjekjen në dinamikë të personelit ushtarak dhe familjarëve të tyre të depistuar me Covid, si dhe kemi qenë pjesë e ndjekjes së rasteve me covid në Spitalin Universitar të Traumës që gjatë kësaj periudhe dhe tani ka marrë misionin e vështirë të urgjencave kirurgjikale në Tiranë.

Si ka qënë numëri i të prekurve tek Forcat e Armatosura? A mund

të flasim për një numur të madh të tyre në rradhët e FA dhe a është ajo pjesë e riskuar e popullsisë për shkak të profesionit që bën? Si janë zbatuar masat anti-covid, si është zbatuar protokollit?

Edhe ushtarakët dhe familjet e tyre sigurisht janë prekur nga pandemia covid dhe fatkeqësisht ka pasur dhe humbje jete. Në SUT është bërë marrja e tamponëve dhe depistimi i ushtarakëve si në rastet e të dyshuarve me covid, gjithashtu dhe para nisjes dhe mbërritjes nga misionet jashtë vendit, kurseve të ndryshme. Në rast të daljes pozitiv ushtarakët janë ndjekur në dinamikë nga mjekët pneumologë dhe infeksionistë në dinamikë ecurinë e tyre dhe në rastet e shtrimeve në spitalet covid, kemi ndjekur ecurinë klinike të tyre. Duke marrë shkas nga kjo intervistë dua të falenderoj kolegët e mi nënkolonele dr. Kujtime Duraku (infeksioniste) nënkolonel dr. Zymer Valbona (infeksionist), majore dr. Akela Beqaj, mikrobiologe, kapitene dr. Dorela Vasha (shëndet publik) dhe kolonel dr. Rushan Muhameti që përveç të qenit mjek pneumolog është dhe komandanti i Njësisë mjekësore Ushtarake dhe ka menaxhuar depistimin dhe menaxhimin e rasteve. Bashkëpunimi i njësisë tonë ka qenë maksimal dhe me Inspektoratin Shëndetësor në MM, ku kolonel dr. Elton Reso na ka mundësuar bashkëpunim dhe menaxhim të gjithë personelit ushtarak me prekje nga covid.

Së fundmi bluzat e bardha të Forcave të Armatosura u janë bashkuar kolegëve të tyre të sistemit publik shëndetësor në vaksinimin masiv të popullsisë ndaj COVID-19, për t'i ardhur në ndihmë Ministrisë së Shëndetësisë jo vetëm në kryeqytet, por kudo ku ajo ka nevojë? Si po zhvillohet ky proces? Sa mjekë dhe infermierë të FA janë angazhuar?

Angazhimi i mjekëve dhe infermierëve të Forcave të Armatosura vjen si një përpjekje për të arritur synimin ambicioz të qeverisë shqiptare për të vaksinuar të gjithë popullatën brenda pranverës së vitit të ardhshëm. Në këtë kuadër angazhimi i mjekëve dhe infermierëve është bërë me ratacion, sepse është marrë në konsideratë dhe puna e përditshme në spital, konsultat, roje 24 orëshe, në mënyrë që të japim ndihmesën tonë në vaksinimin e popullsisë, por pa lenë deyrat tona funksionale. Aktualisht së bashku me një pjesë të personelit mjekësor (mjekë e infermierë) të NJMU-së po marrim pjesë në fushatën e vaksinimit të popullsisë në sheshin Skënderbej.

Ju jeni mjekë, ushtarake, nënë dhe bashkëshorte. Keni krijuar familjen tuaj. Si e gjeni balancën midis detyrës, profesionit, familjes dhe rritjes profesionale?

Unë jam nënë e 2 djemve, Daniel dhe Dario përkatesisht 11 dhe 7 vjeç. Jeta e një mjeku ushtarak është sfiduese, shumë e ngarkuar dhe plot emocione. Është sfiduese të gesh balancën midis detyrës, profesionit, familjes dhe rritjes profesionale. E vetmja gjë lidhëse është dashuria për njerëzit, familjen, profesionin. Në çdo sfidë të re që del përpara si rasti i pandemisë covid, duhet të gesh forcën të ecësh përpara, të ndihmosh të tjerët, të studiosh që të japësh më të mirën, të luftosh për veten, familjen dhe njerëzit. Unë ndihem krenare për familjen nga vij, për familjen që kam krijuar, për profesionin e mjekut ushtarak, për punën e vazhdueshme me pacientët, për ndihmën që ofrojmë për njerëzit në raste vështirësish. Besoj në këtë rrugëtim unë jam rritur profesionalisht, jam rritur si individ, si femër e si nënë. Gjatë këtyre viteve kam njohur kolegë të mrekullueshëm nga të cilët mësoj çdo ditë diçka. I falenderoj sepse puna në mjekësi është punë në skuadër, nuk mund të realizohet vetëm, prandaj dhe kur flas për ta dua t'i përshtes me emër sepse familja jonë e mjekëve ushtarakë është e madhe dhe ata janë gjithmonë në roje të jetës. Ata janë dr. Diana Sinanin, dr. Eriselda Revizhda, dr. Marsida Kasa, dr. Besim Lame, dr. Monika Kallfa, dr. Matjan Kapaj, dr. Fatos Jahon, dr. Arlinda Tomcinin, dr. Erjon Spahon, dr. Gerond Spirollarin, dr. Dorina Shtjefni, Dr. Elona Reci, dr. Sonja Saracin, dr. Katerina Tanku, dr. Elona Markeci, dr. Valbona Kopani, dr. Bruna Sukaj, dr. Kastriot Subashi, dr. Alketa Stroni, apo dhe infermierët tanë që janë të palodhur dhe të cilët janë të gjithë që na bëjnë të ndihemi si një familje e madhe që ndihmojmë njeri tjetrin dhe që ecim përpara pavarësisht vështirësive dhe sfidave të reja. Nuk është e lehtë, por nuk është e pamundur. Është e vështirë, por është dhe plot sodisfaksion. Dhe kjo më bën të ndjehem falenderuese por dhe e lumtur çdo ditë sepse bëj një punën që dua, të ndihmoj njerëzit në nevojë, t'i shërbej vendit tim dhe të përpiqem çdo ditë me hapa të vegjël që të ecim përpara e ta bëjmë të ardhmen e fëmijëve tanë më të mirë e më të sigurt. Falenderoj bashkëshortin tim Ledin, mamane time Tatjanën, fëmijet e mi Daniel dhe Darion që më ndihmojnë çdo ditë që unë të vegjëll që të ecim përpara e ta vazhdoj me pasion rrugëtimin tim. Ju falenderoj dhe juve, për durimin, mirëkuptimin dhe për këtë intervistë që realizuam së bashku.

Fëmijëria ime me shkëlqimin e detit në sy

Sfida ime: Pjesë e anijes “BUTRINTI” me mision patrullues në Detin Egje

Intervistë me
nëntoger
Lediola
Kojanaj, shef
i Qendrës
Shëndetësore
në Pashaliman

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Forca Detare tashmë një forcë moderne dhe profesionale, ka bërë një rrugëtim të guximshëm për ringritjen e saj, qoftë në aspektin e logjistikës të mjeteve e pajisjeve, në terma të ekspertizës, apo çfarë është më e rëndësishme në atë të ngritjes të burimeve njerëzore. Janë pikërisht këto burime njerëzore që me përkushtimin për detyrën, me pasionin për profesionin luajnë një rol domethënës në përfaqësimin e Forcave të Armatosura në vend dhe në misionet e NATO-s. Më poshtë një intervistë për shtypin ushtarak me nëntoger Lediola Kojanaj, efektiv i Forcës

Detare, shef i Qendrës Shëndetësore në Repartin 2004 Pashaliman.

Nën uniformën ushtarake të Forcës Detare, ju nëntoger Lediola Kojanaj, shërbeni prej 4 vjetësh, kohë relativisht jo shumë e gjatë në FA, por që ne ju kemi për zgjedhur të na tregoni për ekperiencën tuaj individuale në FA. Si u bëtë pjesë?

Eksperienca ime në Forcat e Armatosura dhe specifiktë në Forcën Detare, është e ngjashme me atë të dhjetra e qindra vajzave dhe grave nën uniformë që kanë nisur rrugëtimin e tyre të bukur, të vështirë dhe tepër sfiduese nën uniformë, pasi është bukur të bëhesh pjesë e Forcave të Armatosura, e sidomos kush ka ëndërruar për të. Pra të jesh pjesë e Forcave të Armatosura, profesion, që menjëherë sapo dëgjon për të, të duket si një profesion që kur e sheh nga jashtë FA-së, mendon se është profesion vetëm për burrat, por që tashmë jemi edhe ne femrat të rreshtuara krahas tyre, si në çdo fushë tjetër të jetës. Ka qënë viti 2017, falë njoftimeve të Ministrisë të Mbrojtjes, kohë kur unë dëgjova që kishin filluar aplikimet për Akademinë e oficerëve të rinj. Menjëherë nisa procedurën e dokumentacionit që duhej të plotësoja, pasi nuk ishte e lehtë të bëheshe pjesë e FA-së. Është një dokumentacion, që do të jetë ‘certifikata’ jote e parë për të hyrë në botën e bukur të uniformës, por që të arrijë deri atje duhet të kaloje disa faza. Pra janë disa faza tepër të rëndësishme që ti të bëhesh pjesë. Për shembull është faza e parë testimi fizik, pra është është hapi i parë që çdokush duhet të kalojë për të përballuar vështirësitë e stërvitjes që do të pasojnë udhëtimin tënd të mëpasëm. Po kaq i rëndësishëm është testimi intelektual dhe psikologjik, gjithashtu. Pas gjithë testeve të nevojshme që kërkonte përzgjedhja e kandidatave, që për mua për të qënë e sigurtë nuk ka qënë shumë e lehtë, unë shpallëm



fituese. Gëzim i madh, krenari e madhe por njëkohësisht dhe përgjegjësi e madhe. Nën këtë atmosferë tepër emocionuese dhe të paprituara fillova kursin që zgjati prej 9 muajsh.

Si ishte të përshtateshe me jetën ushtarake, me disiplinën që është rregulli numër një i performancës të asaj se nga duhet të nisë udhëtimin i një ushtaraku por sidomos për një student ushtarak, siç janë orët e stërvitjes apo ato të studimit, por edhe disa kufizime specifike që e dallojnë këtë kategori edukimi nga shkollimi civil. Ishte kjo një sfidë për ju?

Po sigurisht, fillimi nuk ishte aspak i lehtë. Duhet të përshtateshe tashmë me zgjedhjen tënde, me jetën ushtarake, së cilës ti vetë i kishe trokitur në derë, duhet të përshtateshe me rregullat strikte, disiplinën, stërvitjet e shumta, orarin preciz, kohën e studimit, etj. Gjithçka ka qënë një sfidë shumë e madhe për mua, sepse nuk mjafton vetëm dëshira, ajo është vetëm gjysma e punës. Pjesa tjetër është vullneti për t'ia dalë, vullneti për të ecur, për të mos u dorëzuar, apo për të mos u kthyer pas, është sedra jote dhe premtimi që ti i ke bërë vetes kur do shumë të arrish objektivin që ti ke marrë përsipër. Gjithçka hap pas hapi bëhet pjesë e karakterit tënd në udhëtimin ushtarak, që nga momenti kur ti hyn në rresht dhe bëhesh pjesë e sfidave që në fillim, me orarin, rregullin, disiplinën. Ti formësohesh nëse kërkon brenda vetes për t'ia dalë.

Pra ato 9 muaj ishin jo të lehtë për mua pasi duhet të përshtatesha siç e përmenda më lart me jetën ushtarake, me disiplinën që në Forcat e Armatosura ishte rregulli numër 1 i performancës të asaj se nga duhet të nisë udhëtimi i një ushtaraku siç janë orët e zgjimit, orët e stërvitjes dhe orët e studimit, pse jo siç e thatë dhe ju, edhe disa kufizime specifike që e dallojnë shkollën ushtarake nga një shkollë civile, si nga ajo që unë kisha kryer më parë.

A kishit ju një model të mëparshëm që ju ndikoi për t'u bërë pjesë dhe për të shërbyer në FA?

Po sigurisht. Kam pasur në familjen time figura ushtarakësh që punonin në Forcat e Armatosura. Por kam përshtypjen se uniforma e ushtarakut është tërheqëse, dhe edhe sikur të mos kisha pasur dikë nga familja, si figurë ushtarake, që të më të fliste lidhur me ushtarinë, do ta doja po njëllot dhe do të kisha po të njëjtin vlerësim. Mendoj se uniformën ushtarake e kam dashur edhe më parë, pasi ajo personifikon forcë, guxim, gatishmëri dhe besim. Pra është një uniformë që frymëzon

lehtë, por dhe që të punosh në FA është një gjë shumë e bukur, por nga ana tjetër ai më kishte thënë se është gjithashtu po aq dhe me shumë përgjegjësi. Ndaj duhet vendosmëri nëse do të bëhesh pjesë e FA-së. Pastaj vite më vonë kam dëgjuar për gra e vajza ushtarake, për ecurinë e tyre në karrierë, për përparimin e tyre në gradë, gjë që u bënë për mua më vonë shembuj frymëzimi.

Kush ka qënë emërimi juaj i



dhe besoj se këtë duhet ta kem ndjerë që në fëmijëri. Ishte dikush pjesë e familjes time, siç e thashë, ai ishte burri i hallës time, që më kishte treguar gjithashtu edhe për vështirësitë, që nuk është e

parë, në FA pas titullimit oficer dhe me gradën e parë ushtarake nëntoger? Si u ndjetë në punën tuaj të parë?

Siç ju tashë pas një periudhe

9 mujore, të mbushur me orë stërvitje, trajnime, aktivitete, më në fund çdo sakrificë, nëse e quajmë të tillë, u shpërblye dhe unë u titullova officer, me gradën nëntoger. Emerimi im i parë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, më pëlqen ta shqiptoj të gjithë termin, sepse ishte një krenari e paparë, ka qenë shef i Qendrës Shëndetësore në Repartin 2004 Pashaliman. E kisha dëshiruar shërbimin tim në atë qendër në fakt, më pëlqente që unë të shërbeja atje. Unë jam nga Vlora, jam lindur në Vlorë dhe jam rritur atje. Fëmijërinë dhe adoleshencën time i kam kaluar me shkëlqimin e detit në sy. Kam lindur në vitet e para të demokracisë, vite të vështira për të gjithë, por të bukura për ndryshimin e madh që e priste vendin. Ka qenë pikërisht viti 1994. Nga Radhima ime e bukur e lindjes, nga Orikumi ku u shkollova më tej, nga Vlora jam larguar në vitin 2011, kur më duhej të studioja në Fakultetin e Mjekësisë dhe tashmë po kthehesha, pranë detit tim, me uniformën e Forcave Detare në Pashaliman. Ishte diçka e bukur ajo që kisha arritur. Isha krenare. Çdo vajzë do ishte krenare, njëlloj si unë. Isha bërë oficer, pjesë e Forcave Detare të FA shqiptare, gjë që nuk kishte qenë e lehtë. Ëndra ime më e bukur ishte bërë realitet.

Sa e rëndësishme është të jesh pjesë e bluzave të bardha të FA, por njëkohësisht dhe pjesë e Forcave Detare?

Në aplikim tim për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura, siç ua theksova që në fillim, unë vija nga një shkollim tjetër i mëparshëm, sepse ky ishte dhe kriteri i parë që kërkohej për t'u pranuar në fazat e mëtejshme të testimit, pra të kishe mbaruar një fakultet që ti të bëheshe pjesë dhe të vazhdoje më tej studimet ushtarake. Unë vija nga një shkollim mjekësor, pra vija me një diplomë mjekësie. E doja shumë profesionin tim dhe isha e dashuruar me bluzën e bardhë që më përfaqësonte dhe me humanizmin që e kisha bërë pjesë të karakterit tim. Por tashmë mbartja me vete dy dashuri të mëdha, së bashku me formimin tjetër, atë të ushtarakut, për të shërbyer më mirë pranë njerzve nën uniformë.

Roli i mjekut është një detyrë sa

e vështirë por edhe aq humane. E konsideroj veten me fat që unë gjendem pranë njerzve të cilët kanë më shumë nevojë se kushdo për shërbim dhe pozitivitet kur ata ndjehen të brishtë. Por gjithashtu kam dhe rolin e ushtarakut, forcën, vendosmërinë, autoritetin që të jep uniforma dhe jo vetëm. E di që për të qenë një femër në fuksion të tillë në Forcat e Armatosura jam e përgatitur dhe e vendosur të luftoj e të fitoj në çdo lloj sfide dhe vështirësie me të cilat mund të përballim, gjithmonë në përmbushje me suksese të detyrës që kam ndaj Atdheut.

Kush ka qenë sfida juaj më e madhe deri tani në FA, që ka shënuar shërbimin tuaj nën uniformë?

Jeta ushtarake në vetvete është sfiduese pa dyshim dhe, sfidat që ti has në përditshmërinë tënde janë të natyrave të ndryshme sigurisht. Por sfida ime më e madhe në Forcat e Armatosura, që doja ta quaja kryesfidën time ka qenë ajo e datës 13 janar e vitit 2019 kur unë përzgjidhem si një ndër efektivët e anijes "BUTRINTI" për të qenë pjesë e Misionit në Detin Egje. Ishte një sfidë që nuk mund ta shmangja apo që të mund t'i thoja jo. E kush do t'i thoshte?! Isha bërë pjesë e ekuipazhit të 11-të në të cilin do të na duhej të patrullonim në det për 3 muaj si efektiv. Ishte totalisht një eksperiencë e re për mua sa aq e veçantë, aq dhe me shumë përgjegjësi. Një emocion i papërshtatshëm, por edhe i paharuar që do të më mbetet, ishte ai në ditën e parë të nisjes së bashku me urimin "Erëra të mbara", për ekuipazhin e anijes "BUTRINTI", pra dita e parë në misionin e NATO-s në Detin Egje. Ishte një sfidë, por një sfidë që rezultoi me shumë suksese për ne të gjithë si përfaqësues të Forcave të Armatosura në atë mision. Ne ishim në të njëjtin nivel përkrah aleatëve në këtë operacion të rëndësishëm. Nisja jonë u bë nga Baza Detare Pashaliman Vlorë, ku u zhvillua dhe ceremonia e përcjelljes së kontingjentit për në operacionin e NATO-s në detin Egje, ishte një ceremoni ku pasoi me morjen në dorëzim të Flamurit Kombëtar. Ceremoni përcjelljesh dhe të kthimit në atdhe të kontingjentëve të anijeve pjesëmarrëse në mision sjellin krenari dhe emocion. Forca Detare shqiptare ishte pjesë e patrullimit në Detin Egje dhe unë së bashku me efektivin ishim pjesë në kuadër

të kontributit me forcat aleate të NATO-s, ku gjatë patrullimeve anijet tona shqiptare kanë ndërmarrë një sërë operacionesh për shpëtimin e jetës së emigrantëve.

Pra ju veçoni si sfidën tuaj më të madhe, atë si pjesë e efektivit të anijes "BUTRINTI", në Misionin e Detit Egje. Ishte hera e parë e pjesëmarrjes së një femre nën uniformë në këtë mision. A është e vështirë për një femër të jetë pjesëmarrëse në një mision të tillë siç ishte ai i Detit Egje? Çfarë do të veçonit?

Po. E vërtetë, hera e parë për një efektiv femër të Forcës Detare që të ishte pjesëmarrëse në një mision të tillë detar, patrullim në Detin Egje për 3 muaj. Të marrësh pjesë në një mision ndërkombëtar është sfidë për çdo ushtarak të FA, i çfardo force që të jetë, pa veçuar gjininë, si për meshkujt edhe për femrat. Ju e dini që në misionet e tjera të NATO-s, ku FA ka qenë pjesëmarrëse, ka pasur edhe ushtarake femra. Por misioni ku unë isha pjesë jo vetëm që ishte i pari për mua, por ishte gjithashtu dhe misioni i parë ku kishte pjesëmarrës, efektiv femër. Unë jam krenare për misionin tim. Jam krenare dhe e nderuar që isha pjesë edhe pse ishte një nismë e vështirë për një femër dhe sidomos për një nënë. Ju më pyetët se çfarë do të veçoja nga ky mision? Ka pasur shumë momente që do t'ia vlen të quaja që unë t'i përmendja sepse mendoj se një mision detar, ka veçoritë e tij nga ata tokësorë. Por unë si një ushtarakë e FD, por dhe pjesë e bluzave të bardha do të veçoja një rast në mision në Detin Egje. Një efektiv i anijes ra në depresion dhe nuk po e përballonte dot qëndrimin brenda në anije për një periudhë kohore të gjatë, siç e kërkonte detyra, kjo sepse ai nuk ishte mësuar me detin. Kjo situatë ishte shumë e vështirë edhe për mua, dhe, edhe pse u kapërcye kjo gjë, ende sot ai efektiv ka ngelur në kujtimet e mia. Kjo sepse unë isha mjeku dhe ushtaraku, dhe siç e thashë edhe më lart roli i mjekut është një detyrë që për të qenë pranë me atë që ke mësuar në shkollë, me përvojën por dhe me dhunë pozitivitet.

Si u ndjetë kur u rikthyet në atdhe?

Si në shtëpi.

Unë, nesër pilotja e parë e Forcave Ajrore

Të udhëhiqesh nga trinomi “NDERI, DETYRA, ATDHEU”

Intervistë me N/Togeren Armela Murati, privilegji dhe sfidat e të qenit pilotja e parë ushtarake në Shqipëri

INTERVISTOI: HAJRIE DEDAJ

Të jesh pjesë e Forcave Ajrore të Shqipërisë është jo vetëm kënaqësi, por edhe privilegj. Tashmë prej kohësh femrave në ushtri u është dhënë një mjedis mbështetës dhe mundësi të barabarta për arsimim dhe përparim. Forca Ajrore është një zgjedhje e shkëlqyer e karrierës për gratë, pasi në ditët e sotme zhvillimi dhe shpërblimet e karrierës bazohen në potencial, përpjekje dhe arritje pavarësisht nga gjinia. Ashtu si dhe meshkujt ato i shërbejnë vendit tonë me guxim dhe përkushtim. Pak javë më parë, në Bazën Ajrore të Farkës u hap kursi për “Pilot Ushtarak Helikopteri”, ku janë 12 kursantë, ndryshe pilotë të ardhshëm, e midis tyre është dhe N/Togeria Armela Murati e vetmja femër. Armela është një vajzë me origjinë nga Burreli, por prej vitesh jeton në qytetin e Durrësit me familjen. Ajo nuk është e vetmja në familjen e saj, që me devotshmëri i shërben atdheut, siç duket traditën për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura ajo e ka trashëguar nga i ati, një ish ushtarak. Kush më mirë se vetë N/Togeria Armela Murati mund të ndante eksperiencën, ndjesitë dhe përgjegjësinë që ajo



tashmë mban mbi supe. Më poshtë do të gjeni intervistën e dhënë për gazetën “Ushtria”.

Armela, ju jeni vetëm 24 vjeçe dhe tashmë keni filluar kursin për të qenë pilotja e parë shqiptare, si jeni duke e përjetuar këtë moment, çdo të thotë kjo arritje për ju?

Jam shumë e lumtur dhe e emocionuar, që po realizoj ëndrrën time, e cila do të jetë e vështirë, por jo e pamundur. Ky moment është tepër emocional për mua, emocione të përziera me një përgjegjësi shumë

të madhe. Mbështetja që kam marrë më bën më shumë përgjegjëse për ta realizuar deri në fund dhe me sukses këtë ëndërr. Janë pafund mesazhet, urimet inkurajuese për hapin që kam ndërmarrë.

Çfarë ju frymëzoi të zgjidhni një profesion, i cili përgjithësisht konsiderohet si mashkullor?

Fakti që vij nga një familje ushtarakësh, ku babai im ka punuar për 25 vite në FA si oficer, ka qenë edhe shtypa kryesore, që unë të radhitem si ai në FA. Babai im është idhulli im.

Që e vogël admiroja uniformën e tij, detyrat që ai mbante dhe kryente me devotshmëri për t'ju regjistruar në memorien time dhe për t'u zgjuar tani, që të ndërmarr këtë hap të rëndësishëm në jetën time. Për mua është një shembull që unë aspiroj të ndjek në të ardhmen. Gjithashtu meqenëse u emërova në Komandën e Forcës Ajrore, pashë dhe ndjeva nga afër kënaqësinë që të jep hapësira ajrore u motivova për të provuar dhe sfiduar veten të ndërmarr këtë sfidë të vështirë, por jo të pamundur të bëhem pilote, kështu që ju nënshtrova testeve të shumta që na u bënë, kështu arrita që të jem një ndër fituesit e këtij kursi. Sfidat janë sfida, si për meshkujt, ashtu edhe për femrat.

Si ka qenë reagimi i familjarëve tuaj kur i keni treguar dëshirën për t'ju bërë pilote ushtarake?

Familja ime është mbështetja kryesore në vendimin, që unë mora. Ato ishin një shtysë edhe më e madhe që unë të merrja këtë hap të rëndësishëm dhe të vështirë në jetën time. Familja vazhdimisht më ka motivuar të ndërmarr sfida të rëndësishme dhe të vështira edhe këtë herë ishin aty për të më mbështetur, inkurajuar.

A ka diçka që i bënë femrat ushtarake më të mira se meshkujt?

Mendoj që në shoqërinë tonë femra është pak e nënvlerësuar në lidhje me profesionet e vështira. Por në këtë rast, vërtetojmë që edhe femrat mund të bëjnë gjithçka, ashtu si edhe meshkujt. Ky është një motiv edhe për të gjithë femrat e tjera të cilat kanë në mendje profesione të vështira, por ngurojnë nga opinionet shoqërore.

Si komandante toge në logjistikë, cila është gjëja më e rëndësishme që mund t'ju kërkonin ushtarëve tuaj?

Respekti ndaj punës dhe motivimi për të realizuar me përpikëri detyrën që u është ngarkuar.

Cila ka qenë dita juaj më e vështirë në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas?

Duke qenë se unë e kam me

shumë pasion profesionin, që kam zgjedhur, mund të them me plot bindjen që asnjë ditë nuk ka qenë e vështirë në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas. Aty unë gjeta një ambient mikpritës, bashkëpunues, mbështetës dhe shtytës për të ecur përpara. Mund të them që ishte vet komandanti im i repartit që më mbështeti në hapin që unë doja të ndërmeroja, duke më motivuar që mund të ia dal dhe të arrij të jem pilotja e parë femër në Shqipëri.

E konsideroni veten patriote?

Sigurisht që jam patriote, sepse

Në gjithë botën femrat kanë treguar, që dinë t'u bëjnë ballë çdo sfide. Historia ka treguar se pas burrave në karrierë qëndron një femër e cila i ka motivuar dhe orientuar për të arritur fitore. Nuk jam unë as e para dhe as e fundit që ka ndërmarr një profesion të vështirë, sepse femrat po sfidojnë burrat edhe në hapësirat kozmike dhe jo më ajrore.

Cili ka qenë momenti më i mirë i karrierës suaj deri më tani dhe çfarë këshille do t'i jepnit një vajze, që kërkon të fillojë një karrierë të ngjashme?

Momenti më i rëndësishëm i



çdo shqiptar e ka në gjak patriotizmin. Gjithë ushtarakët udhëhiqen nga "trinomi" NDERI, DETYRA, AT-DHEU. Kjo tregon që atdhetarizmi është ndjenjë dhe detyrë. Dhe nëse nuk do të isha oficerë në FA, nëse do të ma kërkonte nevoja do të sakrifikoja çdo gjë për të mbrojtur Atdheun tim.

Çfarë u thoni kritikëve, që mendojnë se femrat nuk duhet të shërbejnë në role luftarake?

karrierës sime ushtarake, ishte prezantimi që mu bë ditën e hapjes së kursit "Pilot Ushtarak Helikopteri", ku ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, SHSHP Gjeneralmajor Bajram Begaj dhe Komandanti i Forcës Ajrore në detyrë kolonel Ylli Pulaj, më uruan për kurajën dhe iniciativën që kam marrë, duke më siguruar mbështetjen e tyre të plotë dhe duke më bërë shembull për të gjithë vajzat, që aspirojnë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.

Kolonel Steven Bucci: Shërbimi në Shqipëri një nga pikat e mia të larta profesionale

INTERVISTOI
SHEFQET&HERION KËRCELLI

Zoti Steven, së pari ju falenderoj për mikpritjen që ju treguat në dhënien e kësaj interviste. Doja t'ju pyesja në çfarë rrethanash e morët dhe si e pritët Ju, emërimin si atasheu i Mbrojtjes i SHBA-së, rezident i parë në Shqipëri?

Në fillim dua të them se jam i lumtur t'u përgjigjem pyetjeve tuaja. Kur SHBA, rihapi ambasadën e saj në Tiranë, pas më shumë se pesëdhjetë vitesh, u vendos që stafi i saj të kishte edhe atasheun ushtarak. Në protokollin amerikan, përfaqësuesi më i lartë ushtarak në një ambasadë quhet Atashe i Mbrojtjes, sepse përfaqëson Departamentin e Mbrojtjes në vendin mikpritës. Unë isha duke përfunduar Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në SHBA. Ndërkohë kisha shkruar gjerësisht për tensionet në rritje, në rajonin më të gjerë të Ballkanit, duke u fokusuar në çështjet që prekin popullin shqiptar. Në atë kohë ishte planifikuar që unë të shërbeja në stafin e SHBA-së në NATO. Ata pyetën për gradën, për specialitetin dhe për kualifikimin tim. Unë jam shtetas amerikano-italian dhe ndërkohë më parë kisha përfunduar Kolegjin e Luftës, të Ushtrisë Greke, në Selanik të Greqisë. Ata gjithashtu vunë re punën time në lidhje me rajonin. Pastaj më thanë që po kërkonin një oficer që të bëhej Atasheu i parë i SHBA-së, rezident

Intervistë me kolonel Steven Bucci, atasheu i I-rë ushtarak i SHBA-së, në Shqipëri, në vitet 1992-1996. Kolonel Steven Bucci, aktualisht është Konsulent i Pavarur dhe Studiues Vizitor për Operacione Speciale dhe Kundër Terrorizmit në Fondacionin "Heritage"



në Tiranë. Ata po kërkonin ndonjë që fliste greqisht ose italisht, sepse mund të gjenin folës shqiptarë. Unë flisja greqisht, dhe kisha studjuar Shqipërinë. Mendoj se isha zgjedhja më e mirë e disponueshme. E pranova këtë detyrë, dhe fillova trajnimin tim specifik për këtë emërim të ri e të rëndësishëm. U trajnova për gjuhën në Uashington, gjithashtu edhe bëra edhe trajnim si Atashe nga Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes.

Çfarë dinit ju për Shqipërinë, popullin dhe ushtrinë e saj?

Siç e përmenda më parë, unë e kisha studiuar Shqipërinë, veçanë-

risht situatën e saj politike në lidhje me fqinjët e saj, dhe pak prej historisë së saj. Gjithashtu e shfrytëzoja kohën time të lirë gjatë trajnimit të gjuhës për të studiuar e mësuar më shumë për vendin tuaj. Mësova që Shqipëria kishte vuajtur përgjatë pesëdhjetë viteve të një diktature komuniste tepër shkatërruese, dhe së fundmi e fitoi lirinë e saj përmes vullnetit të pastër të popullit të saj. Tani ishte duke u përpjekur të gjente vendin e saj të ligjshëm mes popujve të lirë të Europës. Shqipëria kishte shkurtuar në mënyrë drastike masën e ushtrisë së saj, pas dhjetra vitesh përgatitje, që të luftonte bashkë me NATO-n edhe aleancën e Traktatit të Var-

shavës. Qeveria e re, e lirë, duhej t'ia përgjigjej popullit, që donte një orientim perëndimor, dhe një sistem të ekonomisë së lirë. Ndryshimet po vinin shumë shpejt, dhe unë do të kisha shansin të ndihmoja në këtë process.

Cilët ishin projektet e para të bashkëpunimit me ushtrinë shqiptare?

Unë u mirëprita me një ngrohtësi të madhe, dhe shpejt fillova të njihem me atëçfarë ishte bërë tashmë nga personeli i përkohshëm, i ndryshëm i dërguar më parë në Tiranë. Pas rreth dy javëve të akomodimit dhe mirëpritjeve zyrtare të ndryshme, sipas protokollit, më ftuan të takoja Ministrin e Mbrojtjes, zotin Safet Zhulali, tek zyra e tij. Kur arrita, u ndesha me mikpritjen tipike shqiptare të mrekullueshme. Fillimisht ministri nxorri një skicë shumë të madhe të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes. Pastaj ai më tha se, donte që unë t'a ndihmoja atë të "rindëronte" Ministrinë e tij të mbrojtjes "që të dukej pikërisht kështu". Unë i thashë se e kuptoja qëllimin e tij për t'a bërë ministrinë moderne dhe funksiononale, që të mund të operonte me ushtritë e tjera perëndimore. Gjithashtu i thashë se, do të isha i nderuar që të ndihmoja me çdo mënyrë që mundesha dhe do të veproja si pika e tij e kontaktit me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes, në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Ne e filluam atë ditë duke evidentuar prioritetet e ministrit dhe zhvilluam një plan fillestar. Ishte një mbledhje e gjatë, por një sfidë tepër entuziaste. Isha i nderuar që kërkohesha nga vetë ministri, për të luajtur një rol aq të besuar. Ishte e qartë për mua se ministër Zhulali, kishte një vizion për ta sjellë ushtrinë shqiptare në një nivel ku ajo mund të mbronte popullin, dhe të luante një rol produktiv në rajon dhe më tutje. Përveç sfidës së madhe që të ndihmonin e të ridizenjonin ministrinë si e tërë, mua gjithashtu më kërkuan që të ndihmoja të krijonim e modernizonim një Regjiment të operacioneve speciale, i aftë të vepronte në çdo terren. Po ashtu krijimin e një Shërbimi Inteligjence Ushtarake të pavarur, që të jepte të dhëna strategjike, në mbështetjen e drejtpërdrejtë të të gjitha aktiviteteve të Ministrisë së Mbrojtjes. Të gjitha këto, ishin detyra të vështira, të cilat donin të kërkoja ndihmë, nga shumë pjesë të strukturave ushtarake amerikane. Një mardhënie e veçantë kishte

lindur, bashkëpunimi i të dy palëve ishte aq i hapur dhe i frytshëm.

Cili është vlerësimi juaj për ushtrinë shqiptare gjatë këtyre kontakteve të para?

Dua të them se, lidhshipi i gjithë ushtrisë (ushtria, marina dhe forca ajrore) ishin të gjitha pozitive dhe plotësisht të fokusuara në detyrat e tyre, me një dëshirë për të mësuar dhe përmirësuar. Niveli i profesionalizmit ishte i lartë, por shumica kuptoi që vitet e gjata të izolimit, i kishin lënë ata pak prapa teknologjisë moderne, dhe të pavetëdijshëm se si ata mund "të ndërvepronin" efektivisht me ushtritë e tjera. Ishte një kënaqësi



të bashkëpunojë me aq shumë ushtarakë të entuziazmuar dhe seriozë, që rriteshin dhe mësonin. Ata gjithashtu donin që të ishin plotësisht një pjesë e Perëndimit dhe NATO-s, veçanërisht të ishin sa më pranë Amerikës. Kur unë i tregova që Amerikës nuk i duheshin klientë, por i duheshin shumë miq dhe përfundimisht aleatë, ata e kuptuan diferencën dhe u përqopën që të ishin pikërisht të tillë. Ata morrën vesh që Amerika nuk kishte synim që të përfitonte nga Shqipëria, dhe prandaj ishin të hapur dhe të ndershëm me mua në çdo mënyrë. Ata ishin të gatshëm të ndanin informacionin, nga i cili përfitonin të barabartë të dyja shtetet.

Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan disa stërvitje të përbashkëta. Çfarë ju la juve përshtypje nga këto zhvillime?

Stërvitja e parë fare e përbash-

kët ishte midis një Kompanie Shqiptare të njohjes së terrenit, dhe një skuadër e vetme e elites së Forcave Speciale Amerikane. Ishte organizuar nën drejtimin e Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes, i nderuari doktor Uilliam Peri. Zoti Peri kërkonte që unë të ndërtoja sa më shumë bashkëpunim që mundeshim dhe ky ishte vetëm fillimi. Nga ai fillim i vogël, pasuan një seri stërvitjesh të tjera të konceptuara me emrin "Shqiponja Shpëtimtare". Këto ishin operacione të tipit kërkim-shpëtim, që tregonin mundësitë e dy ushtrive për të punuar së bashku, të bashkëpunonin në operacione paqeruajtëse, duke ndihmuar njëritjetrin, kur personeli kishte humbur

ose ishte në rrezik. Këto mund të aplikoheshin në situata ushtarake specifike (pilotët e rrëzuar për shembull), ose mbështetje ndaj fatkeqësisë civile (si rrëshqitjet e dheut, tërmetet). Ata filluan me struktura të vogla, por më pas u përfshinë të gjitha shërbimet (Forca Ajrore, Ushtria dhe Marina). Në një shembull, një njësi e plotë e Ekspeditës së Marinës së SHBA-së (MEU), solli në breg tre ngarkesa anijesh të Forcave Tokësore (disa mijëra), në një zonë trajnimit në veri të Durrësit. Nga këto stërvitje, ushtarët amerikanë përfituan eksperiencë po aq sa homologët e tyre shqiptarë. Më vonë, marrëdhëniet e ndërtuara në këto stërvitje, krijuan mundësi për Korpusin e Marinës Amerikane, që ti kërkojë ndihmë ushtarakëve shqiptarë për të trajnuar një prej njësive që vepronte në Bosnjë, në malet me borë të Shqipërisë së Veriut. Ministria e Mbrojtjes bëri gjithçka që mundi,

për ta bërë trajnimin tepër efektiv. Nga pala amerikane u vlerësua si një ndihmë e domosdoshme për operacionet reale të këtij lloji. Shumë stërvitje si kjo pasuan. Një vëllazëri e vërtetë kishte filluar.

A mund të na shpjegoni rëndësinë dhe përfitimin e ushtarakëve shqiptarë që kanë shkuar në SHBA për trajnim, arësimim, si dhe vizitat reciproke të nivelit të lartë të Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes?

Në dy vitet e para, dhjetëra

krijua midis Ministrit të mbrotjes Zhulali dhe Sekretarit të Mbrojtjes Peri. Sekretari i Mbrojtjes bëri një vizitë në Shqipëri dhe të dy zbuluan që kishin shumë gjëra të përbashkëta. Të dy ishin matematicienë, të dy ishin ekspertë shahu, dhe të dy kishin vajza. Kjo vizitë fillestare çoi në një vizitë kthimi, ku Ministri i mbrotjes i Shqipërisë u prit me nderime të plota në Pentagon. Ministri Zhulali kërkoi që Shqipëria të bashkohej përfundimisht me organizatën e Partneritetit për Paqe të NATO-s. Për këtë qëllim sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së, më dha autoritetin që të gjeja sa

një aleat të vërtetë. Ata ashtu si unë, do të provojnë ndjesinë dhe peshën e plotë të mikpritjes e profesionalizmit të vërtetë shqiptar. Terreni dhe kushtet në Shqipëri janë të ashpra, kërkojnë njerëz të fortë, por unë e di se ushtarakët amerikanë do sjellin përvojën e tyre më të mirë, e cila do të përshtatet nga ushtria shqiptare. Presim që të shpalosen sërish mardhëniet dhe miqësia e ngrohtë midis dy popujve dhe ushtrive tona. Besoj se do të jetë një stërvitje e mrekullueshme.

Ju keni pasur shumë eksperiencë shtesë pasi latë Shqipërinë, çfarë vendi zë Shqipëria në eksperiencën tuaj?



ushtarakë shqiptarë udhëtuan drej SHBA-së për shkollë dhe trajnim pranë personelit amerikan. Gjatë asaj kohe, shqiptarët vepruan shumë mirë gjatë gjithë aktivitetit të tyre në shkollat apo repartet ku shkuan. Ata ishin tepër kompetentë, dhe mësuan shumë. Ata vepruan si përfaqësues të mrekullueshëm të kombit të tyre. Një oficer shqiptar u diplomua shkëlqyeshëm tek Shkolla Ranger e Ushtrisë Amerikane, që madje edhe amerikanët nuk e përfundojnë, dhe pak e arrijnë një sukses të tillë. Marrëdhëniet që u ngritën në këto vite, u rinovuan dhe sollën frytet e tyre, kur Shqipëria iu bashkua SHBA-së në Luftën Globale kundër terrorizmit dhe operacioneve në Irak dhe Afganistan. Dua të veçoj marrëdhënien e ngrohtë që u

më shumë mënyra për të zgjeruar marrëdhëniet bashkëpunuese mes dy ushtrive.

Zoti Atashe, ju mund të jeni vënë në dijeni, se në periudhën prill-qershor 2021, në Europë e Shqipëri, do të zhvillohet stërvitja "Defender Europe 2021", përpos të tjerave, mijëra trupa amerikane do të operojnë në Shqipëri. Çfarë këshille do t'i jepje atyre?

Së pari, unë jam shumë i lumtur dhe i entuziasmuar të shikoj, që marrëdhëniet e mrekullueshme që ne filluam 30 vite më parë, të vazhdojnë në një mënyrë kaq të fuqishme dhe pozitive. Amerikanët vijjnë me pritshmëri dhe një eksperiencë të madhe, duke operuar me

Mbasi mbylla misionin në Shqipëri, në vijim të karrierës si ushtarak, unë komandova trupat e Forcave Speciale Amerikane në luftim, më pas isha Asistent Ushtarak për Sekretarin e Mbrojtjes Donald Ramsfeld. (isha në Pentagon për sulmet e 11 shtatorit). U gëzoja shumë kur Shqipëria u bë anëtare e plotë e NATO-s, një gëzim i ligjshëm ky. Natyrisht si ushtarak kam pasur një karrierë dhe jetë të gjatë për të cilën ndjem krenar dhe i kënaqur. Gruaja ime dhe unë kemi folur shpesh për kohën që kaluam në Shqipëri, si një nga detyrat më domethënëse që kemi kaluar ndonjëherë. Gruaja ime punonte edhe me personelin mjekësor

vendas edhe me atë misionar përgjatë kohës tonë atje. Ne ishim në gjendje të dëshmonim dhe ndihmonim në rilindjen e një kombi në arenën ndërkombëtare, dhe në çdo fushë (liria e shtypit, liria e fesë, liria ekonomike, e të tjera.) Është e vështirë ta përshtatësh se si ky vend ndikon në zemrën dhe shpirtin e dikujt. Shqipëria është e pasur, duke u mbështetur në popullin dhe historinë e saj. Populli shqiptar e do lirinë, dhe ata punojnë fort për ta ruajtur atë. Ajo dashuri për lirinë, i bën Shqipërinë dhe Amerikën miq dhe aleatë natyrorë. Është lutja ime nga zemra që dy kombet tona të vazhdojnë të rriten së bashku, të punojnë së bashku, dhe të qëndrojnë së bashku drejt së ardhmes.

Faleminderit mik!

Kampionati i Shahut në strukturat e Forcave të Armatosura



Nga nënkolonele Arta Driza
Woman Candidate Master and FIDE
Arbiter, Albanian Champion
Specialist Standartizimi

Në zbatim të kalendarit të veprimtarive sportive të FA-së për vitin 2021, nga data 12 deri më 16 prill 2021, në ambientet e garnizonit ushtarak të FD-së, u zhvillua kampionati i shahut me strukturat e forcave të armatosura të RSH-së. Në këtë kampionat morën pjesë shahistë nga komandat, njësitë dhe repartet autonome, të cilët u përfaqësuan me nga 4 (katër) pjesëmarrës, me një pjesëmarrje të gjerë, 40 veta nga 8 ekipe të FA-së. Pjesë e aktivitetit ishin edhe një ekip nga trupat e SHBA-së, të ardhur në Shqipëri për stërvitjen "Defender 2021". Në këtë kampionat morën pjesë shahistët më të mirë të përzgjedhur nga konkurimi në të gjitha njësitë dhe repartet e FA-së. Zhvillimi i këtij aktiviteti, në bashkëpunim me federatën shqiptare të shahut konsiderohet si një sukses i shtuar i lëvizjes shahistike në Shqipëri.

Një garë shumë e bukur me ushtarakët dhe civilët e FA-së, është kthyer tashmë në një aktivitet tradicional vjetor. I pari kampionat shahu në FA është zhvilluar në vitin 2015 me iniciativën time dhe asistencën

Pjesë e aktivitetit ishin edhe një ekip nga trupat e SHBA-së, të ardhura në Shqipëri për stërvitjen "Defender 2021"

e shtuar, nisur nga ekperiencia personale për organizimin e aktiviteteve shahistike dhe promovimin e këtij sporti edhe në FA.

Simultanja e zhvilluar me 20 efektive të FA-së, shahistët më të mirë që morën pjesë në kampionatin e shahut të Forcave të Armatosura nga International Master dhe kampioni aktual i shahut z. Llambi Pasku i dha larminë dhe tonin këtij aktiviteti vërtet emocionues në ambientet e mrekullueshme të FD-së në qytetin e bukur bregdetar. Në ceremoninë e mbylljes u ndanë edhe çmimet përkatëse, ku u shpërndanë kupa dhe diploma për fituesit e këtij kampionati. Vendi e parë dhe kupën e meritoi ekipi i AFA-së, me këto shahistë në

përbërje; Nënkolonel Edvis Spahi, Civil Durim Saraci, Nënkolonel Bedri Qoli, Kolonel Artan Bufi.

Në vendin e dytë u rendit ekipi i FT-së dhe në të tretin ekipi i FD-së. Mjeshtrit ndërkombëtar të shahut iu dorëzua "certifikatë mirënjohje" dhe një dhuratë simbolike për angazhimin e tij në organizimin e këtij kampionati në FA.

Ceremonia e mbylljes u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe festive, të krijuar në ambientet e FD-së. Për të ndjekur nga afër këtë aktivitet ishin të pranishëm: përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, FD, Sekretarja e përgjithshme e Federatës Shqiptare të Shahut, Shefi i operacioneve të stërvitjes Defender



2021, llejtënant kolonelë, kolonelë dhe ushtarakë të tjerë të FA-së.

Zv komandanti i FD-së, kapiten i rangut të I-rë, Ferdinand Kreshpani, duke përshëndetur pjesëmarrësit në këtë kampionat u shpreh se: "ndjehem krenar dhe i lumtur që Forcat e Armatosura arritën të zhvillojnë një kampionat shahu këtu në ambientet tona dhe të kemi mbështetjen dhe njohjen nga federata e shahut të Shqipërisë."

Një përshëndetje e veçantë në këtë ceremoni bëri edhe Sekretarja e Federatës Shqiptare të Shahut, Znj. Majlinda Pilinci, e cila ka falenderuar nën/kol Artë Drizën për kontributin e dhënë në zhvillimin e kampionateve të shahut në FA dhe për të çuar më tej këtë traditë të nisur 6 vite më parë, duke zhvilluar edhe kampionate të tjera të shahut në Forcat tona të Armatosura me qëllim që të nxjerrim edhe ne shahistë të shquar dhe profesionistë, dhe të përfaqësohemi denjësisht në "NATO CHESS CHAMPIONSHIP". Një falënderim i veçantë u bë për të gjithë kontribuesit në këtë aktivitet si: Federata e Shahut për bashkëpunimin dhe suportin, FD për mikëpritjen dhe masat organizative në zhvillimin e kampionatit dhe SHBA-në për mundësimin e pjesëmarrjes në këtë aktivitet me një ekip shahu.

Shahistët më cilësorë ushtarakë e civilë u ftuan që të marrin pjesë në "Gjysmë finalët e kampionatit kombëtar" me qëllim marrjen e FIDE ID dhe mundësimin e ratingut ndërkombëtar. Njëkohësisht u hodh edhe ideja për krijimin e ekipit të shahut si një disiplinë zyrtare dhe fillimin e stërvitjes me fëmijët e kontigjentëve të FA-së, me qëllim promovimin e shahut tek të rinjtë dhe injektimin e cilësive të veçanta që t'i jep vetëm ushtrimi i këtij sporti. Nuk mund të humbej edhe mundësia për një vizitë në anije në portin e Durrësit. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët në aktivitetin e organizuar me këtë rast.

Shahu si disiplinë ushtarake

Shahu përveç se është një mjet për të promovuar vlerat njerëzore, intelektuale, e bashkëpunuese është edhe mjeti që i përket disiplinës ushtarake. Shahu konsiderohet të jetë një lojë strategjike - kjo do të thotë që për të fituar, duhet të keni një plan veprimi më të mirë se kundërshtari juaj. Por askush nuk ka lindur me aftësinë për të konceptuar lëvizje të mëdha strategjike, ajo duhet të mësohet duke u praktikuar. Strategjia zhvillohet nga gjeneralë të luftës dhe ushtrisë që planifikojnë sulmet e tyre me lëvizje strategjike, ky shembull dhe model nuk është larg shahut. Ashtu si një gjeneral komandon ushtrinë e

tij, një lojtar shahu komandon figurat e tij në një betejë bardh e zi. Pra, loja e shahut përmirëson shumë aftësinë për të zhvilluar strategji dhe plane të caktuara. Dhe po, ky përfitim nuk është i dobishëm vetëm për gjeneralët e ushtrisë dhe lojtarët e shahut - një mendje e mirë strategjike është shumë më produktive, sepse krijon planin më të mirë të veprimit për çdo detyrë ditore. Gjithashtu, mendimi strategjik është një shpëtimtar në mjediset akademike dhe të punës, sepse gjithçka është planifikuar një hap përpara dhe gjithmonë ka një plan b - rezerve për të operuar. Ka dokumente që deklarojnë se perandorët në të gjithë botën luanin shumë lojëra strategjike me gjeneralët e tyre për të parë sa shpejt do të reagoonte mendja e tyre ndaj situatës aktuale. Një nga rekordet e dokumentuara

e mendjes.", Blaise Pascal; Kërko-het një kujtesë e fortë, përqendrim, imagjinatë dhe një dëshirë e fortë për t'u bërë një lojtar i shkëlqyer shahu", nga Bobby Fischer. Nga studime të kryera mbi përfitimet e shahut në të gjitha moshat kanë dokumentuar që shahu ndihmon veçanërisht fëmijët.

10 përfitimet kryesore të shahut:

Promovon zhvillimin e trurit: lojëra si shahu që sfidojnë trurin në të vërtetë stimulojnë rritjen e dendriteve, trupat që dërgojnë sinjale nga qelizat e neuroneve të trurit; Ushtron të dy anët e trurit. Një studim gjerman tregoi se: kur lojtarëve të shahut u kërkohej të identifikonin pozicionet e shahut dhe format gjeometrike, hemisfera e



është i një perandorit kinez Sun Xu, i cili ishte një strateg me të vërtetë i shkëlqyeshëm mësimit e të cilit janë aktuale dhe të të vlefshme edhe sot.

Si mundet shahu ta mbajë trurin të mprehtë?

Aftësitë kryesore të një lojtari shahu janë kujtesa, përqendrimi, llogaritja dhe planifikimi. Lojtarët e shahut ushtrojnë kreativitetin sepse u duhet të bëjnë zgjidhjen e problemeve ndërsa kundërshtari i tyre përpjeket të shkatërrojë përpjekjet e tyre. Këto përpjekje mendore përforcohen si nga argëtimi, ashtu edhe nga çlirimi i adrenalinit dhe endorfinës nga trupi. Thënë, që lojtarë të mëdhenj, kampionë botedhe njerëz të mëdhenj kanë shprehur për shahun: "Shahu është mbi të gjitha një luftë!", Emanuel Lasker; "Shahu është luftë e improvizuar në një tavolinë shahu.", Bobby Fischer; "Shahu është gjimnastika

majtë dhe e djathtë e trurit bëheshin shumë aktive; Rrit IQ-në tuaj: a luajnë njerëzit e zgjuar shah, apo shahu i bën njerëzit të zgjuar? Të paktën një studim shkencor ka treguar që loja e Shahut në fakt mund të rrisë IQ-në e një personi; Ndihmon në parandalimin e Alzheimerit: me kalimin e moshës, bëhet gjithnjë e më e rëndësishme t'i jepni trurit një stërvitje, ashtu si duhet të bëni çdo grup tjetër muskular, për ta mbajtur atë të shëndetshëm dhe të përshtatshëm; Nxiti krijimtarinë: luajtja e shahut, aktivizon anën e djathtë të trurit, anën përgjegjëse për krijimtarinë; Rrit aftësitë për zgjidhjen e problemeve: një ndeshje shahu kërkon mendim të shpejtë dhe zgjidhjen e problemeve gjatë një kohe të shpejtë, sepse kundërshtari juaj po ndryshon vazhdimisht parametrat; Mëson planifikimin dhe parashikimin: sepse luajtja e shahut kërkon mendim strategjik dhe kritik, ndihmon në promovimin e zhvillimit të korteksit parabolloz dhe

ndihmon adoleshentët të marrin vendime më të mira në të gjitha fushat e jetës, madje i mban ata të mos bëjnë një zgjedhje të papërgjegjshme e të rrezikshme; Përmirëson aftësitë e të lexuarit: në një rreth shkollor ku nxënësit u testuan fëmijët nga rrethi që luajtën lojën e shahut ishin mbi mesataren kombëtare; Optimizon përmirësimin e kujtesës: një studim i nxënësve të klasës së gjashtë të Pensilvanisë zbuloi se studentët që kurrë më parë nuk kishin luajtur shah përmirësuan kujtimet dhe aftësitë e tyre verbale pasi kishin luajtur shah; Përmirëson rikuperimin nga goditja në tru ose aftësia e kufizuar: shahu zhvillon aftësi të shkëlqyera motorike tek individët që kanë aftësi të kufizuara ose kanë pësuar goditje në tru ose ndonjë aksident tjetër fizikisht dobësues.

Përpjekja mendore e nevojshme për të luajtur lojën mund të përmirësojë aftësitë njohëse dhe komunikuese. Të luash gjithashtu mund të stimulojë përqendrim të thellë dhe qetësi, duke ndihmuar në përqendrimin dhe relaksimin e pacientëve të cilët po përjetojnë shkallë të ndryshme ankthi. Një studim në Danimarkë zëvendësoi një periudhë prej një javë studimi të kaluar në matematikë me një periudhë 1 javë të kaluar duke luajtur shah. Jo vetëm që rezultatet e provave të performancës së matema-

tikës u përmirësuan, madje edhe midis studentëve që luanin vetëm pak shah, por rezultatet u përmirësuan më shumë tek studentët që studiuan shah më thellë. Studimet kanë dokumentuar që shahu ndihmon fëmijët në rrezik me probleme të sjelljes, pasi ata mësojnë se duhet të mendoni për pasojat e lëvizjeve tuaja para se t'i bëni ato.

Përfitimet e shahut janë dokumentuar në dhjetëra studime

Natyra e shahut është në thelbin e saj më shumë se një lojë. Një garë e vendosur mes dy kundërshtarëve, në mënyrë të barabartë në gjithçka, përveç aftësive mendore dhe përvojës. Është lojë e barabartë, aq sa është lojë fisnike, është një garë në të cilën çdokush mund të luajë, por vetëm pak mund ta zotërojnë atë me mjeshtëri. Është një provë që është pothuajse aq e lashtë sa vetë civilizimi, dhe megjithatë thjeshtësia e saj është e pakonkurueshme, dhe shkëlqimi i saj i pakonkurueshëm.

Loja e shahut është gjithashtu një sport mendor. Si e tillë, ajo zakonisht është shoqëruar me njerëz me mbi mesataren në aftësi studimi e mësimi. Në të kaluarën këto përfitime ishin të rezervuara vetëm për njerëzit më të pasur ato të fisnikëve. Si e tillë, loja e shahut

ishte e rezervuar për ata që mund të përballonin kohën dhe aftësinë e një mjeshtri për të bërë setin e tyre dhe ndihmën e një mësuesi që mund t'i mësonte siç duhet ata të luanin.

Sot shahu ka ardhur dhe mund të luhet në masat e gjera. Rregullat janë kudo, në internet, në libra, dhe të lira. Megjithatë, ai ende ka një ajër prestigji dhe të drejte që e ka ndjekur atë gjatë gjithë historisë. Në thelb, shahu është një lojë elitare, edhe pse masat janë të ftuara për të luajtur, janë vetëm më të zgjuarit, dhe jo më të pasurit, që mund të pretendojnë dominimin mbi këtë sport mendor.

E megjithatë ekziston një imazh i ri i mjeshtrit të shahut. Nuk është një njeri i pasur ose një fisnik i shëndetshëm me rroba të shkëlqyera. Përkundrazi, është një imazh i një njeriu apo gruaje të thjeshtë, të përlulur. Është një lojë e një njeriu të shkëlqyeshëm, pa para, e njëgjenui të pa punë; është një sport që barazon të gjithë njerëzit nën një faktor përcaktues: sa mirë ju e luani lojën e shahut. Kjo është një diktomi. Nga njëra anë loja është elitare, dhe nga ana tjetër është demokratike. Ky është një simbol për një mënyrë të menduarit rreth botës. Madhështia duhet të rritet nga cilësia individuale e personit në fjalë.

Në ambientet e garnizonit "Skënderbej" në Ministrinë e Mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Baram Begaj mori pjesë më 2 prill 2021, në ceremoninë e përfundimit të aktivitetit sportiv të 5-Garëshit Ushtarak për vitin 2021 në rang Force të Armatosur, i cili u zhvillua në ambientet e garnizonit "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes. Në përshëndetjen e tij, gjeneralmajor Begaj, pasi falënderoi organizatorët për punën e shkëlqyer, përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit për frymën e kolektivitetit dhe shpirtin e garës, tipare këto që karakterizojnë Forcat e Armatosura për arritjen e synimeve dhe objektivave që ata i vënë vetes në realizimin e detyrave. Në aktivitetin sportiv të 5-Garëshit Ushtarak në rang FA, morën pjesë: Komanda e Forcës Tokësore, Detare, Ajrore, Komanda Mbështetëse, AFA, Policia Ushtarake si dhe ASNI. Ky event sportiv u dominua nga ushtarakët e Forcës Tokësore, të cilët arritën që të merrnin vendin e parë për të disatin vit radhazi. Më pas në vendin e dytë dhe të tretë u renditën respektivisht Forca De-

Përfundon aktiviteti sportiv 5-Garësh Ushtarak për vitin 2021

Në aktivitetin sportiv të 5-Garëshit Ushtarak në rangFA, morën pjesë: Komanda e Forcës Tokësore, Detare, Ajrore, Komanda Mbështetëse, AFA, Policia Ushtarake si dhe ASNI

tare dhe Akademia e Forcave të Armatosura. 5-Garëshi Ushtarak në rang FA u zhvillua në periudhën 29 mars-2 prill 2021. Në këtë aktivitet morën pjesë 7 ekipe nga

të gjitha komandat dhe repartet autonome të FARSH-it, në disiplinat: qitje sportive, vrapim 8 km, granadë në precizion dhe distancë, not me pengesa dhe brez-kalitje.





Në vazhdim të takimeve të tij, Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, priti në takim ambasadorin e SHBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. Në fillim, ambasadori Kosnett e uroi ministrin Mehaj për detyrën duke i shprehur vullnetin e tij për bashkëpunim në të ardhmen. Nga ana e tij, ministri Mehaj shprehu falënderimin për vizitën duke theksuar mirënjohjen e thellë për SHBA-në në mbështetjen e pazëvendësueshme për vendin tonë si dhe në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ai, gjithashtu, theksoi se mbështetja e deritashme e SHBA-së ka qenë jetike në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-së, që u kurorëzua edhe me pjesëmarrjen e kontingjentit të parë të FSK-së në misionin e parë jashtë vendit së bashku me forcat ushtarake amerikane. Ministri Mehaj, në vazhdim e njoftoi ambasadorin Kosnett edhe me objektivat kryesore të tij duke shprehur vullnetin për realizimin e tyre në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me SHBA-në dhe vendet tjera partnere. Ai theksoi se FSK është dhe do të jetë forcë profesionale me vlera dhe standarde të vendeve të NATO-s nën kontrollin civil demokratik dhe gjithnjë në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit pa dallim dhe në shërbim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë. Në vazhdim, ambasadori Kosnett, premtosi se SHBA, përmes bashkëpunimit me Armatën e SHBA-ve, Gardën Kombëtare të Ajrovës, dhe programeve tjera, sikur edhe deri më tash, do të vazhdojë partneritetin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Në fund, të dy ishin të një qëndrimi, që të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi bilateral në mes dy vendeve partnere në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



Ministri Mehaj priti ambasadorin e SHBA-së, Philip Kosnett

Bashkëpunim me SHBA-në në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Mbështetja e SHBA-së ka qenë jetike në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s

BASHKËPUNIMI

Gjeneral lejtënant Rama u takua me ambasadorin e Hungarisë

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, priti në takim ambasadorin fuqiplotë të Republikës së Hungarisë në Kosovë, diplomatit Laszlo Markusz. Në takim u bisedua për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë, si dhe për marrëdhëniet e mira dhe të frytshme ndërmjet të dy forcave respektive. Komandanti i FSK-së dhe ambasadori hungarez shprehën gatishmëri për vazhdimin e bashkëpunimit dhe identifikimin e aktiviteteve për thellimin e tij në të ardhmen. Ndërkohë Drejtori i Politikave të Mbrojtjes i Ministrisë së Mbrojtjes zoti Faruk Geci në kuadër të takimeve bilaterale, takoi Ndhmës Sekretarin e Politikave të Mbrojtjes së Hungarisë në Budapest. Qëllimi i takimit ishte thellimi i bashkëpunimit bilateral, njoftimi mbi procesin e tranzicionit të FSK-së me mandat të ri, si dhe mundësitë e bashkëpunimit me aktivitete operacionale në kuadër të dy ushtrive. Drejtori Geci dhe Ekipi nga Ministria e Mbrojtjes njoftuan partnerët hungarez edhe mbi situatën e sigurisë dhe të mbrojtjes në vend dhe rajon. FSK-ja e trajnuar për mandat të ri me standarde të NATO-s do të jetë pjesë e ofrimit të sigurisë në vend dhe më gjerë.

Dy kadetë të FSK-së diplomohen në Akademinë Mbretërore “Sandhurst”

Më datë 9 prill 2021 në Paraden e Sovranit nga Akademia Ushtarake Mbretërore “Sandhurst” të Mbretërisë së Bashkuar, u mbajt ceremonia e diplomimit të kadetëve ku u diplomuan edhe dy kadetë të FSK-së: nëntogere Iliriana Bunjaku dhe nëntoger Ardit Deliu. Kadetja e FSK-së nëntogere Iliriana Bunjaku ka marrë çmimin e parë në këtë ceremoni “Shpata Ndërkombëtare” si kadetja më e mirë ndërkombëtare. Me këtë rast, Ambasada e Britanisë së Madhe, është shprehur e emocionuar për suksesin e nëntogeres Bunjaku.

“Ajo triumfoi përballë një konkurrence shumë të fortë për të fituar çmimin, e cila reflekton performancën e saj të jashtëzakonshme, duke demonstruar qëndrueshmëri fizike, guxim dhe aftësi të vërteta drejtuese gjatë gjithë kursit. Urime për një arritje të jashtëzakonshme, Iliriana!”, -shkruhet në urimin e Ambasadës britanike.

Çmimi është dorëzuar nga Shefi i Shtabit të Mbrojtjes, Gjenerali Sir Nicholas Carter. “Ky është një moment jashtëzakonisht krenar për ne dhe demonstron profesionalizmin dhe aftësinë e FSK-së”, -vijon ambasada. Deri më sot Mbretëria e Bashkuar ka trajnuar 23 pjesëtarë të FSK-së në Akademinë prestigjioze Sandhurst. “Rezultatet e treguara gjatë studimeve të kurorëzuara me titullin e kadetes më të mirë në këtë akademi, ndër më të famshmet në Botë, atë e bëjnë ambasadore të shkëlqyer të Kosovës në arenën ndërkombëtare”, -thuhet në njoftimin për media të Ministrisë së Mbrojtjes. Më tej në njoftim thuhet se kjo arritje e jashtëzakonshme e nëntogere Bunjakut është reflektim i profesionalizmit, aftësive dhe

Janë diplomuar nëntogere Iliriana Bunjaku dhe nëntoger Ardit Deliu. Nëntogere Iliriana Bunjaku ka marrë çmimin e parë “Shpata Ndërkombëtare” si kadetja më e mirë ndërkombëtare



potencialit të madh të FSK-së në perspektivën zhvillimore të saj. Gjithashtu kjo është vlerë e çmuar e partneritetit tonë me Mbretërinë e Bashkuar si dhe mirënjohje e madhe për investimin e vazhdueshëm të tyre në kuadrot tanë të talentuar.

Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani e ka quajtur ditën e Diplomimit të dy kadetëve oficerë të Republikës së Kosovës, kadete Iliriana Bunjaku dhe kadet Ardit Deliu, të cilët u diplomuan nga Akademia Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Britani, njëra prej akademive ushtarake më prestigjioze në botë, si “Ditë krenarie”. “Sot, emri i Republikës sonë u lartësua edhe më shumë. Këta vajza dhe djem po i dëshmojnë të gjithë botës që puna, zelli e përkushtimi shpërblehen gjithmonë. Këta të rinj po na e zbardhin fytyrën e po e ngrenë shtetin tonë në pedestal”, -ka thënë Presidentja Osmani. Sipas Presidentes, vajzat e djemtë e Forcës tashmë janë të dëshmuar në çdo cep ku shkel këmba e tyre. Ata janë premtimi ynë më i madh për një të ardhme të sigurt. Kjo

është dëshmi e performancës së saj superiore në të gjitha fushat, përfshirë rezultatet akademike, shkathtësitë ushtarake, shkathtësitë në lidhshmëri, përgatitje fizike, etj”. “Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, përmes video-thirrjes ka uruar nëntogere Bunjakun për çmimin duke e vlerësuar shembull unik për vajzat dhe motivimin e tyre për uniformën ushtarake të FSK-së. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtant Rahman Rama, bashkë me urimin për suksesin e dy oficerëve tanë shprehu edhe krenarinë për çmimin e marrë nga nëntogere Bunjaku si dhe mirënjohjen e lartë për vlerësimin e lidhshmërisë të akademisë së famshme Sandhurst”, -thuhet në njoftim. Ky çmim është hera e dytë që ndahet për kadetë-oficerët nga Kosova, ku më parë fitues ishte kapiten Ismail Hoxha, i cili aktualisht shërben si instruktor në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Sandhurst, kurse deri më tani në këtë akademi janë trajnuar 23 pjesëtarë të FSK-së.



Më 1 Maj fillon tërheqja e NATO-s nga Afganistani

Maqedonia e Veriut ka kontribuar me më shumë se 3,100 ushtarakë

“Aktualisht, Maqedonia e Veriut kontribuon në misionin në Afganistan me 22 pjesëtarë të Armatës

Forcat Aleate të NATO-s nga 1 maji fillojnë të tërhiqen nga Afganistani. Ky është vendimi i takimit të ministrave të Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme të NATO-s, në të cilin morën pjesë ministrat Bujar Osmani dhe Radmilla Shekerinska. Në takim, aleatët theksuan se presin që kjo të krijojë kushte për një kapitull të ri në të ardhmen e Afganistanit, ku rolin kryesor do ta luajnë qytetarët e vendit. U rikonfirmua mbështetja e fortë për rihvillimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe forcimin e institucioneve të sigurisë në Afganistan. Shtetet anëtare të Aleancës u zotuan të forcojnë përpjekjet diplomatike për të gjetur një zgjidhje politike dhe për të përfunduar me sukses procesin e paqes në Afganistan përmes dialogut të brendshëm inkluziv në vend.

Në takim, ministrat gjithashtu analizuan zhvillimet e reja në dhe rreth Ukrainës. Është shprehur shqetësim në lidhje me veprimet e Rusisë dhe vendosjen e shtuar të trupave në kufirin me Ukrainën. U

shpreh mbështetje e fortë dhe unanime për Ukrainën, si dhe për integritetin dhe sovranitetin e saj territorial. Gjithashtu u theksua mbështetja për dialogun politik brenda kornizës së Marrëveshjes së Minskut, për të cilën ata i bënë thirrje Rusisë që t'i përmbahet parimeve të kësaj marrëveshjeje në drejtim të de-escalimit të tensioneve dhe forcimit të paqes

dhe sigurisë globale. Maqedonia e Veriut ka marrë pjesë në Afganistan që nga viti 2002. Si pjesë e misioneve kemi marrë pjesë me më shumë se 3,100 persona, përfshirë oficerë shtabi dhe nënoficerë, mentorë, njësi të këmbësorisë dhe personel mjekësor. Aktualisht, Maqedonia e Veriut kontribuon në misionin në Afganistan me 22 pjesëtarë të Armatës.

Mbështetja e Sllovenisë është e rëndësishme për Maqedoninë e Veriut

Gjatë vizitës zyrtare në Slloveni, ministria e mbrojtjes Radmilla Shekerinska është takuar me presidentin Borut Pahor. Me këtë takim, ministria Radmilla Shekerinska përmbylli vizitën një-ditore zyrtare në Republikën e Sllovenisë, e cila u zhvillua me ftesë të ministrit të Mbrojtjes, Matej Tonin.

Në bisedën me presidentin slloven, Shekerinska shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Maqedonisë së Veriut. "Maqedoninë e Veriut dhe Slloveninë i lidh një miqësi dhe bashkëpunim i ngushtë që zgjat me dekada. Mbështetja juaj është veçanërisht e rëndësishme për ne, tani që BE bën përpjekje për të siguruar një konsensus për zgjerim me vendet e Ballkanit Perëndimor," -tha ministria Shekerinska. -"Pritjet tona janë që në BE të dominojë pikëpamja se çështjet bilaterale midis shteteve anëtare dhe vendet aspirante nuk duhet të ndërhyjnë në procesin e negociatave.

Presidenti Borut Pahor u shpreh se Sllovenia do të vazhdojë të mbështesë Maqedoninë e Veriut dhe se presidenca e ardhshme Sllovene do ta kthejë rajonin në focus të BE-së.

Në takim gjithashtu u diskutuan problemet e shkaktuara nga pandemia si dhe problemet e shkaktuara nga mungesa e vaksinave.

Pjesa qendrore e vizitës në Slloveni ishte takimi me ministrin e Mbrojtjes Matej Tonin, me të cilin Shekerinska diskutoi për bashkëpunimin në mbrojtje dhe zhvillimin e aftësive të NATO-s në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ministria Shekerinska në Lubjanë vizitoi gjithashtu Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Krizave dhe Qendrën e NATO-s për Përsosmëri në Luftën Malore, ku u njoh me rolin dhe funksionimin e tyre, si dhe pati takim edhe me Komisionin Parlamentar të Mbrojtjes.



Forcat amerikane mbërritën në poligonin Krivollak

Stërvitja ndërkombëtare "Goditje e vendosur 21"

Ministria e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm Azim Nuredin, së bashku me atasheun e mbrojtjes të SHBA-së kolonel Pit Rael, morën pjesë në fillimin e punës së përbashkët të pjesëtarëve të njësive inxhinierike të Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së, të cilat në 30 ditët e ardhshme do të përgatisin terrenin në Poligonin për stërvitjen ndërkombëtare "Goditje e Vendosur 21", e cila do të fillojë në mes të muajit të ardhshëm.

190 pjesëtarë të Batalionit të 15-të Inxhinierik të SHBA-së me 200 makina inxhinierike, automjete dhe pajisje mbërritën në Krivollak dhe së bashku me 120 inxhinierë të Armatës së Maqedonisë së Veriut do të punojnë në infrastrukturën rrugore të poligonit, ndërtimin e një poligoni me objektiva të lëvizshëm për automjete të blinduara dhe pistë për ngritje- ulje për dronët, si dhe do të ngrihet një depo për ruajtjen e objektivave. Njësitë inxhinierike nga Armata e Maqedonisë së Veriut tashmë kanë pastruar në mënyrë të pavarur 33 km rrugë të reja për lidhje më të mirë dhe kalueshmëri të poligonit, dhe së bashku me inxhinierët Amerikanë do të vazhdojnë të punojnë në infrastrukturën rrugore, rindërtimin dhe rritjen e kapacitetit të observatorit Xhidimirci, hapjen e rrugës deri në hyrjen veriore të poligonit. Stërvitja ndërkombëtare "Goditje e Vendosur 21" në Krivollak do të fillojë në 17 maj dhe do të zgjasë deri më 2 qershor, me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të ushtrive të Maqedonisë së Veriut, SHBA-së, Bullgarisë dhe Greqisë. Ministria Shekerinska dhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm Nuredin, sot shfrytëzuan vizitën e tyre në Krivollak për t'u takuar me pjesëtarët e Armatës të cilët ndjekin një kurs për nënoficerë në Krivollak. Pas përfundimit të këtij trajnimi, pas 11 vitesh Armata do të forcojë radhët e saj me brezin e parë me 120 nënoficerë të rinj.

Ministrja e Mbrojtjes prof. Dr. Olivera Injac u takua me Ambasadorin e sapoemëruar të Rumanisë në Malin e Zi, Matei Viorel-Ardeleanu. Ministrja Injac e përgëzoi Ambasadorin për detyrën e tij të re dhe falënderoi Rumaninë për mbështetjen e saj gjithëpërfshirëse për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Malit të Zi. Me rastin e një bashkëpunimi domethënës dypalësh midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, Ministrja Injac shprehu shpresën se do të ketë mundësi për përmirësime dhe zhvillime të mëtejshme në periudhën e ardhshme, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO.

Ministrja Injac e informoi ambasadorin për planet aktuale dhe përparësitë e Ministrisë së Mbrojtjes për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes, dhe theksoi angazhimin e Malit të Zi për të ruajtur stabilitetin dhe sigurinë e rajonit, përmes zhvillimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit rajonal. Injac përshëndeti gjithashtu gatishmërinë e Rumanisë për të vazhduar sigurimin e mbështetjes për Malin e Zi në procesin e integritetit evropian, si dhe mbështetjen e qartë për politikën e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Ambasadori Ardeleanu vuri në dukje anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, si një konfirmim i përparimit të madh të Malit të Zi në zbatimin me sukses të reformave në sektorin e mbrojtjes dhe fusha të tjera të rëndësishme. Ardeleanu theksoi besimin e tij se bashkëpunimi dypalësh midis dy vendeve do të vazhdojë të thellohet me dinamikën e vendosur dhe konfirmoi synimin e Rumanisë për të qenë një partner i fortë i Malit të Zi në periudhën e ardhshme, veçanërisht në fushën e integritetit evropian.

Gjatë takimit, bashkëbiseduesit gjithashtu iu referuan pandemisë së virusit COVID-19, e cila aktualisht është sfida më e madhe në nivelin global, dhe theksuan rëndësinë e solidaritetit dhe mbështetjes së ndërsjellë si arma më e rëndësishme për tejkalimin e saj. Takimi u ndoq gjithashtu nga atasheu ushtarak

Mali i Zi i angazhuar për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit

“Aktivitetet e parashikuara nga Plani i Bashkëpunimit Bilateral për vitin 2021 do t'a përmirësojnë edhe më shumë afrimin me forcat ushtarake rumune



rumun për Malin e Zi, kolonel Lovin Sherban.

Në takime të ndara, kolonel Sherban gjithashtu u takua me Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Politikën e Mbrojtjes dhe Planifikimit, gjeneralmajor Rajko Pesic, si dhe me Ushtruesin e Detyrës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi, kolonel Aleksandar Pantovic.

Gjatë takimit midis gjeneralmajorit Pesic dhe kolonel Sherban, u shpreh kënaqësi në lidhje me bashkëpunimin aktual midis Malit të Zi dhe Rumanisë në fushën e mbrojtjes, si dhe pritshmërisë që aktivitetet e parashikuara nga Plani i Bash-

këpunimit Bilateral për 2021 do ta përmirësojnë atë më tej. Gjeneral Majori Pesic theksoi rëndësinë e ruajtjes së bashkëpunimit të vazhdueshëm, duke pasur parasysh se Rumania, si një aleate e NATO-s dhe pjesë e familjes europiane, mund të kontribuojë në një profilizim më të fortë të Malit të Zi në rrugën e saj europiane. Kolonel Pantović dhe kolonel Zerbana diskutuan mbi mundësitë aktuale të pjesëmarrjes së përbashkët në stërvitjet ushtarake, kontributin e të dy vendeve në strukturën komanduese të NATO-s, si dhe mbështetjen që të dy vendet ofrojnë brenda misionëve ndërkombëtare.

Franca do të mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi

Mbështetja konsiston në përmirësimin e burimeve njerëzore dhe pjesëmarrjen në misionet dhe operacionet ndërkombëtare

Ambasadori i sapoemëruar i Republikës së Francës në Malin e Zi, Christian Timonije, zhvilloi një vizitë përuruese në Ministrinë e Mbrojtjes dhe u takua me Ministren e Mbrojtjes të Malit të Zi, Prof. Dr. Olivera Injac. Ministria Injac falënderoi Ambasadorin për mbështetjen që Franca i jep Malit të Zi në rrugën e integritimit në BE, por edhe si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta brenda anëtarësimit në NATO. Ajo theksoi se suksesi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes reflektohet në shkallën e lartë të realizimit të aktiviteteve të parapara me planet e bashkëpunimit dypalësh, të cilat nënshkruhen në nivel vjetor. Ajo veçanërisht theksoi kënaqësinë e saj me suksesin e zbatimit në rrethana specifike të shkaktuara nga pandemia e virusit Covid-19, e cila dëshmon për angazhimin e Malit të Zi dhe Francës për të mbajtur marrëdhënie të forta miqësore dhe bashkëpunim të suksesshëm, në mënyrë që të promovojnë vlerat europiane dhe ruajnë paqen dhe stabilitetin globalisht.

Ambasadorja Timonia u shpreh e kënaqur me takimin, duke theksuar se marrëdhëniet diplomatike afatgjata midis Francës dhe Malit të Zi bazohen në ruajtjen e vlerave të vërteta demokratike, ndërsa

ushqejnë bashkëpunimin në fusha të shumta me interes të përbashkët. Ai veçanërisht theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të mbrojtjes brenda Aleancës, si dhe pritshmërinë që gjatë mandatit të Ministres Injac, bashkëpunimi dypalësh në këtë fushë do të zhvillohet dhe thellohet më tej, përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta midis Ministrive të Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura malazeze. Timonije tha se Franca do

të vazhdojë të sigurojë mbështetje për Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi në mënyrë që të përmirësojë burimet njerëzore, pjesëmarrjen në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, si dhe në fusha të tjera me interes të përbashkët. Në takim morën pjesë gjithashtu i dërguari i mbrojtjes së Republikës së Francës, koloneli Fabrice Duda dhe shefi i Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Jeanne Spadier.



Bashkëpunim me akademitë prestigjioze ushtarake greke

Në këtë kurs u trajnuan 13 kursantë, 3 femra dhe 10 meshkuj

I dërguari i sapoemëruar i mbrojtjes së Republikës Greke, koloneli Alexandros Radicis, zhvilloi një vizitë përuruese në Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi. Me atë rast, në takime të ndara, ai u takua me Ministren e Mbrojtjes, Prof. Dr. Olivera Injac dhe Zëvendës Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Aleksandar Pantović. Ministria Injac vuri në dukje marrëdhëniet tradicionalisht të mira midis dy vendeve, të cilat sot, 140 vjet pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, janë aleatë në komunitetin më të zhvilluar të demokracive, duke theksuar se Mali i Zi do të vazhdojë të promovojë fuqimisht vlerat dhe parimet Euro-Atlantike të bashkëpunimit. Ajo falënderoi Greqinë për ndihmën e saj të vazhdueshme, si politike ashtu edhe eksperte, në rrugën tonë europiane, përfshirë mbështetjen për perspektivën europiane të të gjithë rajonit. Injac theksoi veçanërisht dinamikën e

bashkëpunimit midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe shkollave ushtarake Greke dhe shprehu besimin se bashkëpunimi i përgjithshëm i mbrojtjes midis dy vendeve do të forcohet dhe përmirësohet më tej në periudhën e ardhshme, si një aleat i NATO-s dhe mbi baza dypalëshe.

Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Aleksandar Pantović vuri në dukje partneritetin dhe marrëdhëniet miqësore midis Greqisë dhe Malit të Zi dhe vuri në dukje rëndësinë e pjesëmarrjes së Greqisë në Programin e Policimit Ajror të Malit të Zi nga Qershori 2018, për të cilën ne jemi veçanërisht mirënjohës. Ai veçanërisht

falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të ofruar nga Republika e Greqisë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Malit të Zi në fushën e arsimit ushtarak, duke theksuar se deri më tani 20 oficerë malazez kanë përfunduar me sukses arsimin e tyre në akademitë prestigjioze ushtarake Greke. Koloneli Radicis falënderoi për mikpritjen në Malin e Zi, duke pritur që plani i bashkëpunimit dypalësh midis forcave të armatosura të të dy vendeve do të përmirësohet më tej gjatë mandatit të tij. Ai vuri në dukje se Republika Greke do të vazhdojë të mbështesë Malin e Zi për Ushtrinë në të gjitha aspektet në të ardhmen.

7 prill 1939, fillimi i rezistencës shqiptare

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Shqipëria në prag të pushtimit fashist

Populli shqiptar e ndjeu rrezikun e pushtimit. Ai shpërtheu në demonstrata dhe i kërkoi qeverisë të organizonte qëndresën. Demonstruesit shkuan përpara pallatit mbretëror në Tiranë për të kërkuar armë. Gatishmërisë së kosovarëve për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve të tyre, qeveria jugosllave iu kundërvu me mbylljen e kufijve. Zogu nuk mbathi opingat dhe nuk ngjeshi armët për ta mbrojtur Shqipërinë sikur kishte premtuar, por mbathi këpucët e modës italiane dhe së bashku me krejt familjen e gjerë, me arin dhe me disa agjutantë besnik, iku nga Atdheu i pushtuar. Më 8 janar të vitit 1939 kryetari i Qeverisë fashiste, Benito Mussolini, miratoi planin e Çianos për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Ahmet Zogu mori disa masa kundër planeve italiane. Ambasadori italian në Tiranë protestoi për këto masa. Ndërkohë, në Italinë e Jugut u përqëndruan forcat ushtarke që do të realizonin pushtimin. Më 25 mars 1939 Ahmet Zogut iu paraqit një projekt traktat nga qeveria italiane që synonte nënshkrimin e Shqipërisë. Por Ahmet Zogu e la në heshtje. Pasi iu përsërit më 2 prill, iu paraqit ultimatumit me afat deri në orën 12.00 të datës 6 prill. Më 5 prill 1939 qeveria shqiptare i paraqiti ministrit italian në Tiranë kundërpropozimet, në të cilat kërkohej të përfundohet një konventë ushtarake dhe të përcaktoheshin rrethanat kur ushtria italiane mund të vendosej në Shqipëri. Më 6 prill pasdreke, parlamenti shqiptar e hodhi poshtë ultimatumit të B. Musolinit.

Në mëngjesin e 7 prillit 1939, ushtria fashiste italiane, prej 35-40 mijë vetë e sulmoi Shqipërinë duke zbarkuar në Durrës, në Vlorë, në Shëngjin dhe në Sarandë. Në Durrës, ushtria e vogël shqiptare e drejtuar kapteri i marinës Mujo Ulqinaku i bëri qëndresë pushtuesit. Ushtarët italianë zbarkuan në bregun e Durrësit, por u detyruan të zmbropseshin në det mbasi në breg i pritit mitrolozi i Mujo Ulqinakut që mbronte trojet e veta.



Në krye të detarëve të braktisur nga mbreti

Kështu, nuk vonoi shumë dhe më 7 prill 1939 trupat fashiste italiane, pas përgatitjesh të shumta, sulmuan atdheun. Me pushtimin fashist italian vendi ynë u gjend i tradhëtuar dhe i papërgatitur për rezistencë. Populli shqiptar në historinë e tij nuk e kishte duruar shtypjen, u ngrit në këmbë dhe kërkoi armë për të luftuar agresionin fashist. Megjithatë armët iu refuzuan, populli u rezistoi fashistëve italianë të armatosur. Të organizuar vullnetarisht mjaft luftëtarë i smbrapsën me guxim shumë herë me radhë sulmet e fashistëve. Me gradën e nënoficerit në një nënrepart të marinës në Durrës, ditën e agresionit fashist italian kundër Shqipërisë u vu menjëherë në krye të detarëve të braktisur nga oficerët e mbretit. Ai organizoi me ta e me vullnetarë të tjerë qëndresën e armatosur në portin e Durrësit. Mujo Ulqinaku luftoi me trimëri e guxim të rrallë.

Ushtarët italianë zbarkuan disa herë në breg dhe po aq herë edhe u zmbropsën. Por ushtria italiane ishte e shumtë në numër dhe Mujo nuk mund t'i bënte ballë për shumë kohë veçse sa që gjallë, ata nuk kaluan dot.

Në këtë mbrojtje të truallit të vet Mujo Ulqinaku ra heroikisht dhe u bë kështu dëshmori i parë i atdheut në luftë kundër pushtuesit fashist. Bashkë me Mujon ranë dhe Hamdi Liko Dollani nga Gramshi, Haxhi Mustafa Tabaku nga Durrësi, Ismail Isuf Reçi nga Kruja, Ramazan Halil Velia nga Dibra, Isak Selim Metalia nga Dibra, Ibrahim Ramë Osmani nga Dibra, Hysen Koçi (Kallço) nga Durrësi. Ndërsa në Sarandë, Vlorë, Berat e Shkodra kanë rënë në fushën e nderit Mitro Vaso Dhimërtika nga Saranda, Hamit Selman Veshko nga Vlora, Zenel Abedin Bllana nga Berati, Tonç Gjon Toma nga Shkodëra, Izet Hysen Shahu nga Erseka.

Shtypi i huaj për qëndresën shqiptare dhe rezistencën antifashiste

Gazeta franceze "La Croix", duke folur për rezistencën e popullit tonë, në kundërshtim me qëndrimin zyrtar të qeverisë shkruante: "Stënipërit e Skënderbeut zbrapsin trimërisht pushtuesin dhe deri tani kanë ndaluar çdo zbarkim...". Duke vazhduar luftënkundër armikut që po shkelte vendin, shqiptarët i treguan gjithë botës se si e mbrojnë lirinë e tyre. Ndërsa gazeta engleze "The Daily Telegraph", dashur padashur shkruante: "Shqipëria foli me një gjuhë të cilën Evropa e kishte humbur zakonisht ta dëgjonte. Shqiptarët refuzojnë të nënshtrohen dhe vazhdojnë luftën...". Ja si e përshkruan okupimin fashist të Shqipërisë publicisti francez, Hubert Bouchet, e pashe të vdesë Shqipërinë. Durrësi u zgjua këtë mëngjes të së premtes së shenjtë si zakonisht. Në port ishin ankoruar dy anije të vogla të përhirta, me pamje peshkaqeni dhe që mbanin flamurin e Madhërisë së Tij Perandorit të Italisë e të Etiopisë. Të tjera anije, në det të hapët, disa milje larg po patrullonin si me pamje të pafajshme...

Kishte mbetur në Europën e mekanizuar në kulm edhe një ishull i vogël njerëzish me zakonet e tyre të lashta, që hanin bukën e thekrës, pinin qumështin e dhive, këndonin luginave baladat e të parëve të tyre! Dhe tani u dashka që këta të marshojnë me hapin e patës, të këndojnë "Giovinezza", të përshëndesin fashistët, të njohin uniformën e përhimtë të një populli vënë në rresht regjimentesh... Por, në fund të fundit, duhet thënë se as që u kërkua ndonjëherë të merrej mendimi i tyre. Pas tradhtisë që Mbreti Zog i bëri vendit, duke e lënë nën mëshirën e gjerakëve të Musolinit, rinia revolucionare e Shqipërisë e bashkuar me Partinë Komuniste Shqiptare, filloi organizimin e rezistencës kundër pushtimit italian dhe për pesë vjet rresht luftoi deri në çlirimin e vendit në nëntor të vitit 1944. Shqipëria ishte vendi i parë në Europë, i cili u çlirua nga nazi-fashizmi, me forcat e veta gjashtë muaj para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Qyteti i Durrësit është qyteti i rezistencës popullore, antifashiste, italiane. Në këtë 82 vjetor të Rezistencës Antifashiste shqiptare dhe të gjithë atyre që dhanë jetën duke luftuar në atë ditë historike për kombin, gjithë populli shqiptar përkulet me nderim para veprës së tyre.

Marinari Mujo Ulqinaku

Mujo Ulqinaku lindi në Ulqin në familjen e një detari të varfër, në vitin 1896. Që në moshë të vogël hyri si ndihmës detar dhe më vonë punoi si detar në Shkodër e në Durrës. I ati ishte marinar. Edhe Mujo, duke ndenjur me të, u mësua me detin dhe i hyri në zemër, kështu që u bë marinar. Shërbimin ushtarak e kreu në marinë, por edhe pas mbarimit të ushtrisë, mbeti përsëri marinar i shërbimit aktiv dhe më vonë, më 1929, u bë kapter. Mujo shërbeu në motoskafin "Tirana", i cili bënte roje në bregdeti shqiptar. Në ushtri ra në kontakt me elementët patriotë dhe filloi ta luftojë regjimin e Zogut dhe fashizmin italian. Mujo për fashizmin italian foli hapur. Kështu që ra në sy autoriteteve të qeverisë, të cilët e nxorrën në lirim. Ai filloi të endet sa andejkëtej duke punuar në portin e Durrësit për të siguruar jetën e familjes. Më 1933 e kërkuan përsëri në shërbim. Pas shumë ngurimesh dhe nisur nga gjendja e vështirë ekonomike, dashuria për detin dhe i nxitur nga shokë marinarë të vjetër, rifilloi shërbimin në marinë. Mujo kishte ndryshuar. Jeta e kishte mësuar, kalitur, epjekur dhe e shikonte gjendjen më realist. Urrejtjen që ushqente për regjimin e Zogut nuk e fshihte, por e shfaqte te shokët e detit, në anije, në qytet e kudo. Ishte viti 1937, kur Italia fashiste po kurdiste provokacione për të pushtuar vendin. Mujo mori pjesë në manifestimet e urrejtjes nga rinia dhe patriotët e qytetit të Durrësit që organizuan kundër këtij provokimi. Qeveria kishte dijeni për këtë provokim, duke parë urrejtjen e popullit, kërkoi që anijet luftarake italiane të largohen nga porti i Durrësit. Italia fashiste me këto veprime bënte manovra, sepse ajo nuk hoqi dorë asnjëherë nga qëllimet e saj agresive.

Në këto përpjekje legjendare të popullit shqiptar në Durrës mori pjesë dhe Mujo Ulqinaku, i cili, me thirrjet që u bënte shokëve të tij marinarë, u thoshte: "Tradhëtia e ka mbuluar vendin tonë... Ne, na takon të luftojmë për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë. Të betohemi vëllezër, se s'do të kursejmë as gjakun, as jetën tonë për mbrojtjen, e Atdheut...". Dhe Mujo e mbajti fjalën. Së bashku me patriotët e tjerë shqiptarë, luftoi deri në pikën e fundit të gjakut të tij. Vetëm me epërsi të madhe në numër e mjete fashistët mundën të thyenin rezistencën heroike të popullit në Durrës, në Vlorë, në Sarandë, në Shëngjin e gjetkë. Dhe megjithëse vendi u pushtua, populli shqiptar asnjëherë nuk e pranoi robërinë dhe nuk u përkul.

Aktit heroik të Mujo Ulqinakut i kushtohet busti i vendosur pranë kullës së kalasë së Durrësit, emrin e tij e mbajnë rrugë, anije, shkolla etj. Për meritat e tij të shquara me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të Atdheut, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH i dha Mujo Ulqinakut titullin e lartë "Hero i Popullit". Veteranë, familjarë të dëshmorëve, pjesëtarë të Forcave të Armatosura dhe populli në këtë ditë të shënuar bëjnë homazhe pranë monumentit të Heroit të Popullit, Mujo Ulqinaku, duke nderuar kujtimin e atyre që dhanë jetën për të ndaluar pushtimin e vendit.



STËRVITJA USHTARAKE “DEFENDER EUROPË 21”

Forcat e NATO-s fillojnë zbarkimin në Portin e Durrësit

Kolonel Joseph Scrocca, Drejtor për Marrëdhëniet me Publikun në Komandën e Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe Afrikë, deklaroi se: “në stërvitjen “Defender Europe 21” marrin pjesë më shumë se 26 kombe dhe 28.000 trupa shumëkombëshe që do të kryejnë aktivitete pothuajse në të njëjtën kohë në më shumë se 30 zona trajnimi, të shtrira në 12 vende midis tyre edhe Shqipëria.

